



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Fakulteti i Ekonomisë



Disertacion

Tema: Parandalimi i Pastrimit të Parave PPP

Në kërkim të gradës shkencore “Doktor”

Punoi:

Roland SUBASHI

Udhëheqësi Shkencor:

Prof. Dr. Ilia KRISTO

Tiranë 2015

Falenderimet

Studimi i fenomenit të pastrimit të parave është një sfidë personale për shkak të angazhimit disa vjeçar në pozicione të ndryshme si në autoritetin përgjegjës DPPP ashtu dhe në industrinë bankare.

Falenderoj kolegët e intervistuar të sektorëve financiar dhe jofinanciar si dhe të autoriteteve shtetërore me njohuri të mira në fushën e parandalimit të pastrimit të parave të cilët bënë të mundur paraqitjen sa më reale të problemeve.

Falenderoj Prof. Dr. Ilia KRISTO për angazhimin dhe përkushtimin e treguar gjate tre viteve të fundit.

Falenderoj koleget e Departamentit të Marketingut për mbështetjen dhe ambjentin e ngrohtë.

Falenderoj familjen për ndihmesën dhe mbështetjen që më kanë dhënë gjatë gjithë kësaj periudhe.

Pasqyra e lëndës

<i>Abstrakt</i>	6
------------------------	----------

<i>HYRJE</i>	7
---------------------	----------

KAPITULLI I

1. RISHIKIMI I LITERATURËS DHE ASPEKTE KONCEPTUALE	10
1.1 Çfarë është Pastrimi i Parave?	11
1.2 Pastrimi i parave dhe evazoni fiskal	17
1.3 Qendrat financiare off-shore	25
1.4 Identifikimi i Pronësisë përfituese fundore	39
1.5 Personat e ekspozuar politikisht PEP	45
1.6 Zhvillimet teknologjike dhe Pastrimi i Parave	48

KAPITULLI II

2. METODOLOGJIA E KËRKIMIT	52
2.1 Metodologjia	52
2.2 Kufizime të punimit	54
2.3 Pyetjet kërkimore	55

KAPITULLI III

3. PREZANTIMI I GJETJEVE TË STUDIMIT	56
3.1 Pyetja kërkimore 1	57
3.2 Pyetja kërkimore 2	70
3.3 Pyetja kërkimore 3	82
3.4 Pyetja kërkimore 4	86
3.5 Pyetja kërkimore 5	91
3.6 Pyetja kërkimore 6	102

KAPITULLI IV

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	109
4.1 Konkluzione	109
4.2 Rekomandime	114
Bibliografia	119

APENDIKSET

APENDIKS I Intervistë e gjysmë-strukturuar	124
APENDIKS II Kuadri ligjor dhe rregullativ	129

Pasqyra e tabelave

Tabela 1. Evazioni fiskal si pjesë e të ardhurave kriminale në SHBA në miliarda Dollarë	22
Tabela 2. 12 Qendrat më të mëdha bankare, të renditura për nga asetet	29
Tabela 3. Një guidë për 6 parajsat fiskale më të njohura në botë	30
Tabela 4. Lehtësia e të bërit biznes	37
Tabele 5. Vlerësimi i sektorit/institucionit në lidhje me korrupsionin	47
Tabela 6. Të dhëna për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare në QKR	60
Tabela 7. Të dhënat shtesë të shoqërive anonime në QKR (nenit 36, ligj i QKR)	62
Tabela 8. Të dhënat që kërkohen në QRA për regjistrimet elektronike të aksioneve	63
Tabela 9. Të dhënat për identifikimin dhe regjistrimin e klientit (neni 5, ligji 9917)	68
Tabela 10. Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja	72
Tabela 11. Dokumentacion shtesë për ortakun person juridik të huaj	73
Tabela 12. Masa për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj PEP-ve	83
Tabela 13. Detyrimet raportuese të subjekteve	93

Pasqyra e grafikëve

Grafiku 1. Pyetja kërkimore 1	58
Grafiku 2. Pyetja kërkimore 2	71
Grafiku 3. Pyetja kërkimore 3	82
Grafiku 4. Pyetja kërkimore 4	87
Grafiku 5. Pyetja kërkimore 5	92
Grafiku 6. Pyetja kërkimore 6	102
Grafiku 7. RAD të raportuara në DPPPP në vitin 2007	104

Pasqyra e figurave

Figura 1. Cikli i plotë i kryerjes së pastrimit të parave	14
Figura 2. Paraqitje skematike e pronësisë përfituese shumështrësore	40

Abbreviation

DNFBP	Designated non-financial businesses and professions
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
PPP/FT	Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimi i Terrorizmit
FATF	Financial Action Task Force
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
FATCA	Foreign Account Tax Compliance Act
NIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
PEP	Personat e ekspozuar politikisht
ECSDA	European Central Securities Depositories Association
QRA	Qendra e Regjistrimit të Aksioneve
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
RTV	Raport i transaksioneve të vlerave
RAD	Raport i aktivitetit të dyshimtë
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
ILDKP	Instituti i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
GFI	Global Financial Integrity
TJN	Tax Justice Network
FSI	Financial Security Index
OKB	Organizara e Kombeve të Bashkuara
SWIFT	Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BSH	Banka e Shqipërisë
IRS	Internal Revenue Service
MONEYVAL	The Committee of Experts on the Evaluation of Anti-Money Laundering
TIA,	Transparency International Albania
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
GDP	Gross Domestic Product

ABSTRAKT

Pastrimi i Parave është një fenomen që përdoret me qëllim fshehjen e burimit të të ardhurave që vijnë nga aktivitete kriminale. Pamvarësisht se mund të sjellë likuiditet në ekonominë e një vendi në një periudhë afatshkurtër, pastrimi i parave dëmton ekonominë e vendit në periudha afatgjata dhe çënon integritetin e sistemit financiar dhe të shtetit të së drejtës. Parandalimi i këtij fenomeni do të përmirësonte mjedisin politiko-ligjor dhe do të ishte një vlerë e shtuar për klimën e biznesit në vendin tonë. Punimi fokusohet në sfidat që përballen subjektet raportuese ligjore financiare (kryesisht bankat) dhe profesionet e lira jofinanciare në kuadër të zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ të parandalimit të pastrimit të parave. Në fokus janë edhe rekomandimet e nevojshme për ndryshime ligjore dhe rregullative, të cilat do të çojnë në një lehtësim qoftë të aktivitetit operacional të subjekteve financiare dhe jofinanciare si dhe në përmirësimin e efikasitetit të përpjekjeve për të rritur funksionimin e parandalimit të pastrimit të parave në vendin tonë. Duke analizuar çështje që shqetësojnë subjektet ligjore dhe ato kompetente të zbatimit të ligjit të tilla si identifikimi i pronarëve përfitues të korporatave shumë-shtetore, PEP, kompleksiteti i sekretit bankar të parajsave fiskale “off-shore”, lidhja ndërmjet pastrimit të parave dhe evazionit fiskal, detyrimet ligjore raportuese të njëjta si për institucionet financiare ashtu dhe për ato jofinanciare, natyrshëm lind nevoja e ndryshimeve të rëndësishme ligjore dhe rregullative në lëmin e parandalimit të pastrimit të parave.

HYRJE

Mjedisi politiko-ligjor luan një rol të drejtpërdrejtë në përcaktimin e objektivave dhe strategjive të personave fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari fitimprurëse dhe është i rëndësishëm si për kompanitë vendase ashtu edhe për ato ndërkombëtare. Në përgatitjen e strategjive marketing, mjedisi politik dhe ligjor është një hallkë e rëndësishme e cila nuk mund të anashkalohet. Faktorët e jashtëm të mjedisit përfshijnë analizën konsumatorit, analizën e konkurrentit, analizën e tregut të synuar, si dhe vlerësimin e çdo elementi të mjedisit teknologjik, ekonomik, kulturor apo politik / ligjor që ka të ngjarë të ndikojë në sukses, *Aaker (2008)*.

Si pjesë e mjedisit politiko-ligjor, parandalimi i pastrimit të parave ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimarrjen operationale të kompanive financiare dhe subjekteve të lira jofinanciare. Subjektet financiare dhe jofinanciare marrin në konsideratë kërkesat rregullative në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave para se të vendosin të ushtojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Bizneset kanë në vëmendjen e tyre parësore maksimizimin e fitimeve por nëse ofrojnë produkte apo shërbime për klientë të dyshimtë, mund të përballen me kundërvajtje administrative dhe penale. Mënjanimi i riskut reputacional, i cili *është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare të shkaktuara nga rënia e reputacionit në veprimtarinë e subjektit, si rrjedhojë e opinionit negativ të publikut ndaj subjektit* (Vendim nr. 03, BSH), bëhet pjesë integrale e vendimarrjes. Kryerja e transaksioneve në mënyrë të përsëritur mund të çojë në heqjen e licensës për të operuar në treg dhe heqjen e së drejtës për të kryer aktivitetet.

Institucionet bankare dhe profesionet e lira jofinanciare, krahas përcaktimit të nevojave dhe dëshirave të tregut, duhet të kujdesen që të përmbushin detyrimet e kuadrit rregullativ në fuqi. Bankat vlerësojnë ndikimin rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në varësi të rrethanave individuale. *Reputacioni i subjektit financiar lidhet me dëmin që mund ti shkaktohet bankës nga përfshirja (qoftë edhe pa qëllim) në një marrëdhënie biznesi apo transaksion, si rezultat i veprimtarive të paligjshme dhe mund të çojë në vendosjen e sanksioneve nga organet kompetente ose në largimin e klientëve nga subjekti* (Vendim nr. 55, BSH mbi PPP/FT).

Fenomenit të pastrimit të parave i është dhënë rëndësi e veçantë vitet e fundit. Një dekadë më parë, klientët me depozita të mëdha trajtoheshin si të një rëndësie të veçantë. Banka do të vihej në

lëvizje për të përmbushur nevojat dhe kënaqësitë e dëshiruara në mënyrë më efektive sesa bankat konkurrense. Tashmë kjo nuk është e mjaftueshme. Klientët duhet të analizohen me detaje nga strukturat e bankës. Menjëherë ngrihen pyetje të tilla si: cili është burimi i të ardhurave të klientit? Nga vjen një shumë relativisht e madhe në para fizike? A përputhet qëllimi i transaksionit me aktivitetin e klientit? etj. Ekzistenca e pasurive, apo kryerja e transaksioneve me vlera shumë më të larta në krahasim me atë që mund të pritët nga profili i klientit, shërben si sinjal që një klient të vlerësohet potencialisht si me rrezik të lartë dhe duhet të raportohet si i dyshimtë.

Institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe autoritetet ligjvënëse në rang kombëtar janë duke marrë masa shumë shtërnguese për të parandaluar dhe zbutur fenomenin e pastrimit të parave. Problematika është sa globale aq edhe nacionale. Qendrat financiare “off-shore” janë një realitet që prekin qoftë vendet e zhvilluara por dhe vendet në zhvillim si në rastin tonë. Subjektet ligjore të përcaktuara në ligjin organik të parandalimit të pastrimit të parave dhe veçanërisht institucionet financiare banka përballen me sfida serioze në implementimin e kuadrit rregullativ në praktikë. Nevojiten ndërhyrje dhe amendime në aktet ligjore dhe nënligjore për një përmirësim të mëtejshëm të punës së subjekteve ligjore. Këto përmirësime përbëjnë objektivin kryesor të kësaj teme.

Qëllimi i studimit është evidentimi i sfidave që përballen subjektet financiare bankare dhe profesionet e lira jofinanciare në zbatim të kërkesave rregullative të PPP si dhe masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut reputacional me të cilin përballen këto subjekte.

Objektivat që synohen të realizohen nëpërmjet këtij punimi janë:

1. Studimi i marrëdhënies së ngushtë ndërmjet fenomenit të pastrimit të parave dhe evazionit tatimor.
2. Analizimi i hendekut në kuadrin rregullativ Shqiptar sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të “Pronarit përfitues”.
3. Vlerësimi i parajsat fiskale “off-shore” si juridiksione të përshtatshme për fshehjen e strukturës së pronësisë përfituese.
4. Analizimi i problemit të identifikimit të plotë të PEP-ve dhe transaksioneve të kryera prej tyre.
5. Shqyrtimi i detyrimit të ekzagjeruar të raportimit të profesioneve të lira jofinanciare pranë autoriteti përgjegjës.

6. Sugjerimi i një sërë amendimesh rregullative që do të bëntë të mundur uljen e rrezikut reputacional me të cilin përballen subjektet raportuese.

Nga eksperiencia e deritanishme në vendin tonë nuk është kryer ndonjë punim kërkimor-shkencor lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave me të cilat përballen subjektet raportuese financiare dhe jofinanciare. Studimi nxjerr në pah sfidat kryesore që proekupojnë subjektet raportuese, kryesisht institucionet financiare dhe profesionet e lira, në përpjekjet e tyre për parandalimin e pastrimit të parave dhe evazionit fiskal. Propozohen përmirësimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe rregullativ për të qartësuar më tej obligimet reale që duhet të kenë subjektet e raportuese. Punimi kornizohet në kuadrin rregullativ me impakt të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e rrezikut reputacional në industrinë bankare dhe profesionet e lira jofinanciare.

KAPITULLI I

1. RISHIKIMI I LITERATURËS DHE ASPEKTE KONCEPTUALE

Rishikimi i literatures përfshin aspektet konceptuale të pastrimit të parave, lidhjen e tij me evazionin fiskal, ndikimin e qendrave financiare “off-shore” në pastrimin e parave, identifikimin e pronësisë përfituese fundore të korporatave, personat e ekspozur politikisht si dhe ndikimin e zhvillimeve teknologjike në pastrimin e parave.

Në këtë kapitull sqarohen konceptet themelore që kanë të bëjnë me fenomenin e pastrimit të parave, metodat e kryerjes së tij si dhe problemet ekonomiko-sociale që sjellë në shoqëri. Ky kapitull do të shërbejë si një vitrinë informuese në lidhje me dinamikën e pastrimit të parave dhe domosdoshmërine e rritjes së masave parandaluese për zbutjen e pasojave që vijnë prej tij. Do të analizohet një aspekt shumë i rëndësishëm i parandalimit të pastrimit të parave që është lidhja e tij me evazionin fiskal. Deri më tani, këto fenomene janë parë si të ndara por kriza financiare dhe shmangia e pagimit të taksave ka bërë që situata të shikohet krejt ndryshe pasi metodat e përdorura nga të dy proceset janë të ngjashme.

Kapitulli përqëndrohet tek parajsat fiskale “off-shore”, të cilat karakterizohen nga një numër relativisht të madh të institucioneve financiare të angazhuara kryesisht në biznes me jorezidentë dhe ushtrojnë një sekret relativisht të madh në lidhje me identifikimin e pronësisë përfituese të kompanive dhe sekret të lartë bankar. Si një dukuri e globalizimit dhe ekonomisë së tregut, transaksionet me vendet “off-shore” janë tashmë prezente edhe në vendin tonë. Rrjedhimisht bashkërendimi i punës së institucioneve financiare dhe kompetente në rang global është mëse i domosdoshëm.

Analizohen çështje që kanë të bëjnë me identifikimin dhe verifikimin e klientve nga subjektet ligjore. Institucionet financiare bankë dhe profesionet e lira jofinanciare duhet të marrin masa konkrete për identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore.

Në këtë kapitull gjithashtu shqyrtohet koncepti i identifikimit të personave të ekspozuar politikisht dhe preken çështje të tilla si zhvillimet e reja teknologjike dhe krimi kibernetik “Cybercrime”.

1.1 Çfarë është Pastrimi i Parave?

Fenomeni i Pastrimit të Parave konsiderohet si “Themra e Akilit” e Sistemit Kapitalist (*Baker 2005*). Lufta ndaj këtij fenomeni ka marrë një rëndësi të veçantë sidomos në dekadat e fundit për shkak të efekteve negative që sjell në ekonomine globale dhe rajonale, gjë që ka çuar në ndryshime dinamike ligjore dhe rregullative si në vendet e zhvilluara ashtu dhe ato në zhvillim. Këto ndryshime në kontekstin ndërkombëtar kanë përfshirë edhe vendin tonë kryesisht në dhjetë vjeçarin e fundit.

Megjithëse është një fenomen që i është kushtuar një vëmendje e veçante kohët e fundit, elementë të tij i gjejmë në shekullin e 15 në Firence të Italisë. Bibla dhe Kurani, dënojnë kreditimin e parave me interes, e cila është baza e shumicës së operacioneve bankare konvencionale. Pra, në shumë pjesë të Krishtëritimit, pastrimi i parave u ishte lënë hebrenjve (*Parks 2005*). Në disa qytete veriore të Italisë mesjetare, filluan të gjendeshin mënyra për të shmangur këtë pengesë. Kjo bëri që të krijohen dhe rriten mënyra të reja për të fshehur fitimin, duke përfshirë edhe marrëveshjet e monedhës dhe tregtinë trekëndore. Bankierët e asaj kohe filluan të financonin veprat fetare të artit si një forme spirituale e pastrimit të parave. Afreske të kushtueshme të vulosura me vulën e familjes “Medici”, të cilat këmbëheshin me ar, ishin shenjat e para të dyshimta të krijimit të pasurisë. Një financë e tillë e nivelit të lartë jo vetëm financoi artin e nivelit të lartë, por paratë dhe lëvizja e fondeve ndihmoi për të nxitur idealet humaniste që frymëzuan Rilindjen (*The Economist, 2011*).

Pastrimi i parave është: *“Konvertimi ose transferimi i pasurisë, duke ditur se kjo pasuri rrjedh nga krimet e rënda, me qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë ose ndihma dhënë çdo personi i cili është i përfshirë në kryerjen e një vepre të tillë ose vepra për të shmangur pasojat juridike të veprimt të tij, si dhe fshehja ose maskimi i natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtat në lidhje me pronësinë, duke e ditur se kjo pasuri rrjedh nga krimet e rënda (Konventa e Komunitetit Evropian mbi PPP).*

Pastrimi i “produkteve të veprës penale” kryhet nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë). Produkte të veprës penale, përfshijnë çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale.

Pastrimi i parave është procesi i lëvizjes së fondeve të gjeneruara në mënyrë ilegale në një rreth transformimesh për të krijuar një aparençë legale të këtyre fondeve dhe duke fshehur origjinën e tyre ilegale. Parate e “pista” vijnë kryesisht nga droga, prostitucioni, krimi i organizuar, korrupsioni, personat e ekspozuar politikisht të korrumpuar sidomos në vendet diktatoriale etj.

Industria financiare bankare është subjekti më i rëndësishëm raportues pranë Autoritetit Përgjegjës i cili në vendin tonë është DPPPP. Autoriteti Mbikëqyrës për institucionet financiare bankare është Banka Qendrore e Shqipërisë.

Profesionet e lira jofinanciare janë avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjorë, ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistët e miratuar të pavarur, zyrat e konsulencës financiare dhe profesionet e rregulluara, që ofrojnë shërbimet e konsulencës financiare kur përgatisin ose kryejnë transaksione për klientët e tyre për veprimtaritë të tilla si: kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të asetëve të tjera; administrimin e llogarive bankare; administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare; krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore; marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare (Ligji

Nr.9917 mbi PPP/FT). Gjithashtu tek profesionet e lira jofinanciare përfshihen: *agjentët e pasurive të paluajtshme, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për këtë kategori, kur përfshihen në transaksione për klientët e tyre, që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme (Ligji Nr.9917 mbi PPP/FT)*. Profesionet e lira jofinanciare kanë gjithashtu autoritetet përkatëse për mbikëqyrjen e tyre, si për shembull: Dhoma Kombëtare e Avokatisë për avokatët; Ministria e Drejtësisë për noterët etj.

FATF e cila merret me Standardet Ndërkombëtare të Luftës kundër pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit, përcakton se pastrimi i parave kryhet nëpërmjet tre fazave kryesore si më poshtë:

- **Vendosja** - vendosja e përfitimeve të paligjshme në sistemin financiar, ose përdorja e tyre për të blerë mallra me vlerë të lartë, prona apo pasuri të paluajtshme.
- **Shtresëzimi ose Tjetërsimi** - përfshin shndërrimin e të ardhurave të jashtëligjshme në një formë tjetër për të fshehur gjurmët. Përdorimi i këtyre fondeve për një sërë transaksionesh financiare të ndërlikuara si për shembull: blerja e instrumentave të investimit, blerja e të mirave dhe shërbimeve etj. Fondet mund të transferohen jashtë vendit dhe të depozitohen në sistemin bankar, shpesh duke përdorur kompanitë “guaskë” ose fonde të maskuara si të ardhura nga biznesi i ligjshëm. Mallrat / asetet mund të rishiten. Gjithë këto transaksione bëhen për të mbuluar burimin e të ardhurave.
- **Integrimi** - në fazën e tretë fondet rihynë në ekonominë legjitime dhe mund të përdoren në pasuri të paluajtshme, ndërmarrje biznesi etj. Të ardhura e “pastruara” përdoren në ekonomi duke ju dhënë një pamje “të ligjshme”. Transferrat komplekse elektronike lokale dhe ndërkombëtare e bëjnë gjetjen e burimit origjinal të fondeve praktikisht të pamundur.

Disa nga këto hapa, në varësi të rrethanave, mund të mos jenë të nevojshme. Shpesh herë dallimi mes fazave të mësipërme është i vështirë sepse mund të përdoren kombinime të tyre njëko hësisht. Për shembull, të ardhurat që janë tashmë në sistemin financiar nuk kanë nevojë për tjetërsim. Figura nr.1 përmban skemën tipike të pastrimit të parave dhe përdoret më së shumti nga ekspertët trainues të parandalimit të pastrimit të parave.

Figura 1. Cikli i plotë i kryerjes së pastrimit të parave

*Burimi: Money Laundering in EU*

Pastrimi i parave, merr forma të ndryshme dhe tipologjitë kryesore përfshijnë “smurfing”, bizneset të bazuara në “cash”, manipulimi i faturave tregtare, transaksionet me pasuri të paluajtshme etj.

Metoda “smurfing” - përfshin përdorimin e transaksioneve të shumta në para, secila me vlerë më të vogël se sa kërkesa për raportim (Quirk 1997). Bizneset e bazuara në “cash” mund të përdorin paratë legjitime dhe paratë që rrjedhin nga vepra penale, duke pretenduar se të gjitha të ardhurat janë legjitime. Manipulimi i faturave tregtare përfshin nën ose mbi-vlerësimin e faturave në mënyrë që të fshihen lëvizjet e parave. Kompanitë multinacionale dërgojnë flukse të mëdha parash të cilat janë nën ose mbi vlerën e çmimit të transaksioneve në degët e tyre, në mënyrë që të zhvendosin fitimet në juridiksionet me përqindje të ulta të taksimit.

Transaksionet me pasuritë e paluajtshme përfshijnë transaksione me prona të paluajtshme të cilat mund të blihen me të ardhura ilegale, dhe pastaj të shiten. Çmimi i pronës është i manipuluar, shitësi do të bjerë dakord fillimisht për një kontratë që nën-përfaqëson vlerën reale të pronës. Përdoren gjerësisht korporatat me qendër në parajsat fiskale “off-shore” të cilat kanë një shkallë të lartë të sekretit bankar dhe të fshehjes së strukturës së pronësisë përfituese të korporatave.

Fondet që vijnë nga jashtë, në shuma të mëdha dhe të shpeshta në drejtim të llogarive ose marrdhënieve të vendosura në një vend nga kompani që kanë pronar persona me qendër në vende me rrezik të lartë ose që tregojnë transaksione jo tipike të biznesit apo aktivitetit dhe që shoqërohen nga tërheqje të mëdha “cash” nga këto vende. Blerje dhe shitje të herëpashershme të instrumenteve financiare, nga dy ose më tepër persona, veprim i cili sugjeron një bashkëpunim në transferimin e fondeve, veçanërisht nëse transaksionet kryhen me çmime të ndryshme nga ato të tregut, dhe që fillojnë dhe përfundojnë në kohë të shkurtra dhe përshijnë instrumente që tregtohen pak (*Rregullore 55 e BSH mbi PPP/FT*).

Ekzistojnë shumë mënyra ku pastruesit e parave mund të mbulojnë transaksionet e tyre duke përdorur profesionet e lira jofinanciare. Shërbimet e ofruara nga kontabilistët, të cilat mund të keqpërdoren në operacionet e pastrimit të parave, përfshijnë si më poshtë (*Udhëzues i FATF për kontabilistët 2008*):

- Krijimi i kompanive ose entiteteve të tjera të ndërlikuara ligjore (si trustet), të cilat mund të fshehin lidhjen mes të ardhurave nga krimi dhe pronarëve përfitues me historik kriminal.
- Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme, ku transferimi i titullit të pronësisë së paluajtshme është përdorur për të mbuluar transferimin e paligjshëm të fondeve (faza e vendosjes) ose investimi final i të ardhurave përmes operacioneve të pastrimit të parave (faza e integritit).
- Ekzekutimi i operacioneve financiare në emër të klientëve si depozita ose tërheqje parash, operacionet e këmbimit valutor, shitja dhe blerja e aksioneve, dërgimi dhe marrja e transfertave ndërkombëtare të parave.

Këshilla financiare dhe tatimore janë pjesë përbërëse e pastrimit të parave. Shkelësit e ligjit me sasi të madhe parash për të investuar, mund të paraqiten si individë që shpresojnë të minimizojnë detyrimet e tyre tatimore ose dëshirojnë ti vendosin pasuritë e tyre jashtë rrezes së detyrimeve fiskale. Juristet mund të ndihmojnë në paraqitjen e padive fiktive për të marrë një gjykim të favorshëm për të legjitimuar fondet e fituara në mënyrë ilegale.

Institucionet ndërkombëtare si FATF dhe organet përgjegjëse dhe mbikëqyrëse të vendeve përkatëse, përmbledhin në aktet e tyre nënligjore një numër transaksionesh që duhet të trajtohen

me kujdes nga subjektet financiare bankë dhe profesionet e lira jofinanciare pasi përmbajnë elemente të dyshimtë të pastrimit të parave.

Ka disa zëra të cilat besojnë se gjatë procesit të pastrimit të parave që vijnë nga produkte të veprave penale, ekonomia e një vendi do të ketë rritje të likuiditetit të paktën në një periudhë afatshkurtër. Duke patur parasysh rënien ekonomike në rajon ku remitancat në vend kanë pësuar një ulje të ndjeshme, çdo formë likuiditeti pamvarësisht nga burimi i të ardhurave do të ndihmonte ekonominë Shqiptare.

Efektet afatgjata në jetën ekonomike dhe sociale të një vendi të shkaktuara nga pastrimi i parave, janë shumë më tepër negative se ato pozitive. *Vendet në zhvillim që tërheqin "paratë e pista" si një motor afatshkurtër i rritjes, mund të hasin vështirësi më vonë për të tërhequr investime solide të huaja të drejtpërdrejta afat-gjata që kërkojnë kushte të qëndrueshme dhe qeverisje të mirë dhe që mund të ndihmojnë në mbajtjen gjallë të zhvillimit dhe në nxitjen e rritjes ekonomike afatgjatë (UNODC). Pastrimi i parave dhe evazoni fiskal japin një impakt negativ në integritetin e sistemit bankar dhe financiar, në ndryshimet e pakuptueshme të kërkesës për para dhe në konkurrencën e ndershme (McDowell, Novis 2001).*

Pastrimi parave është një aktivitet kriminal afatgjatë dhe i vazhdueshëm, kryhet zakonisht në grup, shpesh herë nga më shumë se një person dhe ka një skopë të gjerë ndërkombëtar. Pastrimi i parave dhe evazoni fiskal jepen një impakt negativ edhe mbi shoqërinë në përgjithësi, pasi duke përdorur para jo të ligjshme, krimi i organizuar mund të infiltrojë në institucionet shtetërore dhe të marrë kontrollin e sektorëve të mëdhenj të ekonomisë. Pastrimi i parave sjell implikime të pafavorshme për vendet në zhvillim, si dëmtim reputacioni dhe imazh negativ ndërkombëtar (*Banka Botërore 2013*).

Globalizimi dhe njohja e rëndësisë së ruajtjes së konkurrencës së ndershme kërkon një qasje të veçantë në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe evazionin fiskal. Pasojat afatgjata janë shumë të dëmshme dhe ndikojnë në frenimin e përparimit ekonomik dhe politik të një vendi. *Varfëria dhe pabarazia përkeqësohen; ulen të ardhurat tatimore të qeverisë; zvogëlohen shpenzimet shëndetësore dhe të arsimit; dëmtohet konkurrenca e lirë dhe rritja ekonomike; dekurajohen investimet e huaja direkte; ngadalësohet krijimi i ndërmarrjeve të reja; paratë*

publike kanalizohen në fushën e mbrojtjes dhe të infrastrukturës ku fitimet janë zakonisht të larta; rritet barra e borxhit në vendet e varfëra (Baker 2005).

Pastrimi i parave ka gjasa të zgjerojë ekonominë “në të zezë”, minon sistemin financiar dhe ngre pikëpyetje mbi kredibilitetin dhe transparencën e tij. *Vende të tëra janë gjunjësuar nga aktiviteti kriminal dhe kërkesa për ti kthyer të ardhurat e fituara në mënyrë të pandershme në një monedhë universalisht të pranueshme (kryesisht dollarë amerikanë). Kolumbia është një shembull i qartë; Meksika po i afrohet me shpejtësi të njëjtës situatë (Lilley 2006).*

I tërë shteti mund të “bjerë”. *Kontrabanda në Kolumbi është pjesë e operacioneve shumë miliardë dollarëshe të pastrimit të parave që dëmtojnë biznese të ligjshme, duke minuar mundësinë e Kolumbisë për të rigjetur veten si një ekonomi e lulëzuar pas dekadash të dhunës politike dhe drogës. Paratë e fituara nga trafiku i drogës, korrupsioni, tregtia e armëve, prostitucioni, dhe minierat ilegale të arit duhet të pastrohen. Pasi këto të ardhura hyjnë në ekonominë kolumbiane, fryjnë shifrat reale të rritjes ekonomike. Një pastrues parash është i interesuar vetëm në injektimin e parave në sistem. Këto para krijojnë vuajtje, deformojnë ekonominë dhe ndryshojnë çmimet e referencës, pasi pastruesi i parave nuk kujdeset nëse ai humbet të hollat, vetëm ajo që mbetet të jetë e pastruar (Reuters 2013).*

Pastrimi i parave inkurajon krimin për shkak se mundëson që kriminelët të përdorin në mënyrë efektive fondet e tyre të paligjshme. Shoqëria mund të “kriminalizohet” dhe të minohet besimi tek institucionet kyçe. Kriminelët mund të rrisin fitimet duke i riinvestuar fondet ilegale në biznese. Si pasojë e zvogëlimit të të ardhurave tatimore të qeverisë dhe dobësimit të kontrollit qeveritar mbi ekonominë, vlerat sociale dhe shteti i së drejtës vihen në pikëpyetje. Duke qenë se tashmë jetojmë në një “fshat global”, fenomene të tilla depërtojnë nëpër sektorë të ndryshëm të ekonomisë deri në nivel global.

1.2 Pastrimi i parave dhe evazioni fiskal

Një aspekt shumë i rëndësishëm i parandalimit të pastrimit të parave, i cili ka ngjallur shumë debate kohët e fundit tek ligjvënësit dhe në fushën e biznesit, është lidhja e tij me evazionin fiskal.

Deri më tani, këto fenomene janë parë si të ndara por kriza financiare dhe shmangia e pagimit të taksave ka bërë që situata të shikohet me sy mjaft kritik. Marrëdhënia në mes të pastrimit të parave dhe evazionit tatimor është një temë shumë komplekse që është duke u adresuar nga organizata ndërkombëtare dhe ligjvënësit në mbarë botën. Metodot e përdorura nga të dy proceset janë shumë të ngjashme dhe duhet të analizohen më në detaje.

Nga përkufizimi, pastrimi i parave mund të bëhet vetëm kur ekziston një krim themelor i cili rrit të ardhurat e paligjshme të cilat pastrohen më vonë, duke u futur në qarkullim në ekonominë e ligjshme (Unger 2009). Ndër krimet themelore për pastrimin e parave mund të përmendim, drogën, prostitucionin, krimin e organizuar etj. Të ardhurat që vijnë nga krime të tilla tentohen të pastrohen në fshehtësi.

Fshehja e detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve false, deklaratave të pavërteta apo informacioneve joreale, vlerësimi i të cilave çon në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion fiskal dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt (Ligji për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”). Evazoni fiskal përbën veper penale kur personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, dënohet kur me dashje përpiqet të kryejë evazion tatimor.

Evazoni fiskal çon në pastrimin e produkteve të veprës penale dhe përbën krim. Duke parë ngjashmëritë ndërmjet tyre, ka shumë zëra për një qasje të re në trajtimin e fenomeneve të pastrimit të parave dhe evazionit fiskal që do të çonte në përfshirjen e transaksioneve me natyrë të evazionit fiskal në lupën e kërkesave të kuadrit rregullativ të PPP. Nga praktika e deritanishme duke parë përkufizimet ligjore të pastrimit të parave dhe zbatimet e ligjit në vende të ndryshme, një pjesë e madhe e evazionit fiskal shpesh përjashtohet nga përkufizimet e pastrimit të parave.

Ka patur gjithmonë debate nëse shmangia e taksave duhet futur si krim themelor i pastrimit të parave. Kjo vjen përshkak të konfuzitetit që ndodh në definicionet e këtyre fenomeneve. “*Shkeljet tatimore bien në kufirin e asaj që është dhe nuk është konsideruar si pastrim parash, për faktin se paratë që një person ligjërisht merr nuk mund të pastrohen. Kjo është ilustruar nga rasti vijues. Nëse një person merr 100 £ për punën dhe është i detyruar të paguajë një normë marxhinale rreth 40% të tatimit mbi të ardhurat dhe nuk deklaron të ardhurat, atëherë shuma prej £ 40 është*

konsideruar si e vjedhur nga Thesari i Shtetit. Prandaj, nuk është pastruar vlera prej 100 £, por është pastruar vetëm 40 £, domethënë pastrimi i tatimit të shmangur” (Money laundering in EU, people.exeter.ac.uk).

Paratë që krijohen nga evazioni konsiderohen të “pista” dhe qëndrojnë të tilla deri në çastin kur tentohet të “pastrohen”. Shmangësit fiskal, në një moment të dytë, do të mundohen ti riciklojnë dhe integrojnë fondet e pastuara në sistemin financiar duke i dhënë një pamje përfundimtare të ligjshme. Ky arsyetim na çon në përfundimin se metodat e përdorura nga të dy proceset janë të ngjashme.

Ligji për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor parashikonte faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor, kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe kompetencat e organeve të administratave tatimore e doganore, të cilat evidentojnë tatimpaguesit/debitorët që përfitonin nga ky ligj. Ligji parashikonte faljen pa pagesa në favor të Buxhetit të Shtetit të të gjitha detyrimeve tatimore të personave fizikë, të regjistruara si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël, të mbetura të papaguara e që i përkasin periudhës tatimore deri më 31 Dhjetor 2010 si dhe të gjitha detyrimet tatimore të papaguara të individëve për periudhën tatimore deri më 31 Dhjetor 2010 (*Ligji “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” 2011*).

Ligji parashikonte faljen e detyrimit tatimor për tatimpaguesit, persona juridikë, apo tatimpaguesit të regjistruar si subjekt i TVSH-së për periudhën 2009 – 2010 përkundrejt pagimit të një shume të caktuar mbi principalin si dhe faljen e gjobave të lidhura me detyrimin për t'u pajisur me paisje fiskale. Koha e zbatimit që subjektet të përfitonin nga legalizimi dhe falja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të ushtrohej deri në datën 31 dhjetor 2011. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatoheshin për kapitalin që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” (2009) si dhe për kapitalin e përfituar si rezultat i veprave penale të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

Efekti i këtij ligji në arkën e shtetit ishte jo i kënaqshëm dhe nuk u arrit qëllimi për të cilin u dekretua. Me gjithë lehtësitë e krijuara nga tatimi, si për shembull komisione të ulta për legalizimin

e kapitalit, efekti i ligjit ishte shumë më i paktë nga sa pritej. Shumë individë kërkonin që ligji për legalizimin të shoqërohet me më shumë garanci për mos përndjekje penale në të ardhmen. Personi i cili me dashje kryejn evazion tatimor dënohet në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Shtetasit Shqiptare janë të vetëdijshëm se paratë e ardhura nga evazioni janë të fituara në mënyrë të paligjshme dhe si të tilla janë “të pista”. Ligji i legalizimeve në këtë mënyre bie ndesh me kodin penal dhe ky i fundit prevelon.

Ligji mund të kishte efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit nëse legalizimi zbatohet për të gjitha llojet e krijimit të kapitalit në mënyrë të paligjshme. Por kjo do të sillte një reaksion të madh brenda dhe jashtë vendit. Madje edhe për amnistine fiskale të propozuar nga ky ligj ka patur kontestime të shumta nga individë dhe biznese që paguanin rregullisht taksat dhe punonin në mënyrë të ndershme. Por reagimi më i madh me siguri do të vinte nga ndërkombëtarët që kurrësesi nuk do të lejonin dekretimin e ligjeve që legalizojnë kapitale të fituara në çdo lloj forme, përfshirë burime të paligjshme kriminale.

Një fenomen i tillë është vënë re në Pakistan. *Zemra financiare kaotike e Pakistanit është shtëpia e 18 milionë njerëzve, talebanë, vrasës me pagesë si dhe një nga tregjet më të suksesshme në botën e aksioneve. Me 49 për qind në kthim në vitin 2012, Karaçi Stock Exchange (KSE) ishte një nga pesë tregjet më të mira performuese në botë. Tani KSE është duke kërkuar për një partner të huaj për të blerë një pjesë të aksioneve dhe të marrë përsipër menaxhimin e një tregu që është rritur tre-fish gjatë katër viteve të fundit. Pjesë e kesaj performance erdhi si rrjedhojë e një amnistie të qeverisë e cila lejoi shtetasit që mbanin pasuritë e padeklaruara ose "para në të zezë" për ti investuar lirshëm në treg dhe për të blerë aksione pa u pyetur fare në lidhje me burimin e parave (Reuters, 2013).* Normalisht veprime të tilla mund të krijojnë një rreth vicioz dhe të ndihmojnë krimin e organizuar pasi politika dhe paratë e pista janë të lidhura në vënde të tilla.

Niveli i ekonomisë informale Shqipëri arrin në nivelin 25 – 30% të Produktit të Brendshëm Bruto të vendit dhe që ka impaktin e saj në ekonominë Shqiptare. *Ndonëse na mungojnë të dhënat për matjen e ekonomisë informale (më mirë të themi se na mungon konsensusi për një metodologji) shifrat nga institucione të ndryshme tregojnë se ekonomia informale është rreth 30 për qind nga INSTAT në 60 për qind nga vlerësimet institucione financiare ndërkombëtare (Meksi & Pasha 2004).* Kjo është një sfidë që duhet të përballemi në të ardhmen. Ekzistenca e një ekonomie

informale, të përmasave të tilla, mund të përbëjë një fakt domethënës në lulëzimin e evazionit fiskal dhe pastrimit të parave. Vështirësitë në ndjekjen e fluksit të parave “cash” dhe identifikimin e personave të përfshirë përbëjnë një problem serioz për identifikimin e transaksioneve të evazionit fiskal apo pastrimit të parave.

Në këto kushte, edhe pse ligji mbi legalizimin e kapitalit supozohej të kishte efekte rregullatore të mëpasme në treg, raste të reja të evazionit fiskal nuk kanë munguar. Administrata tatimore në vendin tone ka zbuluar skema evazioni fiskal, përmes së cilës janë qarkulluar miliona dollarë. Niveli ekonomisë informale krijon mundësinë që fondet e gjeneruara nga aktivitetet e evazionit fiskal apo kriminaliteti të integrohen në ekonominë formale dhe krijohen kushte të favorshme për fazen e dytë të pastrimit të parave, shtresëzimin, apo të tretën - integrimin e fondeve në sistemin financiar dhe ekonomik të vendit.

Personat të cilët angazhohen në pastrim parash apo evazion fiskal kanë një tendencë për të korruptuar tërë sistemin ekonomik, ligjor dhe shoqëror të një vendi dhe atë global. *Firmat jo të gatëshme për të paguar rryshfet po humbasin gjithnjë e më shumë terren, përballë konkurrentëve të tillë si ato rusë dhe në rritje ato kineze. Bizneset frikësohen se po të mbajnë qëndrim do të ballafaqohen me sjellje ndëshkimore (ngacmime burokratike, kërkesa arbitrare tatimore) apo të humbasin në kontratat publike. Manjatët po subvencionojnë në fushën e medias. Gërshetimi i ngushtë i oligarkëve dhe pushtetit politik është duke helmuar tregun. Votuesit janë të etur për një dorë të fortë. Por siç tregon rasti i Rusisë, kura mund të jetë më e keqe sesa sëmundja. Vetëm 20 vjet pasi rifituan lirinë e tyre, shumë vende të Evropës Lindore po rrezikojnë ta kompromentojnë atë (The Economist, 2011).*

Problemi është i mprehtë edhe në vendet e zhvilluara. *Shqipëria nuk është i vetmi vend që duhet fajësuar, vende si SHBA, Britani e Madhe ose strehat fiskale si Zvicra, Qipro, Hong Kongu apo Singapori duhet të veprojnë (Clark Gascoigne, GFI, 2012).* Duke parë peshën e GDP-së së Shqipërisë në rang global, problemi është më shqetësues në vendet e madha që janë lider në ekonominë botërore. *Sa me e lartë GDP për frymë e një vendi, aq më i pasur do jetë, më shumë para për pastrim do të tërheqë, sepse paratë mund të pastrohen më lehtë në një ekonomi të madhe dhe të pasur se sa në një ishull të varfër (Unger dhe Rawlings 2008).*

Për Hollandën, vlerësimet mbi evazionin fiskal dhe mospagimin të taksave janë edhe më të larta, varjojnë mes 6% dhe 15% të GDP-së. Nga të dhënat e zyrës hollandeze të hetimit për mashtrim fiskal, rreth 700 milionë euro të evazionit tatimor (që variojnë nga 20 deri në 70 miliardë Euro) është vlerësuar nga autoritetet si mashtrim i rëndë. *Holanda është akoma e ndjeshme ndaj pastrimit të parave për shkak të qendrës së madhe financiare, hapjes ndaj tregtisë dhe madhësisë së të ardhurave kriminale (FATF publication, 2011).*

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ardhurat nga evazoni fiskal janë pjesa më e madhe e të ardhurave kriminale. Ato arrijnë në rreth 4% në 6% të GDP (dallimi në mes kolonës 3 dhe 5 në tabelën 1).

Tabela 1. Evazoni fiskal si pjesë e të ardhurave kriminale në SHBA (në Miliarda Dollarë)

Viti	Evazoni fiskal i përfshirë		Evazoni fiskal i papërfshirë	
	Të ardhura kriminale të vlerësuara	përqindje e GDP	Të ardhura kriminale të vlerësuara	përqindje e GDP
1965	49	6.8	18	2.5
1970	74	7.1	26	2.5
1975	118	7.2	45	2.7
1980	196	7.0	78	2.8
1985	342	8.1	166	4.0
1990	471	8.1	209	3.6
1995	595	8.0	206	2.8
2000	779	7.9	224	2.3

(Source Unger 2009: Reuter and Truman (2004) quoted in Levi and Reuter (2006)).

Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit European (Direktiva e tretë e BE mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave, Shtator 2005), është përpjekur të harmonizojë disa dallime ligjore për vendet e saj anëtare. Megjithatë ajo nuk ka zgjidhur problemin e evazionit fiskal. Një arsye është se taksat perceptohen me forcë si diçka nën sovranitetin kombëtar. Shumë vende përfshirë këtu edhe vende si Austria, Zvicra apo Luksemburgu nuk e konsiderojnë evazionin fiskal si krim. Gjermanët nuk e konsiderojnë krim evazionit fiskal nga individët por vetëm nga biznesi dhe organizatat kriminale. Hollandezët nuk e konsiderojnë evazionin fiskal si një krim të rëndë, por vetëm si një shkelje ligji,

kështu që vetëm kur lidhet me një mashtrim të rëndë mund të ketë një veprë penale të lidhur me pastrimin e parave. (Unger 2009).

Elita e korruptuar ka nxjerrë më shumë se 1.3 miliardë dollarë nga Shqipëria, dhe kjo duhet të shërbejë si një këmbanë zgjimi për qeverinë. Qeveria duhet të kërkojë që të gjithë bankat në Shqipëri të dinë përfituesit realë, individul dhe përfituesit e çdo llogarie të hapur në institucionet e tyre financiare. Rreth 60 përqind e parave vijnë nga evazioni fiskal, 35 përqind nga aktivitetet kriminale dhe 5 përqind nga korrupsioni. Vetëm në vitin 2008, 405 milion dollarë u transferuan në mënyrë të paligjshme nga Shqipëria, ndërkohë që çdo vit transferohen në strehat fiskale 131 milion dollarë (Clark Gascoigne, GFI, 2012). Kapitali i larguar vjen nga të ardhura të dyshimta ku përfshihen si të ardhurat kriminale ashtu edhe nga evazioni fiskal.

Konfuziteti rritet kur përpiqemi për të identifikuar pastrimin e parave është çështja e fluturimit të kapitalit. Kjo ndodh kur individët (ose kompanitë) heqin fonde nga ekonomia e vendit të tyre dhe investojnë jashtë vendit, zakonisht duke shmangur tatimin e brendshëm në proces. Ky aktivitet është bërë më i përhapur që nga rënia e komunizmit dhe fillimin e vështirësive katastrofike për ekonominë post-sovjetike. A është kjo pastrim parash? Përgjigja logjike është se në qoftë se paratë janë fituar ligjërisht atëherë ato nuk janë të tilla. Në qoftë se duke shmangur taksat je duke kryer veprë penale, a bëhet ky proces i njëjtë me atë të pastrimit të parave? Nëse nuk është, si mund të dallohen të dy fenomenet - veçanërisht kur vërehet se teknikat dhe kanalet e përdorura nga të dy proceset janë në mënyrë të habitshme të ngjashme? (Lilley 2006).

Përderisa ka ngjashmëri substanciale midis teknikave të përdorura për të pastruar të ardhurat e krimit dhe atyre për të kryer krime tatimore, Ministrat e Financave të G7 kanë inkurajuar veprimet ndërkombëtare për të rritur kapacitetet e sistemeve kundër pastrimit të parave dhe luftuar efektivisht krimet e lidhura me taksat. G7 konsideron se një veprim i koordinuar ndërkombëtar në këtë fushë do të forconte mekanizmat ekzistuese të parandalimit të pastrimit të parave dhe do të rrisë efektivitetin e shkëmbimit të informacionit në çështjet e taksave. Në këtë drejtim Komiteti për çështjet fiskale i OECD-së, ka krijuar një dialog me FATF dhe vazhdon të shqyrtojë mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit midis autoriteteve tatimore dhe atyre të parandalimit të pastrimit të parave. Puna e ekspertëve të OECD-së mbi krimin e taksave dhe pastrimit të parave është projektuar për të plotësuar atë që tashmë është ngritur nga FATF (Tavares 2013).

Samiti i 39-të i G8, kërkoi rritjen e transparencës në lidhje me rrjedhat e fshehta të parave duke përmendur pastimin e parave dhe evazionin fiskal. Ekonomitë më të pasura të botës deklaruan se do të mbajnë një qëndrim më të ashpër në luftën kundër pastrimit të parave dhe evazionit fiskal. Grupi i tetë liderëve ra dakort për një sërë çështjesh, duke përfshirë përmirësimin e transparencës në lidhje me faktin se kush zotëron kompanitë “guaskë” dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit mes autoriteteve tatimore (EU 2013).

Amendimet e duhura duhet të bëhen në rang global dhe nacional, në kuadrin rregullativ për të inkluduar shmangien e taksave si krim themelor të pastrimit të parave. Ndryshimet globale janë të domosdoshme për shkak të ndryshimeve themelore që ekzistojnë në kuadrin ligjor, veçanërisht në atë tatimor. FATF ka bërë ndryshime thelbësore në rekomandimet e saj të Shkurtit 2012 të cilët priten të zbatohen nga vendet anëtare dhe me gjerë. Me ndryshimet e fundit në rekomandimet e FATF, ndër kategoritë e percaktuara si krim themelor i pastrimit të parave përfshihen edhe:

- kontrabanda, (duke përfshirë shkeljet me detyrimet doganore, akcizat dhe taksat);
- krimet tatimore (lidhur me tatimet direkte dhe taksat indirekte);

Bashkimi Evropian ka filluar punën për një direktivë të re të parandalimit të pastrimit të parave, të katërtën dhe me të vështirën deri më sot ku mendohet të përfshihen edhe rekomandimet e FATF të Shkurtit 2012. Impakti që do të ketë zbatimi i direktives së katërt të BE-së në momentin që do të hyjë në fuqi do të jetë mjaft i rëndësishëm në botën financiare globale.

SHBA kanë miratuar kohët e fundit një ligj federal tatimor të quajtur FATCA i cili hyri në fuqi në Korrik të vitit 2014. Ligji parashikon që individët dhe personat juridike amerikanë që ushtrojnë aktivitetin e tyre financiar jashtë vendit të identifikohen dhe raportohen. Vendet kryesore Evropiane si Franca, Gjermania, Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia kanë nënshkruar tashmë me Departamentin e Thesarit Amerikan marrëveshjen ndërqeveritare “Model IGA”, e cila i detyron këto vende të ndërmarrin një qasje të përbashket për të luftuar evazionin fiskal. FATCA do të kërkojë institucioneve financiare jashtë SHBA të raportojnë në Autoritetin e Tatim-Taksave (IRS), informacionin për llogaritë e çelura nga taksapaguesit amerikanë, ose llogari të kompanive, në të cilat taksapaguesit amerikanë janë aksionerë.

Vende të tjera evropiane që nuk e kanë nënshkruar këtë marrëveshje akoma janë në pararojë të marrjes së masave për implementimin e kësaj marrëveshjeje në vendet e tyre. Kjo vjen ngaqë bankat do të konsideroheshin jo koperuese dhe shoqërohet me rreziqe reputacionale. FATCA mund të ndikonte në transaksionet në dollarë me bankat korrespondente lehtësisht të kontrollueshme nga autoritetet amerikane. Gjithashtu kërkohen ndërhyrje në sistemet kompjuterike bankare për të përshtatur kërkesat specifike të FACTA.

Autoritetet legislative dhe ekzekutive në Shqipëri akoma nuk e kanë nënshkruar marrëveshjen dhe nuk kanë filluar diskutime për të nënshkruar një marrëveshje ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe IRS por gjasat janë që edhe Shqipëria do të jetë pjesë e marrëveshjes në të ardhmen. Në fazën e parë të implementimit të ligjit, grupeve bankare ndërkombëtare ju kërkohet plotësimi i një pyetësi “Banking Light Survey” që bën një vlerësim të përgjithshëm të situatës së vendeve të ndryshme në këtë drejtim. Formulari i FATCA ndër të tjera përmban seksionin e identifikimit të klientit dhe të pronarit përfitues i cili ka lidhje direkte me parandalimin e pastrimit të parave, pasi pa u identifikuar se cilët janë individët (taksapagues amerikanë në këtë rast) dhe zotëruesit e kompanive që abuzojnë me mospagimin e taksave apo fshehjen e të ardhurave është pothuajse pamundur vlerësimi i situatës reale të evazionit fiskal. Identifikimi i klientit është një tjetër aspekt që tregon për një lidhje direkte të pastrimit të parave me evazionin fiskal.

1.3 Qendrat financiare “off-shore”

Qendrat financiare “off-shore” konsiderohen si një nga pikat më të debatueshme të identifikimit të pronësisë përfituese dhe rrjedhimisht të pastrimit të parave. Qendrat financiare “off-shore” karakterizohen nga disa elemente dallues si më poshtë:

- Juridiksione që kanë një numër relativisht të madh të institucioneve financiare të angazhuara kryesisht me jorezidentë.
- Sistemet financiare që kanë asete dhe detyrime të jashtme jo në proporcion me ato të brendëshme financiare.
- Ofrojnë disa ose të gjitha shërbimet e mëposhtme: taksa të ulëta ose zero; kërkesa rregullative të moderuara apo lehtësuese financiare; sekret bankar dhe anonimitet të lartë të pronësisë së korporatave (*Zoromé 2007*).

Korporatat “off-shore” janë tashmë një fenomen i pranishëm edhe në sistemin financiar Shqiptar pasi korporata me rezidencë në qendrat “off-shore” kanë hapur deget e tyre në vendin tonë. Gjithashtu, klientë apo shtetas shqiptar dërgojnë fondet e tyre në qendra “off-shore” si në rastin e Qipros. Megjithëse nuk është ilegale të dërgosh para në Qipro (aq më tepër që është vend i Bashkimit Evropian), dërgimi i fondeve në një qendër “off-shore” ngre disa hije dyshimi për fenomene të pastrimit të parave apo evazionit fiskal. Rasti i Qipros po shqetëson ligjvënësit Evropian të cilët e kanë lejuar këtë vend të operojë për një kohë të gjatë si një parajsë fiskale.

Qiproja, një vend i vogël mesdhetar, me një PBB prej vetëm \$ 23 Miliardësh po përballet me pasojat e një krizë financiare afat-gjatë. *Tetë muaj pasi Banka Qendrore Evropiane dukej se kishte rivendosur stabilitetin duke premtuar për të bërë çfarëdo qoftë për të shpëtuar monedhën e përbashkët, rreziku që një anëtar i euros të dalë nga Eurozona është rikthyer. Qipro ka mirëpritur shtetasit rusë dhe ka lejuar bankat e saj të marrin shuma të mëdha prej tyre. Pasuritë e bankave qipriote arritën në vlerën 800% të PBB në vitin 2011. Kaosi pasoi, të paktën në mesin e rusëve me shumë reputacion (ose jo), të cilët kanë depozituar paratë e tyre në këtë ishull me rregulla të lehta financiare (The Economist 2013).*

Subjektet financiare duhet të marrin masa për ti trajtuar korporatat “off-shore” me vigjilencë të zgjeruar që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar identitetin e klientit; për të kuptuar dhe testuar profilin e tij, të biznesit dhe veprimtarisë së llogarive të tij bankare; për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore (*Ligj 9917 mbi PPP/FT*). Personat përgjegjës të përputhshmërisë në banka që merren me çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe i gjithë stafi i bankës në përgjithësi, duhet të jenë të mirë trajnuar në rastin kur përballen me klientë “off-shore”.

Këto vende kanë regjime preferenciale ligjore për të tërhequr dhe konkuruar për kapitale në shkallë globale. Deri në fund të viteve 1990, shumë vende ishin të pavëmendshëm për rreziqet që vijnë nga infiltrimi i parave kriminale në sistemet e tyre financiare. Në kohët e ndërkombëtarizimit dhe globalizimit në rritje, vendet të ndryshme përpiqen të tërheqin sa me shumë kapitalin e huaj. Firmat shumëkombëshe janë të interesuara për vende me taksa të ulëta, me infrastrukturë të mirë,

subvencione të larta, me standarde minimale të kushteve të punës me qëllimin e përfitimit nga kostot dhe standartet e ulëta ekologjike që ofrojnë këto vende.

Rasti më tipik janë ishujt “Seychelles”. Në vitin 1995 qeveria e “Seychelles”, një shtet ishull me rreth 80 000 banorë në Oqeanin Indian, miratoi Aktin e Zhvillimit Ekonomik (EDA). Qëllimi i këtij akti, në përputhje me preambulën e tij ishte “... për të siguruar dhënien e stimujve dhe koncesioneve individëve të kualifikuar për të investuar në “Seychelles”, me qëllim të sigurimit të një niveli të lartë të rritjes së qëndrueshme ekonomike në këtë vend”. Akti krijoi një bord që mund të jepte koncesione dhe stimuj për investime të tilla. Një nga këto stimuj ishte imuniteti i plotë nga ndjekja penale në procedurën penale dhe mbrojtja e pasurive nga konfiskimi edhe nëse investimet janë fituar si rezultat i krimeve të kryera jashtë “Seychelles”. Një investitor mund të merret me drogë ose kryejë vepra të dhunshme diku tjetër në botë dhe pastaj i sigurtë mund të investojë të ardhurat në “Seychell”, i lirë nga konfiskimi apo ndjekja e Prokurorisë. E vetmja gjë që një individ duhet të bënte ishte investimi i një shumë minimum prej \$ 10 milion dollaresh dhe Qeveria e “Seychelles” do t’i japte imunitet nga ndjekja penale. “Seychelles” në mënyre eksplicite njoftoi se do të konkurojë hapur për thithjen e të ardhurave nga krimi (B. Unger and G. Rawlings 2008).

Reagimi nga shumë vende të zhvillura në lidhje me çështjen “Seychelles” erdhi më vonë pasi fonde me natyrë të dyshimtë vërshuan drejt këtij vendi. Si rezultat i falimentimit të korporatave të mëdha si Enron, shqetësimit në rritje mbi financimin e terrorizmit pas 11 Shtatorit 2001, skandaleve bankare dhe rrezikut të ekspozimit të tregjeve financiare nga pastrimi i parave pas krizes globale financiare 2008, qeveritë dhe organizatat multilaterale kanë lëvizur kundër pastrimit të parave kriminale nëpërmjet shtrëngimit të kërkesave të raportimit dhe atyre rregulative duke prekur në mënyre të drejtpërdrejte qendrat financiare “off-shore”.

Është shumë e vështirë për të bërë një gjykim të shëndoshë mbi financimet “off-shore” për shkak të sekretit të aktivitet të sektorit financiar në këto vende. Hulumtimi mbi shkallën e problemit paraqet sfidat globale që përballen sot ligjvenesit në mbarë globin duke përfshirë edhe vendin tonë. Vendet e varfra “humbasin” më shumë se 1 trilion USD në vit për shkak të parajsave fiskale, rreth dhjetë herë më shumë se ndihma që ata marrin. Dy të tretat e kësaj shume mendohet të jetë evazion fiskal dhe shmangie detyrimesh tatimore, ndërsa pjesa tjetër transferta nga individë me të shkuar kriminale dhe të korruptuar (*The Economist* 2011). Juridiksione si “Isle of Man” zënë një pozitë të krahasueshme me Norvegjinë, ndërsa Bahamas me Austrinë (B. Maurer 2009).

Për autorë të tjerë, shifrat e mësipërme janë një vlerësim konservator. *Një elitë globale super të pasurish kishte të paktën 21 trilion USD të fshehur në qendrat “off-shore” deri në fund të vitit 2010. Kjo shifër është e barabartë me madhësinë e ekonomive amerikane dhe japoneze të marra së bashku. Në fund të vitit 2010, 50 banka kryesore private menaxhonin më shumë se 12.1 trilion USD të aseteve ndër-kufitare të investuara nga klientët privatë. Bankat private që mbajnë me shume asete në qendrat financiare “off-shore” janë UBS, Credit Suisse dhe Goldman Sachs. Më pak se 100.000 njerëz në mbarë botën zotërojnë rreth \$ 9.8 trilion të pasurisë në qendrat financiare “off-shore” (Henry 2012).*

Ka gjykime të ndryshme mbi numrin e qendrave financiare “off-shore” dhe madhësinë e kapitalit të mbajtur në to. Raporti i FMN (2008) mbi Programin e Vlerësimit të Sektorit Financiar, përcakton numrin e qendrave financiare “off-shore” në rreth 52, ndërsa sipas OECD (2013) ky numër arrin në 58. Sipas FSI i administruar nga Rrjeti për Drejtësi Tatimore TJN (2011), numri i vendeve që mund të konsiderohen qendra financiare “off-shore” arrin në 73. Këtu përfshihen vende territore me dispozitat strikte të sekretit bankar dhe taksa minimale si Bermuda, Qipro, Ishujt Kajman dhe Vanuatu si dhe demokraci të industrializuara të tilla si Australia, Luksemburgu, Austria, Holanda etj. SHBA dhe Britania e Madhe kanë nën juridiksionin e tyre shtete që mund të konsiderohen si parajsë fiskale si Delaware, Minnesota, Nevada në SHBA dhe Ishujt e Kanalit në Britaninë e Madhe.

Legjislacioni Hollandez për përfituesin e pronësisë nuk përfshin personat që janë në gjendje të ushtrorë kontrollin e fundit efektiv ndaj një marrëveshjeje ligjore (FATF 2011). Vendet në zhvillim përballen me një standart të dyfishtë. E ndërsa vende si Shqipëria e kanë të mirë definuar në legjislacion e parandalimit të pastrimit të parave, identifikimin e pronësisë përfituese, vende të tilla si Holanda akoma nuk e kanë zgjidhur përfundimisht çështjen e vigjilences së duhur ndaj pronarit përfitues.

Numri më i lartë i bankave për 1,000 banorë gjendet në juridiksionet e sekretit apo strehat e taksave (Harari, Meinzer and Richard Murphy, 2012). Ndër 12 qendrat më të mëdha bankare, të renditura sipas pasurisë në Dhjetor 2006, gjenden Ishujt Kajman (tabela 2).

Tabela 2. 12 Qendrat më të mëdha bankare, të renditura për nga asetet, Dhjetor 2006 (në miliarda USD)

1	UK	5178.5
2	Germania	2794.0
3	SHBA	2305.1
4	Francë	2196.1
5	Japoni	1898.5
6	Ishujt Kayman	1661.9
7	Zvicra	1122.0
8	Hollanda	1041.5
9	Belgjika	891.6
10	Irlanda	819.1
11	Hong Kong	621.4
12	Singapor	603.5

Burimi: Bank for International Settlements 2006, marrë nga (Re-regulating “off-shore” finance, 2009)

Ishujt Kajman ishin qendra e gjashtë më e madhe në botën bankare përsa i përket aseteve bankare, vlera monetare e të cilave arrin një shumë totale prej mëse 1661 miliardë dollare. Kjo shifër është mjaft kontradiktore nëse do ti referohemi PBB nominal, ku Ishujt Kajman renditën në vendin e 159 me një PBB me vlerë rreth 3 miliardë dollarë (*Lista e Kombeve të Bashkura 2011*). Ishujt Kajman janë një territor Britanik që gjenden në pjesën perëndimore të Detit të Karaibeve me një sipërfaqe totale prej vetëm 264 km dhe një popullsi prej 54,878 banorësh (*Censusi i vitit 2010*). Një numër institucionet globale shumë të rëndësishme financiare, duke përfshirë HSBC, Deutsche Bank, UBS dhe Goldman Sachs operojnë në vend.

Qendrat financiare “off-shore” përdoren jo vetem nga subjekte me rezidencë në vendet e industrializuara por edhe nga vendet në zhvillim. Mauritius është investitori më i madh në Indi, Ishujt e Virgjër Britanik një nga më të mëdhatë në Kinë. Parajsat fiskale më të rëndësishme të botës financiare globale kanë disa karakteristika të përbashkëta (tabela 3).

Tabela 3. Një guide për 6 parajsat fiskale më të njohura në botë.

Parajsa Fiskale	Popullsia 2010, në mijë	Karakteristikat	Mangësitë
Ishujt Kajman	56	Përqëndrimi kryesor në rang botërori i "hedge funds". Gjithashtu popullor për bankat e mëdha.	Rregullore të buta, shkruar në thelb nga klientët e saj. I është lakuar emri në shumicën e skandaleve të mëdha financiare.
Mauritius	1,299	Lidhje të ngushta me Indinë. Josh bizneset nga prajsat fiskale Evropiane që janë në presion.	Lejon Indianët të fshehin investimet në vendin e tyre nën petkun e avantazhit të taksave për kapitalin e huaj.
Jersey	93	Lidhje të ngushta me qytetin e Londrës. Truste të padepërtueshme. Asnjë taksë mbi fitimet korporatave	Pretendon se është duke rishikuar legjislacionin.
Luksemburgu	507	Rezistencë e madhe ndaj përpjekjeve evropiane për të promovuar transparencën. Tregu i dytë më i madh për "mutual fund" pas SHBA.	Konsiderohet "Ylli vdekjes" së sekretit financiar në zemër të BE-së.
Zvicra	7,664	Mbrojtja e evazionit tatimor si një reagim legjitim ndaj presionit që vjen për këtë çështje.	Konçesionet që po ofrohen nën presionin ndërkombëtar për t'i dhënë fund sekretit bankar janë kryesisht "sa për sy e faqe".
Singapori	5,086	Agresivisht marketon veten si një qëndër tregtare rajonale. Ashtu si Mauritius, tërheq biznese nga parajsat fiskale perëndimore.	Marrëveshjet e shkëmbimit të informacionit me vendet e tjera janë të kushtëzuara nga masa mbrojtëse që zbatohen ligjërisht.

Burimi: "TJN; The economist; Trouble Islands 2011"

Rekomandimet rregullative ndërkombëtare të tilla si FATF, direktiva e tretë dhe së fundmi e katërt e BE-së në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave si dhe autoritetet e zbatimit të ligjit në vende të ndryshme, i konsiderojnë qendrat "off-shore" si shumë të rrezikshme në lidhje me çështjet të pastrimit të parave. Kuadri ligjor shqiptar mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe sidomos

vendimi i Bankës së Shqipërisë nr. 55, mbi miratimin e rregullores "Për PPP/FT", në klasifikimin e klientëve në bazë të rrezikut që ato paraqesin, i rendit klientet "off-shore" në krye të listës.

Juridiksionet "off-shore" ushtrojnë një sekret relativisht të lartë në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive të regjistruara në këto vende si dhe të llogarive bankare të tyre. Çdokush pavarësisht nga përkatësia e tij mund të regjistrojë një kompani në një qendër "off-shore" dhe më pas të krijojë një marrëdhënie biznesi me një bankë e cila nuk ushtron standardet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit, përfshirë fshehjen e pronarit përfundimtar përfitues (personi i fundit fizik që zotëron një kompani). Më vonë këto kompani mund të kryejnë marrëdhënie biznesi në të gjithë botën, duke shfrytëzuar infrastrukturën ndërkombëtare bankare (çeqe bankare, transfertat etj) dhe duke "pastruar" shuma të konsiderueshme parash.

Zhvillimet e fundit në Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikacionit (ICT) dhe në veçanti internet banking, telephone banking, mobile banking etj, ofrojnë mundësi unike për pastruesit e parave (*Moneyval, March 2012*). Nje metodë shumë e përsosur për të pastruar para në këto vende është elektronik banking. Nga një bankë në një qendër financiare "off-shore", fondet mund të transferohen nëpërmjet kompjuterit personal në një llogari bankare në një vend tjetër. Mund të hapësh një llogari rrejedhëse bankare me kartë krediti në një vend "off-shore" dhe të kryesh transaksione në të ardhmen universalisht.

Anonimiteti i korporatës është shumë i rëndësishëm për qëllime të pastrimit të parave dhe të evazionit tatimor. Në juridiksionet "off-shore" mund të kryhen transaksione ilegale si "smurfing" (strukturimi i transaksioneve) apo "kontrabanda e cash-it" (kontrabanda fizike e cash-it në një juridiksion tjetër, dhe depozitimi në një institucion financiar me sekret bankar më të madh apo me kërkesa më pak rigorozë të zbatimit të ligjit të PPP/FT). Individë të pasur, persona me të kaluar kriminale dhe PEP të korruptuar, ndërsa fshehin identitetin e tyre në qendrat "off-shore" janë në gjendje të bëjnë shumë akrobaci të paligjshme financiare.

Kriza financiare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka ngritur debate mbi sistemin Bankar dhe sidomos rolit që luajnë bankat e mëdha në tregun financiar. Banka të mëdha që synojnë të zhvillojnë standarde të industrisë së shërbimeve financiare edhe në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, shpesh herë janë akuzuar për kryerjen e transaksioneve të dyshimta për klientë të dyshimtë apo transfertat në vende që janë nën rregjimin e sanksioneve të OKB-së.

Njerëz të njohur të financës argumentojnë se bota e zhvilluar mund të mos e bombardonte Libinë, në qoftë se do ti kushtonte një vemendje më të madhe pagesave të bëra nga korporata multinacionale të regjimeve despotike, dhe nëse bankat do të ishin më pak entuziast për të hapur llogari bankare personale “off-shore” për despotë të caktuar. Qeveritë që kanë fonde të ngrira të kontrolluara nga Gadafi, Mubarak, Ben Ali dhe miqtë e tyre duhet të publikojnë bankat që mbajnë pasuritë e tyre. Ato banka që mbajnë paratë e pista duhen bërë publike dhe pastaj rregullatorët duhet të nxjerrin një sistem të ri i cili ndalon bankat të marrin fonde të dyshimta (BBC, 2011).

Në një kohë kur rregullat e pastrimit të parave për të hapur një llogari bankare po bëhen një makth administrativ për subjektet bankare, dikatorë dhe bashkëpunëtorët e tyre me të ardhura dukshëm të fituara në mënyrë abuzive, kanë hapur llogari dhe mbajnë shuma deri në miliarda dollarëshe në banka të mëdha me qendër në vendet perendimore dhe me një shtrirje globale. Në kohën e krizës rajonale dhe globale çdo institucion financiar do të dëshironte depozita miliona dollarëshe qofshin këto edhe nga diktatorë të tillë si Ben Ali, Gadafi, Mubarak etj. Pranvera Arabe që filloi në vitin 2011 nxorri në pah depozita të mëdha në emër të diktatoreve nga lindja e mesme apo kompanive të kontrolluar prej tyre në banka të mëdha dhe me emër në tregun global financiar.

Lojtari më i madh në botën e fshehtë “off-shore” është Britania, nëse grupohet së bashku me ishujt në vartësinë e saj në kanalin Anglez, Karaibe dhe gjetkë. Britania e madhe është vetëm në vendin e 21-të, por dy satelitët e saj - Xhersi dhe Cayman Islands - janë në dhjetëshen e parë, me Bermudën dhe Guernsey jo shumë larg prapa. Së bashku ato përbëjnë diku mes një të tretës dhe gjysmës së tregut global të shërbimeve financiare dhe të korporatave “off-shore”. Pjesa më e madhe e parave që ata mbledhin është kanalizuar përmes qytetit të Londrës (The Economist, 2013).

Transaksionet me vendet problematike që aplikojnë standarte të ulta të PPP, mund të shkatërojnë dëme shumë serioze apo katastrofale për reputacionin e grupeve bankare. Mjaft banka të njohura e me reputacion në arenën ndërkombëtare janë ndëshkuar me sanksione të konsiderueshme nga autoritetet mbikëqyrëse për shkak të kryerjes së transaksioneve me vendet problematike.

Autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit por edhe institucionet financiare ndeshen në një batak ligjor. Kompanitë “off-shore” nga ana tjetër përfaqësohen nga juristë dhe eksperte kontabël të aftë për të shfrytëzuar hapsirat ligjore që gjenden në legjislacione të vendeve të ndryshme. Shqetësime

praktike janë gjithnjë në rritje. *Parajsat fiskale e bëjnë të vështirë për të krijuar një pamje të vërtetë se ku qëndron niveli i borxhit dhe i rrezikut, për shembull, nëpërmjet tregtimin të fondeve “hedge” kompania Enron fshihet borxhin në qindra filiale të saj në Karaibe (The Economist, 2011).*

Në vendet “off-shore” problemi i identifikimit të klientit dhe burimit të të ardhurave bëhet shumë kompleks dhe me të drejtë ka shumë zëra që kërkojnë nga ligjvënuesit një zgjidhje në rang global për të lehtësuar punën operacionale të institucioneve financiare kudoqofshin ato. Kohët e fundit është rritur presioni për një transparencë më të madhe mbi identitetin e njerëzve të cilët zotërojnë korporatat anonime. Presioni po vjen nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore, FATF etj. Ndryshimet e reja në 40 +9 rekomandimet FATF dhe direktiva e katërt e BE-së mbi parandalimin e pastrimit të parave, e cila pritet të implementohet së shpejti, përfshijnë evazionin fiskal si krim primar. Vende në zhvillim të tilla si India, janë duke marrë masa të nevojshme për të goditur evaduesit tatimorë në qendrat “off-shore”. *Në listën e atyre që kanë investuar në qendrat “off-shore” të tilla si Ishujt e Virgjër Britanik, përfshiheshin 612 shtetas Indianë si deputetë, industrialistë të lartë etj (The Indian Express 2012).* Pas krizës financiare të vitit 2008, qeveritë kanë shtuar përpjekjet për të luftuar krimin ekonomik dhe për të siguruar rritjen e të ardhurave në buxhetet respektive të shteteve të tyre.

Transaksionet financiare me qendrat “off-shore” ju kushton SHBA-ve rreth 100 miliard dollarë të të ardhurat tatimore çdo vit (*Jane G. Gravelle 2013*). Nga 100 korporatat më të madha amerikane, 83 prej tyre i mbanin të ardhurat e tyre në vendet “off-shore” (*US Pirs 2012*). Akti Amerikan FATCA do ti detyrojë institucionet e huaja financiare të raportojnë mbi llogaritë e shtetasve amerikanë ose të përballen me sanksionet ligjore. *Zbatimi i këtij Akti mund të rrisë shpenzimet për bankat e huaja me më shumë se 10 miliardë dollarë në dhjetë vitet e ardhshme (The Economist 11.02.2012).*

Këto përpjekje kanë nxjerrë në pah rezultatet e para dhe banka zviceriane Wegelin është një rast i cili ka patur efekt të rëndësishëm në zhvillimet e fundit të financave “off-shore”. *Autoritet zvicerane e kanë të rrënjosur ligjin mbi fshehtësinë bankare që nga viti 1934, duke e bërë një vepër penale zbulimin e identitetit të klientit. Kjo ka krijuar parajsën më të madhe fiskale në botën tatimore. Bankat e Zvicrës zotëronin rreth 2.1 trilion \$, ose 27%, të pasurisë së përgjithshme të vendeve që konsiderohen parajsë fiskale në vitin 2010, (The Economist 2012).* Banka Wegelin me

qendër në Zurich kryente biznes për mëse 271 vjet dhe është banka më e vjetër e Zvicrës. Banka ka ndihmuar klientët e saj të shmangin taksat amerikane në vlerën 1.2 miliard USD në llogaritë e parajsave fiskale dhe të joshë klientët amerikanë nga UBS, një bankë tjetër gjigande zvicerane. Pasi UBS u gjobit në vitin 2009, Wegelin arriti të tërheqë shumë shtetas amerikanë të cilët ishin klientë të UBS gjatë vitit 2008 dhe 2009. Wegelin shpresonte se ishte e siguar pasi nuk kishte degë në SHBA por vendimi i ri është përfshirës për të gjithë evaduesit tatimore amerikanë. Akuzat e bëra ndaj Wegelin e bëjnë atë bankën e parë jashtë territorit amerikan të akuzuar nga autoritetet amerikane dhe shënon një moment historik në goditjen e sekretit bankar zviceran dhe përpjekjet për të detyruar bankat të raportojnë mbi emrat dhe të dhënat e klienteve të tyre (*Reuters 2012*).

Bashkimi Evropian ka bërë përpjekje në drejtim të kërkimit të një lloj raportimi vend pas vendi. “Isle of Man” është bërë parajsa e parë fiskale britanike që ka rënë dakort për të shkëmbyer informacionin tatimor sipas kërkesës. Gjermania dhe Britania në vitin 2011 kanë negociuar me Zvicrën marrëveshjen dypalëshe "Rubik". Shtetasit e këtyre vendeve që mbajnë llogari në vendet “off-shore” duhet të paguajnë një shumë të caktuar për tatimet e papaguara, plus një taksë vjetore të mbajtur në burim. Qeveria zviceriane mbledh të ardhurat dhe ja kalon vendeve përkatëse, por emrat qëndrojnë anonim. Qëndrimi gjerman dhe britanik është shumë më i butë sesa ai amerikan në lidhje me emrat anonime (*The Economist 2012*).

Një presion gjithnjë e më i fuqishëm po vjen nga brenda sistemit. Aksionerët e kompanisë po bëhen gjithnjë e më sensitivë në lidhje me rreziqet reputacionale të përdorimit të parajsave fiskale. *Një tjetër rrezik janë dhe efektet e një goditjeje në vendet e origjinës. Investitorët kanë filluar të llogarisin se si ajo mund të ndikojë në vlerësimet kapitalit”, thotë një konsulent (The Economist, 2011).*

Opinionimi publik po ndryshon edhe në vende “off-shore” si Zvicra duke anuar në anën e një transparence më të madhe në lidhje me çështjet sensitive që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe evazionin fiskal. Kjo vjen sidomos pas disa skandaleve politike që ndodhën në këtë vend. *Philipp Hildebrand, drejtor i bankës qendrore, dha dorëheqjen në Janar të vitit 2012 pas një marrëveshje tregtie të këmbimit valutor të kryer nga gruaja e tij që u zbulua nga një i punësuar në një bankë private (The Economist, 2011).*

Ka disa zëra kritikë që i konsiderojnë këto masa si të pamajftueshme. Qytetarët mesatarë dhe bizneset e vogla do të vazhdojnë të paguajnë çmimin për transaksionet “off-shore” të kryer nga bizneset e mëdha (*U.S. PIRG - Phineas Baxandall, Abigail Caplovitz Field dhe Dan Smith, 2012*). Globalizimi dhe teknologjia kanë sjellë ndryshime të mëdha në mënyrën se si bizneset veprojnë. Komunikimi është më i shpejtë se kurrë. Financat janë bërë më të lëvizshme se kurrë. Vlera e kompanive është e lidhur gjithnjë e më shumë në koncepte të tilla si markë dhe pronë intelektuale, të cilat nuk respektojnë kufijtë e vendit. Pavarësisht nga kjo, parimet që rregullojnë taksat për kompanitë multinationale nuk kanë ndryshuar që kur u aprovuan nga Lidhja e Kombeve pothuajse një shekull më parë. Si rezultat, disa shumëkombëshe të mëdha janë në gjendje për të ristrukturuar biznesin e tyre për të shmangur pagimin e pjesës së duhur të tatimit. Disa shfrytëzojnë rregullat duke i zhvendosur fitimet nga vendet me tarifa të larta tatimore në parajsat fiskale, duke paguar më pak se 5% në taksat e korporatave, ndërsa bizneset e vogla janë duke paguar deri në 30%. Kjo shtrembëron konkurrencën, duke i dhënë kompanive më të mëdha një avantazh mbi kompani më të vogla vendase. Njerëzit me të drejtë janë duke kërkuar të bëhet diçka (*George Osborne, the Guardian 2013*).

Për të rivendosur drejtësinë në sistemin tatimor nga abuzimi i korporatave dhe individëve të pasur nëpërmjet përdorimit të parajsave fiskale, politikëbërësit duhet të (*U.S. PIRG 2013*):

- ndalojnë mundësinë e korporatave multinationale për të shtyrë në një kohë të pacaktuar pagimin e tatimit mbi fitimet duke përdorur deget e tyre të huaja.
- kërkojnë raportim të plotë dhe të ndershëm për të ekspozuar abuzimin me parajsat fiskale. Së pari, i duhet dhënë fund aftësisë nga korporata multi-nacionale për të shmangur taksat duke u fshehur identitetin e pronarëve të tyre dhe origjina e fitimeve të tyre prapa shtresave të kompanive “guaskë”. Së dyti, ti kërkohet korporatave shumëkombëshe për të raportuar se si i alokojnë fitimet e tyre në vende të tjera për të mënjeluar mashtrimin rreth të ardhurave të tatueshme në vende të tjera.

Mbeten për tu parë efektet që do të kenë masat e ndërmarra nga institucione ndërkombëtare dhe qeveritë në shkallë globale në zbutjen e fenomenit të pastrimit të parave dhe evazionit fiskal. Pamvarësisht përmirësimeve në kuadrin ligjor përsa i përket minimizimit të sekretit financiar në qendrat financiare “off-shore”, sfida të shumta u dalin ligjvënësve përpara. Një nga më kryesoret është se cili nga institucionet shtetërore duhet ti zbatojë keto rregulla të reja në praktikë. Agjencitë

e zbatimit të ligjit kanë burime të kufizuara në aspektin e buxhetit dhe burimeve njerëzore pasi duhet të ndjekin “pirgje” me shkresa që mund të përfshijnë të dhënat e shumë kompanive dhe mund të jenë përfshirë me dhjetra juridiksione “off-shore” (*The Economist, 2012*). Deri në fund të procesit gjurmët janë zhdukur. Regjistrat e korporatave si Qendra Kombëtare e Regjistrimit QKR në Shqipëri por dhe në vende të tjera të zhvilluara, ankohen se nuk mund të marrin më shumë detyra pasi puna e tyre është të mbledhin dokumentat, dhe jo të kontrollojnë autenticitetin e tyre.

Bankat kanë probleme në zbatimin e ligjit. Për momentin ato janë duke e ndjerë shumë barrën e aplikimit të ligjeve dhe rregulloreve të PPP. Sipas kuadrit ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar, në rastet kur banka ka filluar marrëdhënien e biznesit dhe nuk është në gjendje të zbatojë vigjilencën e zgjeruar ndaj një korporate me rezidencë në qendrat financiare “off-shore” për çështje të tilla si identifikimi i pronësisë përfituese, duhet të ndërpresë marrëdhënien e biznesit dhe të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës. Bankat ballafaqohen me rreziqe ligjore dhe reputacionale.

Kompanitë “off-shore” ankohen pasi për vetë natyrën e legjislacionit të vendeve “off-shore” nuk janë të detyruar të sigurojnë burimin e të ardhurave apo pronarin përfitues. *Një zëdhënës i Shoqatës Britanike të Bankave “ankohet” se anëtarët e tij janë vendosur nën detyrime, por pak mendohet se si bankat mund të gjejnë informacionin që këkohet nga autoritetet ligjvënëse dhe ti përmbahen detyrimeve ligjore. Një ide është që të pyetet klienti dhe nëse nuk përmbushet vigjilenca e duhur ndaj klientit të mos i ofrohet shërbimi. Megjithatë bankat e kanë të vështirë të vërtetojnë nëse deklaratat e klientëve janë të vërteta* (*The Economist, 2012*).

Qendrat financiare “off-shore” janë pararojë e përdorimit të produkteve të reja financiare pasi mbështeten shumë në fondet “hedge” të cilët tregtojnë produkte derivative ekzotike, duke kërcënuar në këtë mënyrë stabilitetin financiar ndërkombëtar. Ishujt Kaiman, në Qershor 2008, regjistruan 10,000 fonde “hedge” (*Cayman Compass 2008*). Bashkëpunim i autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe eksperteve kontabël që kanë dijeni mbi funksionimin e përdorimit të produkteve të reja financiare duhet të rritet.

Rregullimi i financave “off-shore” duhet të trajtohet dhe adresohet në çdo qendër “off-shore” me të njëjtën forcë. *Duke vënë nën presion një pjesë të vogël të juridiksioneve “off-shore” vetëm sa i shtyn bizneset diku tjetër, për shembull nga Ishujt e Kanalit dhe Zvicra, të themi, në Mauritius dhe*

Singapor (*The Economist*, 2011). Institucionet ndërkombëtare që merren me çështje të pastrimit të parave si dhe institucionet të tjera shtetërore të zbatimit të ligjit në mbarë botën duhet të mbajnë një presion të vazhdueshëm në të gjitha qendrat financiare që bien nën definicionin e një qendre financiare “off-shore”. Singapori renditet në vend të parë në botë për lehtësinë e të bërit biznes (tabela 4).

Tabela 4. Lehtësia e të bërit biznes

1	Singapori
2	Zelanda e Re
3	Hong Kong
4	Danimarka
5	Koreja e Jugut
6	Norvegjia
7	SHBA
8	Mbreteria e Bashkuar
9	Finlanda
10	Australia

Burimi: Banka Botërore 2014;

Ka një ekosistem në rritje për të mbështetur sipërmarrjen në Singapor, e cila i jep pozitën si qendër në rajon (*Banka Botërore 2012*). Arsyet kryesore kanë të bëjnë me infrastrukturën e vendit, mjedisin miqësor ndaj biznesit dhe një shtytje aktive nga ana e qeverisë për të hequr pengesat rregullatore. Pëveç asyeve të tjera, "heqja e pengesave rregullative" e ka bërë Singaporin një destinacion të rëndësishëm për individët dhe kompanitë që duan të gjejnë hapësirë për evazion fiskal dhe pastrim parash. *Konfirmohet rritja e vazhdueshme e Hong Kongut dhe Singaporit, si juridiksioneve të sekretit. Hong Kongu është një forcë në rritje në tregjet e kapitalit dhe formimit të kompanive “off-shore”. Të dy kanë përfituar pasi disa aktivitete “off-shore” Evropiane dhe të Amerikës së Veriut janë zhvendosur në drejtim të lindjes, në kërkim të vendeve që janë më pak nën presionin e menjëhershëm nga kryeqytetet perëndimore (The Economist 2013).*

Bankierë zviceranë, ndërkohë që po mbrohen nga sulmet, janë duke u përpjekur për të dalë me një model biznesi alternativ. "Plani B" është përqëndrimi më shumë në konsumatorët e pasur në vende

në zhvillim dhe politikisht të paqëndrueshëm. Fitimet e pandershme të njerëzve të pasur në vendet e varfra e të dobëta mund të jenë shumë fitimprurëse, pavarësisht nga rreziku i reputacionit që ato paraqesin (*The Economist*, 2012)

Një sfidë shumë e rëndësishme në minimizimin e dëmit financiar që vjen nga parajsat fiskale është kundërshtimi nga korporata dhe individë shumë të rëndësishëm të botës financiare. *Ndërkohë që ekonomia amerikane vuante pasojat e krizës, në fillim të vitit 2009, presidenti Barak Obama ofroi një plan që do të shpëtonte shumë vende pune amerikane: - goditje korporatave që dërgojnë fitimet jashtë vendit për të shmangur pagimin e miliarda dollarëve të taksave amerikanë çdo vit. Një pjesë e rëndësishme e strategjisë së taksave të Apple, për shembull, është të paturit e një degë në Irlandë ku grumbullohen të gjitha të ardhurat nga dyqanet e shitjes me pakicë të Apple në Evropë. Vendet "off-shore" kanë qenë shqetësim për qeverinë amerikane praktikisht që nga fillimi i kodit tatimor në 1913. Ne vitin 1962 një kompromis mes presidentit John Kennedy dhe Kongresit vendosi taksat mbi të ardhurat "pasive" të tilla si honorareve dhe interesin e fituar jashtë vendit, por jo mbi të ardhurat "aktive" nga operacionet e rregullta të biznesit. Eliminimi i legjislacionit të tanishëm do të dëmtonte kompani shumëkombëshe me bazë në SHBA duke i detyruar ata të paguajnë më shumë taksë, jo vetëm në SHBA, por edhe në vende me taksë të larta si Franca (Reuters, 2013).*

Ligji Amerikan FACTA do të vendosë taksë mbi të ardhurat "aktive" nga operacionet e rregullta të biznesit të shtetasve amerikanë që ushtrojnë aktiviteitn e tyre në SHBA si dhe pronarëve përfitues që zotërojnë 10 % të kapitalit aksioner të kompanive financiare me bazë në Shtetet e Bashkuara. *Lajm i mirë është se shkëmbimi automatik i informacionit, ka një shans të mirë për tu zhvilluar me kalimin e kohës në një standard global i ndihmuar dhe nga Akti i fuqishëm Amerikan mbi Përputhshmërinë e Llogarive Tatimore të Jashtme FATCA. Lajmi i keq është se, fshehtësia financiare është ende shumë e gjallë dhe në gjendje të mirë (The Economist 2013). Nëse vende të tjera të zhvilluara apo në zhvillim do të jenë në gjendje të aplikojnë marrëveshje të ngjashme me FATCA, anonimitetit të aplikuar në parajsat fiskale do ti jepej një goditje e rëndësishme dhe si rrjedhojë një koperim në shkallë ndërkombëtare është vendimtar.*

1.4 Identifikimi i Pronësisë Përfituese Fundore


Në kuadër të identifikimit të klientit, identifikimi i strukturës së pronësisë përfituese të personave juridike është një nga sfidat kryesore që përballen sot institucionet finaciare dhe jofinanciare. Kompanitë që kryejnë marrëdhënie biznesi me institucionet financiare banka dhe jo vetëm, kanë struktura të ndryshme duke filluar nga të thjeshta një shtresore në ato shumë shtresore. Origjina e kompanive jorezidente është nga vende të ndryshme dhe rrjedhimisht kërkesat rregullative të shtetit mëmë janë të ndryshme nga ato lokale.

Klientet ndahen në persona fizikë (individë), persona fizikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse, persona juridike privatë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse (shoqëritë tregtare), persona juridike privatë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse (OJF) dhe përfaqësues ligjorë të klientit (*ligji 9917 mbi PPP/FT*). Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionere (*Ligj nr.9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*). Për shoqëritë tregtare është shumë e rëndësishme identifikimi dhe verifikimi i identitetit të pronarit përfitues. *“Pronar përfitues” është personi fizik që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person: zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik; i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë; përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik; kontrollon në çdo lloj mënyrë zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik (ligji 9917 mbi PPP/FT).*

Në kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjekteve financiare, përpara se të kryejnë një marrëdhënie biznesi me klientet persona juridike, ju kërkohet të përcaktojnë personat fizikë, të cilët zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 25% të aksioneve të një kompanie. Subjektet financiare, në bazë të kuadrit rregullativ në fuqi, ju kërkohet të përcaktojnë individët të cilët zotërojnë dhe kanë kontrollin e fundit mbi klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi kompanitë tregtare ose mbi organizimet e

ndryshme ligjore. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë dhe identifikimin e personave fizikë të cilët përbëjnë pjesën vendimarrëse dhe menaxhuese të personit juridik. Në rast të organizimeve ligjore kjo përfshin dhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to. Bankat, në bazë të ligjit Amerikan FATCA, duhet të jenë në gjendje të identifikojnë pronarët përfitues amerikanë që kanë një pjesëmarrje me një vlerë të barabarte ose me të madhe se 10% të aksioneve të një shoqërie. Figura 2 paraqet në mënyrë skematike kuptimin e pronarit përfitues të tërthortë me disa shtresa/nivele (*Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 28 mbi PPP/FT*).

Figura 2. Kompani me pronësi përfituese shumështrësore



Burimi: Udhëzimi 28 i Ministrisë së Financave datë 31.12.2012 mbi PPP

Në nivelin e parë, personi fizik 1 zotëron 30% të aksioneve në kompaninë A dhe rrjedhimisht është pronar përfitues. Në nivelin e dytë vetëm personi fizik 3 është pronar përfitues pasi ai së fundmi zotëron 26% të aksioneve të kompanisë A (duke qenë se ai zotëron 50% të aksioneve të kompanisë C, e cila nga ana tjetër zotëron 52% të aksioneve të kompanisë A). Në nivelin e tretë, personi fizik 4 është pronar përfitues, pasi ai së fundmi zotëron 33.6% të aksioneve në kompaninë A (duke qenë

se ai zotëron 18% të aksioneve të kompanisë A nëpërmjet kompanive B dhe X, si dhe 15.6% të aksioneve të kompanisë A nëpërmjet kompanisë C dhe kompanisë Y ($100\% * 100\% * 18\% = 18\%$, $100\% * 30\% * 52\% = 15.6\%$)).

Rreziqet rriten në lidhje me pronarët përfitues të llogarive sepse mbajtësit e llogarive mund të mundësojnë individët dhe subjektet e biznesit për të fshehur identitetin e pronarit të vërtetë të aseteve apo pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal. Për më tepër, kriminelët, pastruesit e parave, shmangësit e pagimit të taksave dhe terroristët mund të shfrytëzojnë privatësinë dhe konfidencialitetin e disa lloj entitetesh, duke përfshirë kompanitë “guaskë” dhe mjete të tjera të dizenuara për të fshehur natyrën dhe qëllimin e transaksioneve të paligjshme dhe identitetet e personave të lidhur me to. Rrjedhimisht, identifikimi i pronarëve përfitues të disa subjekteve juridikë mund të jetë sfidues, pasi duke analizuar karakteristikat e tyre shpesh në mënyrë efektive mbrojnë identitetin ligjor të pronarit. Një identifikim i tillë mund të jetë i rëndësishëm në zbulimin e aktivitetit të dyshimtë dhe në ofrimin e informatave të dobishme për zbatimin e ligjit (*Guidance on Obtaining and Retaining Beneficial Ownership Information, 2010*).

Në mënyrë që të luftohet dhe parandalohet me sukses keqpërdorimi i produkteve të korporatës për qëllime të paligjshme, është thelbësore që të gjitha juridiksionet të themelojnë mekanizma efektive dhe të mundësojnë autoritetet e tyre për të marrë në kohën e duhur, informacion mbi pronësinë përfituese dhe kontrollin e produkteve të korporatave të themeluar në juridiksionin e tyre për qëllim të hetimit të aktiviteteve të paligjshme, përmbushjen e funksioneve të tyre rregullatore / mbikëqyrëse, si dhe shkëmbimin e informacionit me autoritetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Kjo kërkon respektimin e tre objektivave themelore domethënëse 1) pronësia përfituese dhe kontrolli i informacionit duhet të mbahet ose të jetë i arritshëm nga autoritetet ligjvënëse, 2) duhet të ketë një mbikëqyrje të mjaftueshme dhe integritet të lartë të çdo sistemi për mbajtjen apo marrjen e pronësisë përfituese dhe të kontrollit të informacionit, dhe 3) informacioni jo-publik mbi pronësinë përfituese dhe kontrollin e informacionit duhet të ndahet me mbikëqyrës dhe autoritetet e zbatimit të ligjit (*OECD 2001*).

Institucionet financiare duhet të ngrejné sisteme efikase për të identifikuar qartë pronarët e kompanive, përpara se të vendosin marrdhënie biznesi me to si dhe të monitorojné dhe përditësojnë

në mënyrë të vazhdueshme, ndryshimet që mund të ndodhin në strukturën e pronësisë pas vendosjes së kësaj marrdhënie në bazën e të dhënave të tyre, qoftë elektronike apo në “hard copy”.

Ekziston mundësia që një përqindje e lartë individësh të fshehin pronësinë përfituese mbi korporatat apo të përdorin instrumenta anonime për qëllime të pastrimit të parave apo evazionit fiskal. *Vende të caktuara lejojnë korporatat të inkorporuara ose themeluara në juridiksionin e tyre të përdorin instrumente që errësojnë pronësinë përfituese si për shembull: emërimi i aksionerëve të rremë mbi pronësinë përfituese si dhe emërimi i drejtorëve të rremë duke fshehur identitetin e pronarëve apo ortakëve të vërtetë, të cilët mund të jenë përfshirë në aktivitete të paligjshme. Edhe në vende me ligje të forta të sekretit bankar, autorët e aktiviteteve të paligjshme preferojnë të depozitojnë fitimet e tyre në llogaritë e korporatave, sepse mbrojtja e fshehtësisë bankare mund të hiqet në një situatë të caktuar (OECD 2001).*

Ka shumë zëra që janë kundër deklarimit të pronësisë përfituese e cila dëmton privatësinë dhe arsyet mund të jenë të ndryshme. Në disa vende është thjesht e rrezikshme të zbulosh pronësinë dhe ruajtja e privatësisë është shumë e vlerësuar. Grupet kriminale, sidomos në vendet e botës së tretë, mund të vendosin në shenjestër pronarët përfitues dhe familjarët e tyre nëse kanë informacion të saktë publik mbi shumën e aseteve që ato zotërojnë.

Institucionet e mbrojtjes së të dhënave personale nga ana e tyre dekurajojnë nxjerrjen e të dhënave për palët e treta. Bërja publike e pronarit të fundit përfitues bie ndesh me mbrojtjen e të dhënave personale. Privacia është një e drejtë themelore e një individi. Një pyetje e rëndësishme e ngritur në konferencën e organizuar nga dhoma ndërkombëtare e tregtisë – Vjenë (ICC 2013) ishte: *si të balancojmë Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*. Legjislacionet kanë evoluuar në mënyrë të shpejtë në të dy kahet. Fryma e ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale është e tillë që kufizon në një farë mase bërjen publike të të dhënave personale. *“Të dhëna personale” është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm (Ligji nr. 9887 mbrojtja e të dhënave personale)*. Privatësia është pikërisht e drejta për të ruajtur kontrollin mbi informacionin që na përket, të jemi të vetëdijshëm se shumë nga veprimet tona të përditshme lënë gjurmë në atë mënyrë që zbulojnë detajet e personalitetit tonë, besimit tonë të brendshëm, që jo gjithmonë duam që të tjerët ta njohin (Mauro PAISSAN <http://www.kmdp>).

Fshehja e identitetin mund të ketë edhe arsye të ndershme tregtare. *Në qoftë se të gjithë e dinë se Exxon Mobil, BP ose një kompani tjetër e madhe e naftës është ofruar për një copë tokë në Teksas, çmimi do të rritet menjëherë. Kompanitë që blejnë të drejtat minerare pretendojnë se kompanitë anonime janë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së tyre, kur hyjnë në diskutime me pronarët e tokës. Në disa industri të tregosh pronësinë rrezikon. Ekzistojnë shqetësime legjitime për sigurinë e pronarëve përfitues në firma të tilla si Biotech, të cilët gjurmohen nga aktivistët e të drejtave të kafshëve (The Economist 2012).*

Në kushtet e krizës globale, qeveritë po përpiqen të shkurtojnë rregullat e të bërit biznes dhe jo ti komplikojnë ato. Vendet në zhvillim, të etur për investime të huaja direkte, janë të prirur të tolerojnë përsa i përket dokumentacionit të firmave të huaja. Iniciativat e qeverive Shqiptare “one stop shop”, dhe “Shqipëria 1 Euro” synojnë të lehtësojnë mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri dhe tërheqjen e investimeve të huaja por kjo kërkon shkurtrim të procedurave dhe dokumentacionit për regjistrimin dhe identifikimin e plotë të kompanive të huaja. Në shumë raste të tjera ku kompani të caktuara kontrollohen nga PEP të korruptuar, organizata kriminale apo individë shkelës të ligjit, një transparence më e madhe në drejtim të identifikimit të pronësisë së është në anën e shtetit të së drejtës dhe lirisë.

Problemi i identifikimit të pronësisë përfituese deri në hallkën e fundit të zinxhirit të kontrollit efektive mbi një shoqëri mbetet problem mbarë botëror, i cili është i pranishëm pavarësisht rajonit gjeografik që i përket apo stadi të zhvillimit ekonomik që një vend i caktuar ka. Në rajonin tonë problemet janë të mprehta. *Në Malin e Zi, harmonizimi i ligjeve kundër pastrimit të parave me standardet ndërkombëtare nuk është i plotë. Hetimet nga agjencitë e zbatimit të ligjit të Malit të Zi mbi operacionet e krimit të organizuar dhe transaksionet e dyshimta financiare tregojnë për lëvizje parash të hyra dhe të dala nga institucionet e huaja financiare “off-shore”, duke përfshirë institucionet e vendosura në Ishujt e Virgjër Britanik, Qipro, Seychelles, Panama, dhe Zvicër. Fondet transferuar nga këto institucione janë duke u përdorur për të blerë pasuri të patundshme dhe të mallrave të luksoze konsumit dhe për tu investuar në biznese. Në Gusht 2010, Qeveria e Malit të Zi njoftoi se personat me një reputacion global të besueshëm mund të marrin nënshtetësinë malazeze nëse investojnë drejtpërdrejtë të paktën 500.000 Euro në Mal të Zi dhe ekonominë e tij. Ky vendim u pezullua në fund të vitit 2010, por nuk është hequr formalisht (Money Laundering Report – 2012, US State Department).* Identifikimi i pronësisë përfituese është i

përcaktuar sipas rekomandimeve të FATF në ligjin organik të PPP të Malit të Zi por prezenca ruse në këtë vend ndihet kudo, madje edhe në bursë. Duke qenë se një numer i madh shoqërisht malazeze janë blerë nga shtetas rus edhe transaksionet në burse kanë pësuar rënie këto kohët e fundit. Se sa nga këto shtetas rus janë oligarkë me burime të dyshimta fondesh është e vështirë të thuhet.

Në Kosovë, megjithëse institucionet shtetërore janë më të reja, kemi një përkufizim të plotë të pronarit përfitues sipas rekomandimeve të FATF-së. Ligji nr. 04/L-178 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 03/L-196 Për PPP dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit në Republikën e Kosovës” përcakton se: *të gjitha subjektet raportuese duhet të identifikojnë pronarin përfitues dhe/ose një person ose personat fizik të cilët kontrollojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi njëzet përqind (20%) ose më shumë të një personi juridik. Rrjedhimisht përcaktohet se pronar përfitues është personi fizik (individ), i cili i fundit ushtron kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik. Gjashtë mujori i parë i vitit 2013, ishte një periudhë e rëndësishme dhe e frytshme për NIF të Kosovës (Tipologjitë NIF Kosova). Ka patur disa tipologji të rëndësishme ku përfshihen edhe pronarët përfitues të disa kompanive të akuzuar për pastrimin e parave.*

Në rastin e Maqedonisë është definuar qartë terminologjia e pronarit përfitues në legjislacionin organik të PPP, i cili është konform standarteve ndërkombëtare. Maqedonia nuk konsiderohet një qendër rajonale financiare. *Pastrimi i parave në Maqedoni është e lidhur kryesisht me krimet financiare si evazioni fiskal, kontrabanda, mashtrimet financiare dhe privatizimi, mashtrimi me siguracionet, rryshfeti, shpërdorim të pozitës zyrtare dhe korrupsionit. Shumica e të ardhurave që pastrohen vijnë nga aktivitetet kriminale vendase. Një pjesë e vogël e pastrimit të parave mund të jetë aktiviteti i lidhur me trafikimin e narkotikëve, megjithëse nuk ka prova të organizatave të trafikimit të narkotikëve apo grupe terroriste që kontrollojnë pastrimin e parave. Grupet e krimit të organizuar të përfshira në trafikimin e armëve apo njerëzve në Maqedoni mund të kenë pastruar të ardhurat nga këto aktivitete duke investuar në biznese (Money Laundering Report – 2012, US State Department).*

Institucionet financiare të vendeve të ballkanit perëndimor, aspirante për t’ju bashkuar familjes së madhe Evropiane, përballen me sfidën e identifikimit të pronësisë përfituese. Autoritetet përgjegjëse duhet të rrisin bashkëpunimin rajonal në parandalimin e veprave të produkteve të pastrimit të parave. Kjo do ta ulte ndjeshëm presionin mbi subjektet financiare dhe jofinanciare.

1.5. Personat e Ekspozuar Politikisht PEP

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme në parandalimin e pastrimit të parave është edhe identifikimi i plotë i personave të ekspozuar politikisht PEP dhe transaksioneve të kryer prej tyre. PEP konsiderohen individë të cilët mbajnë ose kanë mbajtur poste të larta shtetërore. Rekomandimet ndërkombëtare të FATF-së, Direktiva Europiane 2005/60/EC e Komitetit Evropian mbi PPP, kërkojnë nga institucionet financiare dhe subjektet e tjera ligjore që personat të cilat mbajnë poste zyrtare të larta të jenë në qendër të vëmendjes pasi PEP të korruptuar paraqesin një rrezik të lartë në lidhje me çështje të pastrimit të parave dhe evazionit fiskal.

“PEP” janë personat të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarinë e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin “Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil (ligj 9917 mbi PPP/FT). Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi. PEP janë Individët të cilët janë ose kanë qenë ngarkuar me funksione publike të spikatura në një shtet tjetër si dhe anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e ngushtë që kanë lidhje biznesi me PEP (FATF rekomandimi 9).

Në kategorinë PEP përfshihen: kryetarët e shteteve, kryeministrat, ministrat dhe zëvendës ministrat, anëtarët e parlamentit, oficerët e lartë të forcave të armatosura, anëtarët e bordeve administrative ose mbikëqyrëse të ndërmarrjeve shtetërore. PEP konsiderohen gjithashtu anëtarët e gjykatave të larta, gjykatave kushtetuese ose organeve të tjera të larta gjyqësore vendimet e të cilave përgjithësisht nuk bëhen objekt i një ankimi të mëtejshëm, anëtarët e bordeve të bankave qendrore dhe ambasadorët. Të rëndësishëm janë pjesëtarët e drejtpërdrejtë të familjes ku përfshihen bashkëshortët, partnerët, fëmijët, prindërit, bashkëpunëtorët e ngushtë të njohur bazuar në formacionet që dihen publikisht. Përkufizimi i PEP nuk përfshin individët e rangut të mesëm

apo të ulët, të cilët i përkasin kategorive të mësipërme. PEP ndahen në të brendshëm ku përfshihen të gjithë PEP që mbajnë pozita të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë dhe të jashtëm ku përfshihen PEP ndërkombëtar.

Institucionet financiare dhe jofinanciare duhet identifikojnë fillimisht PEP dhe pronarët përfitues PEP që zotërojnë kompanitë. Gjithashtu shumë e rëndësishme është identifikimi i burimit të pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht.

Korrupsioni është çështja më e nxehtë që ka lidhje me PEP. Presioni në rritje mbi qeveritë e korruptuara ka detyruar disa liderë të lenë detyrën gjatë vitit 2011, *por pa u pastruar akoma pluhuri është bërë e qartë se nivelet e rryshfetit, shpërdorit të pushtetit dhe marrëveshjeve sekrete janë ende shumë të larta në shumë vende* (Transparency International 2012). *Ndërsa PEP të korruptuar mund të jetë një pjesë e vogël e të gjithë numrit të PEP-ve, sjellja e një PEP të vetëm të korruptuar mund të ketë një ndikim të madh mbi një vend dhe nganjëherë në një rajon të tërë* (Greenberg, Gray, 2010).

Korrupsioni i PEP ndodh në nivele të larta të sistemit politik. *Korrupsioni politik është çdo transaksion midis aktorëve të sektorit privat dhe publik përmes të cilit mallrat kolektive janë konvertuar në mënyrë të paligjshme në përfitime private. Korrupsioni politik apo i madh ndodh në nivele të larta të sistemit politik, kur politikanët dhe agjentët shtetërorë kanë të drejtë të bëjnë dhe zbatojnë ligjet në emër të popullit, por e përdorin këtë autoritet për të mbështetur statusin, pushtetin dhe pasurinë e tyre* (Byrne 2007).

Ekziston një perceptim mbarëbotëror se personat në strukturat e larta shtetërore mund të jenë të korruptuar. Sondazhi i Transparency International i vitit 2010 i mbajtur në 86 vende me të ardhura të ulëta, të mesme dhe të larta, vlerëson partitë politike dhe funksionaret e lartë politike si më të korruptuarit (tabela 5).

Tabele 5. Vlerësimi i sektorit/institucionit në lidhje me korrupsionin

Partitë politike	79%
Funksion publik / Nëpunës civil	62%
Parlamenti / Legjislatura	60%
Policia	58%
Sektori i biznesit privat	51%
Organizmat fetare	50%
Gjyqësori	43%
OJF-të	30%
Ushtria	30%

Burimi: Transparency International - Barometri i korrupsionit global për vitin 2010

Qeveritë nuk mendohet se kanë bërë sa duhet për ti detyruar të korruptuarit të japin llogari. Shumica e njerëzve në mbarë botën besojnë se qeveritë e tyre janë të pafektshme në luftën kundër korrupsionit dhe korrupsioni në vendin e tyre po bëhet më keq (*Global Corruption Barometer 2013*). Kriza financiare globale e vitit 2008, e cila shfaq efektet e veta tek pastrimi i parave dhe evazioni fiskal, i bën njerezit më të pambrojtur nga korrupsioni. Në ish vendet e Evropës Lindore firmat që nuk janë të gatshëm të paguajnë rryshfete humbasin gjithnjë e më shumë përballë atyre konkurrencte që paguajnë, të tilla si ruse, kineze. Bizneset kanë frikë se duke mbajtur qëndrim ndaj rryshfeteve do të përballen me dënime si ngacmime burokratike, kërkesa arbitrare të tatim/taksave ose mospërzgjedhje në kontratat publike. Miliarda euro fonde të dhëna nga Brukseli për modernizimin e infrastrukturës dhe shërbimet publike për vendet që kanë hyrë në BE, shpesh përfundojnë në praktika korrupsioni. Kompanitë, politikanët dhe zyrtarët që bashkëpunojnë për të fiksuar tenderat janë të veshur me imunitet dhe zakonisht ia hedhin pa u ndëshkuar. Mbikëqyrësit e ligjit janë të dobët, dhe votuesit duken apatike dhe cinik (*The Economist 2011*).

Rreth 130 mijë njerëz nga 170 vende, dyshohet se i kanë depozituar paratë e tyre në institucionet financiare jashtë shteteve të tyre. Një burim anonim ka mundur të nxjerrë të dhëna nga rreth 2,5 milionë dokumente, ku tregohet se cilat janë rrugët sekrete për të fshehur pasuri të mëdha jashtë vendit, pa u taksuar nga autoritetet fiskale. Mes tyre bëjnë pjesë firmat që kanë vetëm një kuti postare në një vend, nga ku evadorët fiskalë mund të fshehin gjurmët e bizneseve të tyre. Ekspertët

vlërësojnë se rreth 2100 miliardë USD mund të fshihen në llogari të tilla. Shumë prej këtyre individëve mund të jenë PEP (Der Spiegel 2013).

Raporti i bazuar në projektin “CRINIS”, i cili është realizuar në 5 vende të Ballkanit Perëndimor, (Shqipëri, Kroaci, Serbi, Maqedoni e Kosovë), kërkoi të rritet transparencja e financimit të partive politike në Shqipëri. Raporti vlerëson 10 dimensione të çështjes përfshirë kontabilitetin e brendshëm të partive, raportimin e partive tek autoritetet mbikëqyrëse, intensitetin dhe besueshmërinë e raportimit, si dhe aktivitetin monitorues nga shoqëria civile (TIA 2013).

Rrjedhimisht identifikimi i plotë i PEP-ve dhe i transaksioneve të kryer prej tyre është një sfidë e rëndësishme për subjektet raportuese dhe ligjvënëse në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

1.6 Zhvillimet teknologjike dhe Pastrimi i Parave

Zhvillimet e reja teknologjike në fushën e sistemit bankar, krahas përmirësimeve që sjellin në punën operacionale dhe lehtësimit e të bërit biznes, kanë sjellë edhe një sërë problemesh të rëndësishme në identifikimin e klientit dhe strukturën e pronësisë përfituese. Ekziston mundësia e keqpërdorimit të produkteve të kartës së kreditit dhe të “Internet Banking” pasi punonjësit e institucioneve financiare nuk kanë një përballje fizike të drejtpërdrejtë me klientët në kohën e kryerjes së transaksionit. *Përparimet teknologjike që duket të jenë të përditshme, njëkohësisht janë shfrytëzuar plotësisht nga kriminelët dhe pastruesit e parave. Ritmi i shpejtë i ndryshimit dhe mjedisi i paqëndrueshëm i biznesit rezultojnë të krijojnë një mjedis ideal për kriminelët dhe bashkëpunëtorët e tyre (Lilley 2006).*

Katër rreziqe potenciale të pastrimit të parave në lidhje me sistemet e pagesave në internet përfshijnë: llogaritë anonime, financimin anonim në (ATM), llogari fondesh me limit të lartë apo pa kufizime limitesh, ofrues shërbimesh në parajsat fiskale që nuk respektojnë ligjet e një juridiksioni tjetër. Zbutja e këtyre rreziqeve përfshijnë kërkesat adekuate dhe proceset për të identifikuar mbajtësin e llogarisë, të dhënat identifikuese të transaksioneve midis pagesit dhe marrësit, monitorimin e transaksioneve dhe raportimin e aktivitetit të dyshimtë, kufizimin e

mundësisë së financimit etj. Vështirësia në kryerjen e një mbikëqyrje të duhur të këtyre shërbimeve qëndron në profilin e tyre virtual (*raporti FATF 2006*).

Subjektet raportuese dhe veçanarisht institucionet financiare, duhet të zbatojnë politika dhe të marrin masat e duhura, sipas rastit, për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me: *zhvillimet e produkteve të reja, praktikave të biznesit, mënyrat e ofrimit apo kanalet e shpërndarjes; përdorimin e teknologjive të reja apo atyre që janë në zhvillim. Këto masa duhet të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja, praktikave të biznesit apo teknologjive të reja, në mënyrë që të administrohen dhe të ulen rreziqet e identifikuar. Subjektet duhet të zbatojnë procedura specifike dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit. Masat e vigjilencës së duhur duhet të zbatohen nga vetë subjektet e këtij ligji dhe mbështetja në palë të treta nuk është e lejuar (Ligj 9917 mbi PPP/FT).*

Sistemet e pagesave në internet mund të lejojnë transaksione me llogaritë anonime. Sistemet e internet banking të pagesave në qendrat financiare "off-shore" mund të lehtësojnë transaksione që janë të paligjshme në legjislacionin e vendit të dërguesit. Në disa raste, kur fondet e drejtpërdrejta transferohen tek marrësi përfundimtar dhe bllokohen në bazë të ligjeve të brendëshme të një vendi, pagesi mund të transferojë fondet nëpërmjet sistemit të pagesave online në qendrat "off-shore" që veprojnë nën një regjim tjetër rregullator (*raporti FATF 2006*).

Krimi kibernetik "Cybercrime" po merr një rëndësi të veçantë në pastrimin e produkteve të krimit në shkallë globale. Shpeshherë krimi i organizuar është një hap para autoriteteve të zbatimit të ligjit. Krimi kompjuterik përfshin veprat penale kundër konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave kompjuterike. Abuzuesit e ligjit kryejnë hyrje të paligjshme në sistemet kompjuterike, ndërhyjnë në bazën e të dhënave, duke përfshirë dëmtimin, fshirjen, ose ndryshimin e të dhënave kompjuterike si rrjedhojë mund të manipulohet me identifikimin e klientit.

Ndër metodat më të sofistikuar të përdorura janë "Malware" dhe "Botnets". Malware mbetet mjeti kryesor për kryerjen e krimit kibernetik. Malware ka evoluar në një industri të madhe me një infrastrukturë ekonomike komplekse me banda kriminale të mirë-organizuara dhe të mirë-financuara. Viruset, worms dhe trojans menjanojnë aplikacione të sigurisë, vjedhin login-et e

llogarive, dhe të dhënat e tjera dhe konsiderohen si nga më të rrezikshmet. Botnets përbëhen nga grupe të kompjuterave individuale që janë të infektuara me një pjesë të malware i cili i kthen këta kompjuterë të infektuar në "robota" (bots) ose "zombies" që janë të kontrolluara në distancë dhe pa dijeninë e pronarëve të kompjuterëve nga ideatorët apo mjeshtra të botnet. Botnets vazhdojnë të konsiderohen kërcënim kryesor në lidhje me krimin kibernetik dhe sigurinë e informacionit (Moneyval 2012). Një bandë "kiberkriminelesh" ka arritur të grabisë rreth 45 milion dollarë nga pirateria në një bazë të dhënash të kartave të debitit të parapaguara dhe bankomateve nëpër botë. Agjensitë e zbatimit të ligjit në Japoni, Kanada, Britani të Madhe, Rumania dhe 12 vende të tjera kanë qenë të përfshirë në hetim. Në vend të armëve dhe maskave, kjo organizatë e krimit kibernetik ka përdorur laptopë dhe internetin (BBC 2013).

Një zhvillim i rëndësishëm në fushën e zhvillimeve të reja teknologjike është monedha-kibernetike "Bitcoin". Bitcoin ofron një alternativë ndaj sistemit konvencional bankar. Kjo është arsyeja pse institucione të fuqishme janë aq të kujdesshëm ndaj këtij fenomeni. E lançuar për herë të parë në vitin 2009 nga një figurë misterioze me emrin Satoshi Nakamoto, monedha kibernetike është bërë për të qenë e pavarur nga autoritetet monetare dhe bankat. Duke përdorur software në dispozicion të publikut që vepron nëpërmjet një rrjeti prej rreth 20.000 kompjuterash të fuqishëm, njësitë e monedhës kibernetike janë krijuar nga aplikimi i një formule matematikore në një proces të njohur si "miniera Bitcoin". Ndryshe nga monedhat e kontrolluara nga qeveritë të cilat mund të lëshohen në sasi të pakufizuar, vetëm rreth 21 milion bitcoins mund të prodhohen gjithësej (BBC, 2013).

Në vend që të mbështeten nga politikanë dhe bankierë, apo tekat e demokracisë, përdoruesit bitcoin e vënë besimin e tyre në ligjet e matematikës. Për ta, monedha kibernetike është e qeverisur nga një formulë e pakorruptueshme (Reuters, 2011). Monedha bitcoin është kritikuar si një mjet për spekulatorët dhe pastruesit e parave dhe vlera e saj ka patur luhatje të mëdha si pasojë e "hacking". Më shumë bitcoins, më shumë probleme. Hakerat janë duke sulmuar gjithnjë e më shumë poseduesit e bitcoins (CNBC 2013). Këto shkëmbime janë të parregulluara dhe detyrimet e tyre për të raportuar aktivitetet e dyshimta tek autoritetet, njësoj si institucionet të tjera financiare të licensuara nga autoritetet përkatëse, janë akoma të paqarta. Kriza financiare qipriote rriti së ndjeshmi vlerën e bitcoin. Kjo ndodhi në momentin kur u hap lajmi se një pjesë e "bailout" të bankave të vendit do të financohet nga një përqindje e llogarive të depozituesve. Universiteti i Nikosia në Qipro është bërë universiteti i parë i akredituar për të pranuar bitcoin për pagesat për

shkollim dhe pagesat të tjera të ngjashme (Reuters 2013). Duke marrë parasysh që Qipro është një vend “off-shore” ku ka mjegullnajë në lidhje me transparencën e pronësisë përfituese, kalimi jashtë sistemit konvencional bankar e veshtirëson së tepërmi punën e autoriteve ligjvënëse dhe institucioneve financiare. Praktikisht edhe kontrolli i “fluturimit të kapitalit” bëhet shumë i vështirë.

Institucionet financiare, nga ana e tyre, kryejnë investime të mëdha dhe kanë hartuar procedura të brendshme për tu mbrojtur nga keqperdorimi i produkteve të reja teknologjike dhe nga sulmet kibernetike. Autoritet ligjvënëse e kanë të vështirë të ekzekutojnë në vend inspektime në një marrdhënie tregtare virtuale.

Në përgjigje të rritjes së rrjedhës së parave penale në internet, organizatat e sektorit publik dhe privat duhet të miratojnë një sërë masash të cilat mund të shërbejnë si praktika të mira për parandalimin e pastrimit të parave. Këto masa përfshijnë krijimin e një kuadër ligjor bazuar në standartet ndërkombëtare, krijimin e njësisive të specializuara për parandalimin e krimit të teknologjisë së lartë, bashkëpunimin ndërinstitucional midis autoriteteve përgjegjëse të hetimit financiar, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik (*Moneyval 2012*). Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve ligjvënëse dhe institucioneve financiare në çështje të caktuara duhet të jetë i dixhitalizuar për një parandalim në kohe reale të transaksioneve të dyshimta.

KAPITULLI II

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Kapitulli i dytë fokusohet tek metodologjia e përdorur për kërkimin e dizertacionit. Në punim janë përdorur të dhëna sekondare nga literatura e fundit bashkohore. Gjetjet janë përpunuar nga pyetjet e gjysmëstrukturuara. Për shkak të natyrës dhe kufizimeve të punimit është përdorur metoda cilësore pasi metoda statistikore nuk do të arrinte rezultatet e dëshiruara.

2.1 Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi është përdorur një kombinim i të dhënave primare me ato sekondare. Kërkimi sekondar i ka paraprirë kërkimit primar. Ndër të dhënat sekondare një vend të rëndësishëm zë literatura e gjerë bashkohore mbi pastrimin e parave. Në studim janë shfrytëzuar një seri e gjerë burimesh të tjera sekondare, në formën e literaturës akademike, raporteve të organizmave të rëndësishëm ndërkombëtar apo publikimeve të tjera që i shërbejnë kapitullit të parë. Janë përdorur burimet më të azhornuara të informacionit si interneti dhe bibliotekat elektronike.

Një ndihmesë e veçantë kanë qenë raportet e autoritetit përgjegjës DPPP dhe atij mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë si dhe raportet e institucioneve ndërkombëtare si FATF, FMN, Banka Botërore etj. Studimi është bazuar kryesisht në artikuj “on line” dhe publikime që kanë të bëjnë me fenomenin e “Parandalimit të Pastrimit të Parave”. Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave sekondare janë siguruar nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve të internetit si faqja zyrtare elektronike e “Reuters”, “The Gardian”, “BBC” si dhe prestigjozja “The Economist”.

Pasi u shqyrtuan konceptet, teoritë, variablat më të rëndësishme, përkufizimet konceptuale dhe problematika, u krijua mundësia e implementimit të kërkimin të dëshiruar në ambjentin Shqiptar. Përsa i përket studimit primar, filozofia e kërkimit është zgjedhur “fenomenologjia”. Idea bazë në të cilën mbështetet filozofia “fenomenologji” është se bota dhe realiteti nuk janë objektiv, pasi janë

të ndërtuar në mënyre sociale nga njerezit të cilët situatave të ndryshme u japin kuptime të ndryshme. Fenomenologjia është filozofia bazë e kërkimit cilësor. Trajtimi cilësor është i karakterizuar nga një orientim i lirë i objektivave dhe pranim natyral i skemës së objekteve. Për këtë studim, filozofia “fenomenologjike” ishte më e përshtatshme, meqenëse projekti kërkimor nuk mbështetej në objektivitet. Qëllimi është të ekzaminohet opinioni subjektiv i aktorëve kryesorë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Duhej të investigonim opinione të ndryshme, mendime, ndjenja, dhe sjellje duke përdorur metodën cilësore ku studiuesi është pjesë e procesit dhe përdor komunikimin dhe vëzhgimin.

Për sa i përket qasjes së studimit është përdorur Induktivizmi. Trajtimi induktiv prezanton paradimën “fenomenologjike”. Zakonisht analiza cilësore ndjek procesin induktiv i cili nis me humultimin e elementeve specifik dhe përfundon me përgjithësimin. Pyetjet në studim janë çfarë dhe pse? Në rastin e metodës induktive nisemi nga vëzhgimet e veçanta për të arritur aspektet e përgjithshme, për të pyetur nëse ekziston një rregull apo një parim për këtë gjë që observojmë (Holger 2011).

Në këtë kërkim, është përdorur metoda cilësore meqenëse të dhënat janë mbledhur nga një grup relativisht i vogël të pyeturish dhe nuk do të analizoheshin me teknika statistikore siç ndodh në metodat sasiore të kërkimit. Strategjia e kërkimit është ajo e analizës cilësore që bazohet në “intervistë në thellësi”, “intervistë dyshe” dhe “grupe fokusi”. Intervistat në thellësi dhe intervistat dyshe janë parë si metodat më e mirë për një depërtim në brendësi të opinionit personal, besimit dhe vlerave. Ky mjet kërkimi i cili është fleksibël, e pajis kërkuesin me një informacion shumë të thellë në fushën e kërkimit. Vetëm në këtë mënyrë kërkuesi është në gjendje të njohë pikpamjet kryesore të aktorëve kryesorë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe të ketë mundësi të bashkëpunojë më shumë se parashikimi po të jetë e nevojshme. Gjetjet janë të interpretueshme por jo të matshme, e cila është karakteristike e studimit cilësor.

Intervistat u zhvilluan një nga një dhe u bazuan në pyetje të hapura ose gjysëm të strukturuar. Për këtë, gjatë fazës së kërkimit primar u përgatit një pyetësor i gjysmë-strukturuar, i cili mblodh perceptimet dhe qëndrimet e personave përgjegjës rreth çënueshmërisë së sektorit ku punojnë dhe sfidave që përballen institucionet e tyre nga elementë të pastrimit të parave. Pyetjet ju drejtuan ekspertëve me një njohuri të mirë të sektorëve financiarë dhe të biznesit në vend si për shembull drejtues, oficerë të përputhshmërisë së institucioneve financiare, zyrtarë të zbatimit të ligjit dhe

përfaqësuesve të profesioneve të lira. Përqasja është fleksibël dhe e orientuar natyrshëm sipas rastit.

Pyetjet kërkimore drejtuar të intervistuarve konsistojnë kryesisht në vlerësimin mbi transaksionet në para fizike, masat e vigjilencës së duhur bazuar në nivelin e rrezikut, identitetin e klientit përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientët, identifikimi i pronarit përfitues (person fizik) të klientëve parësore dhe rastësore, monitorimi i vazhdueshëm i të dhënave të klientit si dhe vështirësitë që hasen në këtë drejtim, identifikimin e PEP, rrezikun që vjen nga parajsat fiskale “off-shore” dhe “jo rezidentet” etj.

Në rastin e bankave janë intervistuar thellësisht 13 persona përgjegjës për parandalimin e pastrimit të bankave të madhësive të ndryshme të cilët janë kryesisht Drejtorët e Përputhshmërisë, Drejtorë të Përgjithshëm si dhe Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës së Bankave. Nga institucionet shtetërore janë intervistuar 5 përfaqësues nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA), DPPPP dhe Banka e Shqipërisë. Në rastin e profesioneve të lira jofinanciare janë intervistuar 7 përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, IEKA, shoqëritë audituese, ekspertë kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistë të miratuar të pavarur dhe vlerësues të pasurive të paluajtshme.

Numri i të intervistuarve gjithsej është 25, ndërsa pyetjet kërkimore të përdorura gjatë intervistave janë të pasqyruara më të detajuara në Apendiks I.

2.2 Kufizime të punimit

Duke qenë se kemi të bëjmë me të ardhura të gjeneruara në “të zejë”, problemi është mjaft i gjërë dhe kompleks dhe nuk mund të përcaktohet me saktësi shkalla e tij. Një pjesë e të intervistuarve shfaqnin rezerva në dhënien e informacionit duke marrë parasysh që materiali do të prezantohet dhe nuk kritikonin hapur legjislacionin në fuqi. Problematika e trajtuar është mjaft teknike dhe publiku i gjërë nuk ka informacionin e duhur. Ekspertët e fushës me anë të intervistave në thellësi dhanë informacione të vlefshme në fushën e kërkimit.

Për vetë natyrën e tij, pastrimi i parave ndodh jashtë rrezes së statistikave normale ekonomike të një vendi të caktuar. Institucione të njohura si FATF, FMN etj. përpiqen me anë të statistikave të

përafërta që problemit ti jepet një sens shkalle dhe nuk mund të përcaktohet qartë madhësia e problemit. Për këto arsye metodologjia e kërkimit është zgjedhur cilësore pasi kërkimi sasior nuk do të sillte rezultatet e duhura.

2.3 Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të përdorura në këtë studim janë:

1. A sjell vështirësi identifikimi i pronarit përfitues i cili ushtron i fundit kontrollin mbi një shoqëri tregtare me strukturë pronësie shumë shtresore në operativitetin e subjekteve financiare dhe jo financiare dhe a kërkohen amendime në kuadrin rregullativ në fuqi?
2. A hasni vështirësi në identifikimin i klientit për degët apo filialet e një kompanie të huaj me rezidencë në vendet e tjera (sidomos në qendrat financiare “off-shore”) dhe a mendoni se kërkohen amendime në kuadrin rregullativ në fuqi dhe krijimi i regjistrave të aksesueshëm ndërkombëtar me të dhëna mbi pronësinë përfituese?
3. A hasni vështirësi në identifikimin e anëtarëve të familjes dhe personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale me PEP dhe a duhet autoritet ligjvënës të mundësojnë listat e plota të PEP?
4. Çfarë peshe zënë investimet në teknologjinë e informacionit në lidhje me PPP në banka dhe a duhet të shikohet mundësia nga autoriteti përgjegjës apo mbikëqyrës për harmonizimin e proceseve për ndarjen e kostove ndërmjet subjekteve?
5. A duhet të përjashtohen profesionet e lira nga detyrimi i raportimit të RTV-ve dhe të fokusohen vetëm tek raportimi i RAD-ve?
6. A duhet të përfshihen transaksionet me natyrë evazioni fiskal në kërkesat rregullative të vigjilencës së zgjeruar të PPP dhe a duhet të raportohen ato si RAD?

KAPITULLI III

3. PREZANTIMI I GJETJEVE TË STUDIMIT

Problematikat që trajtohen në këtë seksion kanë të bëjnë me shqetësimet reale që përballen personat e intervistuar në vazhden e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ dhe në shmangien e rrezikut reputacional. Ekzistojnë disa hendeqe ligjore të cilat duhet të adresohen dhe të merren masa për ndryshime dhe amendime përkatëse në mënyrë që institucionet financiare dhe subjektet e tjera ligjore të mos vihen përballë vërshtirësive rregullative. Institucionet kompetente ligjvënëse eventualisht do të kenë një qasje më efektive në luftën ndaj këtij fenomeni. Zgjidhja e këtyre problematikave do të përmirësonte mjedisin ligjor të të bërit biznes në vendin tonë.

Subjektet financiare bankë dhe profesionet e lira jofinanciare gjenden përballë rrezikut reputacional për mospërbushje të kërkesave ligjore dhe rregullative. Secila prej këtyre çështjeve merr rëndësi të veçantë në situata të veçanta që lidhen me karakteristikat e vendit amë të korporatave shumëkombëshe, karakteristikat e vetë korporatave, si dhe industritë ku operojnë subjektet financiare dhe jofinanciare.

Evidentohen dhe adresohen problematikat që hasin institucionet financiare dhe jofinanciare në identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me klientin.

Bankat dhe profesionet e lira jofinanciare hasin vështirësi në identifikimin e klientëve jorezidentë dhe veçanarisht korporatat me seli në vendet “off-shore”. Korporatat “off-shore” përdorin një anonimitet të lartë të pronësisë përfituese dhe produkte të dyshimta si aksionet e mbajtësit dhe marrëveshjet e mirëbesimit.

Adresohet problematika e listave jo të plota të PPP të vëna në dispozicion të subjekteve financiare dhe profesioneve të lira jofinanciare. Listat e plota do të zvogëlonin ndjeshëm abuzimin që mund të vijë nga personat e ekspozuar politikisht PEP të korruptuar.

Përdorimi i zhvillimeve të reja teknologjike nga persona të inkriminuar mund të parandalohet në kohe reale nëse instalohen programe kompjuterike inteligjente të cilat përmbajnë tipologjitë e pastrimit të parave por kostot janë të konsiderueshme.

Sa i përket raportimit të profesioneve të lira jo financiare, shqyrtohet ngarkesa e tepërt dhe e pa nevojshme e raportimit të vlerave dhe shtrirja e trajtimit të sekretit profesional edhe tek profesione të tjera jo financiare krahas avokatëve.

Domosdoshmëria e qartësisimit dhe përfshirjes së tipologjive të evazionit fiskal në kuadrin ligjor të pastrimit të parave merr një rëndësi të veçantë. Është e nevojshme njëhësi i fenomenit të evazionit fiskal me pastrimin e parave pasi të dy proceset përdorin elementë shumë të ngjashëm.


3.1 Pyetja kërkimore nr. 1.

Identifikimi i klientit është një aspekt parësor në parandalimin e fenomenit të pastrimit të parave. Problematika kryesore që hasin subjektet financiare dhe jofinanciare në këtë drejtim është identifikimi i plotë i pronësisë përfituese si një nga pikat themelore të identifikimit të klientit. Fokusi është kryesisht në sistemin bankar ku edhe numri i të intervistuarve është më i madh. Klientët ose transaksionet e tyre mund të jenë me tregues të nivelit të rrezikut më të lartë, kur struktura e pronësisë së kompanisë duket e pazakontë ose tepër komplekse, duke patur parasysh edhe natyrën e biznesit të kompanisë. Subjektet financiare dhe jofinanciare duhet të verifikojnë klientët e tyre me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të pronarit përfitues përfundimtar dhe të strukturës së pronësisë. Identifikimi i pronarëve përfitues përfundimtar të klientëve të cilat janë shoqëri anonime me pronësi shumë shtresore paraqitet tepër kompleks dhe me mangësi në kuadrin ligjor dhe rregullativ. Këto mangësi duhet të adresohen pasi problematika rëndon mbi subjektet raportuese financiare dhe jofinanciare. Bazuar në argumentet e mësipërme është formuluar pyetja kërkimore në vijim:

A sjell vështirësi identifikimi i pronarit përfitues i cili ushtron i fundit kontrollin mbi një shoqëri tregtare me strukturë pronësie shumë shtresore në operativitetin e subjekteve financiare dhe jo financiare dhe a kërkohen amendime në kuadrin rregullativ në fuqi?

Rezultatet e kërimit janë të pasqyruara në grafikun 1. Numri i të intervistuarve që janë shfaqur pozitiv për pyetjen kërkimore është 15 ndërsa vetëm njëri prej të intervistuarve ka mbajtur një qëndrim negativ. Të intervistuarit qoftë nga subjektet private raportuese apo nga institucionet shtetërore ishin pro ndryshimeve rregullative për përmirësimin e kuadrit rregullativ. Nga institucionet shtetërore vetëm një i intervistuar ishte i mendimit që subjektet private raportuese duhet të bënin më shumë sa i përket identifikimit të klientit dhe se për momentin nuk janë të domosdoshme ndryshimet rregullative.

Grafiku 1.



Institucionet financiare dhe jo financiare duhet të zbatojnë vigjilencën e duhur për verifikimin e klientëve të tyre. Për këtë qëllim, ato kanë në fuqi politika dhe procedura të brëndshme rregullative të cilat mundësojnë identifikimin dhe verifikimin e pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies së biznesit me klientet e tyre. Këto procedura, parashikojnë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën ekonomiko-ligjore të biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut që ai paraqet.

Në varësi të rrezikut që klientët paraqesin, institucionet financiare duhet të aplikojnë edhe vigjilencë të zgjeruar ndaj klientit e cila është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “Njihe klientin tënd”, që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar identitetin e klientit; për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së llogarive të tij bankare; për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore (*ligj 9917 mbi PPP/FT*).

Shqetësim kryesor në sistemin bankar, në vendin tonë është identifikimi i strukturës së pronësisë përfituese të shoqërive anonime. Kuadri i përgjithshëm ligjor dhe rregullativ në vendin tonë mbi pronësinë përfituese, i vendos institucionet bankare dhe më gjerë përballë disa situatash komplekse dhe si rrjedhojë kërkohet një ekzaminim dhe rirregullim i disa akteve normative të veçanta. Subjektet raportuese, në kuadër të vigjilencës së duhur, duhet të kryejnë identifikimin dhe verifikimin e zotëruesit përfundimtar të personit juridik duke kërkuar dokumente shtesë të cilat provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfitues apo zotëruesit përfundimtar me personin juridik që kryen transaksionin.

Për “Personat Juridikë”, struktura e pronësisë aktualisht përcaktohet nga dokumenti zyrtar i QKR-së i cili paraqitet në bankë nga klienti, përfaqësuesi ligjor i tij apo personi i autorizuar me prokurë. Ekstrakti i QKR-së është i detyrueshëm për personat fizikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse, për personat juridikë privatë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse dhe për personat juridikë privatë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse. Bankat gjithashtu janë të lidhura “online” me faqen zyrtare të QKR-së nga ku verifikohen ekstraktet e kompanive. Aktualisht nuk ka asnjë regjistër tjetër publik apo ndonjë formë tjetër që banka mund të lidhet “online” dhe të merret si bazë për identifikimin e pronarit përfitues. Në rastin e vendit tonë është më e lehtë të identifikohet struktura e pronësisë së një kompanie lokale por situata nuk është e njejtë për kompani të huaja ose me pronësi me aksione të mbajtësit. Shumica e kompanive lokale, duke qenë se edhe ekonomia jonë e tregut është në hapat e para, nuk e kanë shumë të koklavitur strukturën e pronësisë. Më së shumti gjejmë kompani vetëm me një ose disa pronar përfitues persona fizikë. Mungesa e transaksioneve të koklavitura të aksioneve të mbajtësit e bëjnë më të lehtë identifikimin e plotë të strukturës së pronësisë që shkon deri tek identifikimi i plotë i të dhënave të pronësisë përfituese fundore.

Për sa i përket personave fizikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse, pronari përfitues përfundimtar është mbajtësi i llogarisë dhe si rrjedhojë është lehtësisht i identifikueshëm dhe i verifikueshëm, ndërsa në rastin e personave juridikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse strukturat e pronësisë përfituese mund të jenë me disa nivele. Në disa raste që të arrihet tek pronarët përfitues të fundit të një kompanie, duhet të identifikohen shumë kompani të tjera të cilat zotërojnë njëra tjetrën. Ky numër mund të arrijë deri në shtatë shtresa apo më tepër. Në çdo rast pronarë përfitues janë personat fizikë (individë), të cilët zotërojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 25% të aksioneve të një kompanie. Strukturat e pronësisë së kompanive mund të jenë komplekse. Në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit QKR, shpesh herë janë të regjistruar vetëm aksionerët e nivelit të parë dhe jo nivelet e tërthorta të pronësisë ose janë regjistruar përfaqësues ligjorë të personave juridike dhe jo aksionerët e kompanisë. Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë tregtare të kërkuara për regjistrimin në QKR nuk janë të mjaftueshme për të identifikuar pronarin përfitues të shoqërive shumë shtresore. Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare në QKR janë të domosdoshme disa të dhëna identifikuese (tabela 6).

Tabela 6. Të dhëna për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare në QKR

	<i>Të dhëna për regjistrimin fillestar në QKR</i>
1	<i>emri</i>
2	<i>forma</i>
3	<i>data e themelimit</i>
4	<i>të dhënat e identifikimit të themeluesve;</i>
5	<i>selia</i>
6	<i>kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar</i>
7	<i>të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre</i>
8	<i>specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve</i>

Në kërkesat për të dhënat e identifikimit të themeluesve nuk përcaktohet ekskluzivisht pronari i fundit i cili ushtron kontroll efektiv mbi personat juridikë. Të dhënat shtesë për shoqëritë me

përgjegjësi të kufizuar jo domosdoshmërisht çojnë në identifikimin e pronarit përfitues, i cili është personi fizik individ që ushtron kontrollin e fundit efektiv mbi kompaninë. Identifikimi shkon deri në shtresën e parë të ortakëve përfitues por ligji nuk është detyrues për të identifikuar pronarin e fundit përfitues.

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar: *është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, numri i pjesëve të kapitalit, vlera nominale e secilës pjesë, pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak, si dhe informacioni nëse kapitali fillestar i nënshkruar është paguar ose jo (neni 35 ligji për QKR)*. QKR-ja mjaftohet me njoftimin e vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, numrin i pjesëve të kapitalit, vlera nominale e secilës pjesë, pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak të shtresës së parë të pronësisë por nuk shkon më tej në rastin e kompanive shumë shtresore.

Identifikimi i pronarit përfitues në rastin e shoqërive aksionere/anonime paraqet një situatë shumë komplekse për shkak të natyrës së tyre të pronësisë dhe si rrjedhojë nevojitet një qasje e veçantë në trajtimin e pronësisë përfituese të këtyre shoqërive dhe shqyrtimit të legjislacionit në fuqi. Shoqëria aksionare, është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara (*ligj 9901, Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*). Shoqëritë aksionare mund të jenë shoqëri me ofertë, private apo publike, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

Të dhënat shitesë të kërkuara për regjistrimin e shoqërive anonime në QKR, nuk nxjerrin në pah identifikimin e personit fizik i cili ushtron kontrollin e fundit efektiv të një shoqërie me pronësi shumë shtresore. Neni 36 i ligjit për QKR përcakton të dhënat shitesë të detyrueshme për identifikimin dhe regjistrimin e shoqërive anonime (tabela 7):

Tabela 7. Të dhënat shtesë të shoqërive anonime në QKR (nenit 36, ligji mbi QKR).

	Të dhënat shtesë për shoqëritë anonime
1	<i>vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar</i>
2	<i>numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara</i>
3	<i>vlera nominale e secilit aksion</i>
4	<i>numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksionar</i>
5	<i>vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksionar, si dhe pjesa e paguar prej secilit</i>
6	<i>kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve</i>
7	<i>procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut</i>
8	<i>vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;</i>
9	<i>përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike</i>
10	<i>të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre</i>
11	<i>numri i anëtarëve të organeve drejtuese; i) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore. Shoqëritë anonime me ofertë publike, përpara regjistrimit fillestar, duhet të regjistrojnë edhe të dhënat e identifikimit të themeluesve, projektstatutin, si dhe të kryejnë njoftimet e mëpasshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore</i>

Të dhënat e mësipërme mundësojnë identifikimin e numrit të aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner, por këto të fundit mund të mos ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv të shoqërisë në rastin e një strukture pronësie shumë shtresore dhe sidomos kur aksionerët e shtresës së parë janë shoqëri të tjera. Sa i përket kërkesës për të dhënat e identifikimit të themeluesve, nuk specifikohet identifikimi i personit fizik përfundimtar në zinxhirin e pronësisë përfituese. Aktualisht QKR-ja nuk i vjen në ndihmë bankave dhe profesioneve të tjera të lira në identifikimin e plotë të klientëve të cilët janë persona juridike dhe kanë një pronësi të ndërlikuar shumë shtresore.

Një rol shumë të rëndësishëm në zgjidhjen e problematikës së identifikimit të pronësisë përfituese të shoqërive anonime duhet të luante Qendra e Regjistrimit të Aksioneve QRA si regjistruese e të

dhënave të mbajtësit të aksioneve. QRA, përveç mbajtjes së regjistrit të aksioneve kryen edhe funksione të tjera. Pranë QRA-së ofrohen shërbime si llogaritja e dividendëve, konfirmimi i gjendjes së azhurnuar në çdo kohë të llogarisë së secilit aksioner apo njoftimi i mbledhjes së përgjithshme të llogarisë së secilit aksioner. Regjistrimet elektronike të aksioneve në regjistrat e titujve përmbajnë disa të dhëna mbi aksionerët e shoqërive anonime (tabela 8).

Tabela 8. Të dhënat që kërkohen në QRA për regjistrimet elektronike të aksioneve (Neni 13, Ligji “Për Titujt”).

	Të dhënat për regjistrimet elektronike të aksioneve
1.	<i>Llojin e aksioneve.</i>
2.	<i>Datën e emetimit.</i>
3.	<i>Emërtimin, selinë dhe numrin e regjistrimit të emetuesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.</i>
4.	<i>Mbajtësin e aksioneve:</i> <i>a) për individët shënohen identiteti, adresa e banimit, si dhe numri i dokumentit të identifikimit;</i> <i>b) për personat juridikë shënohen emërtimi, selia, si dhe numri i regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.</i>
5.	<i>Numrin e aksioneve të emetuara.</i>
6.	<i>Vlerën nominale të aksioneve të emetuara.</i>
7.	<i>Datën e regjistrimit të aksioneve në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve.</i>

Të dhënat e mësipërme në pikën 4, parashikojnë informacionin e nevojshëm për mbajtësin e aksioneve si për individët ashtu dhe për personat juridikë ku shënohet emërtimi, selia, si dhe numri i regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. *Titujt emetohen, transferohen dhe ruhen si të dhëna elektronike në regjistrarët e titujve, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti (Neni 6 ligjit “Për Titujt”).* Titujt përfshijnë një gamë të gjerë instrumentash financiare. *“Në termin tituj përfshihen pa kufizim **aksionet**, obligacionet e*

shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emetuar nga BSH, deftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” (neni 3 i ligjit “Për Titujt”).

Regjistrari, në varësi të titujve, për të cilët është liçencuar, ka si funksion ofrimin e shërbimit të regjistrimit të titujve, nëpërmjet organizimit të mënyrës së mbajtjes së regjistrit, në mënyrë të tillë që të sigurohen në çdo kohë **të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt**, si dhe kufizime të të drejtave të pronësisë mbi to. Për realizimin e funksioneve të veta, regjistrari ka për detyrë: *Të organizojë regjistrimin e transaksioneve dhe të ndryshimeve përkatëse, në mënyrë që të evidentojë, në çdo kohë, të dhëna mbi zotëruesin e fundit të titujve dhe kushteve, që çojnë në kufizim të të drejtave të pronësisë mbi titujt (neni 126/1i ligjit “Për Titujt”).*

Regjistrari ka për detyrë të organizojë të regjistrojë të dhëna mbi zotëruesin e fundit të titujve ku aksionet janë pjesë përbërëse e tyre. Aktualisht ekziston vetëm një qender e specializuar për mbajtjen e regjistrave të titujve në vendin tonë, Institucioni i Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve “QRA”, i cili në masën 75 % zotërohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipëmarrjes. Kjo qendër është shoqëria aksionere që ka për objekt të veprimtarisë, organizimin dhe administrimin e të dhënave për titujt.

Baza ligjore është shumë e plotë sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të të dhënave fundore të aksionerëve në QRA. Shqetësimi ekziston në mos funksionimin duhur të këtij institucioni i cili kryen regjistrimin e të dhënave përfshirë ato të pronësisë përfituese të shoqërive aksionere në vendin tonë. Titujt në bazë të ligjit duhet të regjistrohen në QRA si qender e specializuar për mbajtjen e regjistrave të titujve në Shqipëri por sipas përfaqësuesve të QRA numri i shoqërive aksionere të regjistruara në këtë institucion është më i vogël se numri total i atyre të regjistruar në QKR. Kjo situatë vjen përshkak të handikapeve ligjore dhe rregullative që ekzistojnë në statusin ligjor dhe funksionimin e QRA-së.

Së pari, neni 6 i ligjit “Për Titujt” përcakton se titujt mund të regjistrohen *në disa qendra të specializuara* për mbajtjen e regjistrave të titujve dhe nuk parashikon *një depozitar qendror të vetëm* të regjistrimit të pronarëve përfitues të aksioneve të shoqërive anonime. Ligji parashikon

decentralizimin e regjistrimit të aksioneve në regjistrarë të ndryshëm duke krijuar paqartësi dhe konfuzitet sa i përket statusit të këtij institucioni të rëndësishëm.

Së dyti, ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nuk i detyron shoqëritë të regjistrojnë të dhënat e pronësisë fundore në një regjistrar qendror të dhënash. Neni 119 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” për regjistrimin e aksioneve, parashikon se: *Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.* Neni 117 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i detyron shoqëritë aksionare të mbajnë një regjistër të posaçëm, ku të regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, *Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria.* Ligji nuk përcakton regjistrimin e të dhënave të zotëruesve fundorë të aksioneve në regjistrin e posaçëm të shoqërisë dhe për më tepër, nuk i detyron shoqëritë aksionere që këto të dhëna ti raportojnë në një regjistrar qendror të dhënash QRA.

Se treti, mungesa e një tregu aksionesh “bursë” nuk ndihmon në identifikimin e strukturës së pronësisë në rastin e shoqërive aksionere me oferte publike. *Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionarëve të kompanisë. Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të OECD-së (Udhëzim 28 i Ministrisë së Financave mbi PPP/FT).* Bursa në vendin tonë ka një aktivitet shumë të limituar tregtar dhe si rrjedhim sistemi financiar përqëndrohet tek bankat. Në mungesë të bursës, shoqëritë tregtare private i shesin aksionet e tyre në tregun informal dhe si rrjedhojë nuk paraqitet pronari i fundit efektiv në një regjistrar si QRA, i cili mund të aksesohet nga institucionet financiare. Ndryshimet në pronësinë fundore të aksioneve të kryera nga brokeri në bursë detyrimisht do të regjistroheshin brënda një afati të përcaktuar në QRA. Bursat e njohura të vendeve të OECD-së e kryejnë këtë funksion duke lehtësuar punën operationale të bankave.

Së fundmi, në QKR vihen re ndryshime të shpeshta të pronësisë së aksioneve pasi transaksionet e kalimit të pronësisë së aksioneve janë pa komision. Kalimi i pronësisë së aksioneve të regjistruara

në QRA shoqërohet me komisionet përkatëse. Rrjedhimisht shumë shoqëri aksionere nuk regjistrohen në QRA duke e bërë shumë të vështirë monitorimin e vazhdueshëm të ndyshimeve në pronësinë përfituese të klientëve nga institucionet financiare.

Rekomandimet e institucionit Evropian të letrave me vlerë ECSDA¹, kërkojnë që QRA-ja në vendin tonë të përfshijë të gjitha llojet e titujve të përcaktura në termin “tituj” në nenin 3 të ligjit “Për Titujt”. Momentalisht QRA-ja, për shoqëritë aksionere të regjistruara, mban të dhëna vetëm për pronarët përfitues që zotërojnë aksione. Në fakt, do të krijohet një panoramë më e qartë për burimin e të ardhurave të kompanive aksionere nëse të gjitha llojet e titujve përfshirë aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga AMF, të ruhen si të dhëna elektronike në regjistrarin e vetëm qendror të titujve në QRA. Kjo do të rriste transparencën mbi veprimtarinë financiare të shoqërive aksionere dhe do të lehtësonte punën operationale të oficerëve të përputhshmërisë në institucionet financiare dhe personave përgjegjës të subjekteve të tjera raportuese.

Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që: të realizohet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur; të mos ndërpritet zhvillimi normal i aktivitetit të biznesit; rreziqet e pastrimit të parave të menaxhohen në mënyrë efektive, të përcaktohen procedurat e menaxhimit të riskut që do të zbatohen për rastet kur një klient mund të lejohet të përdorë marrëdhënien e biznesit përpara ose gjatë plotësimit të procesit të verifikimit (*ligj 9917 mbi PPP/FT*). Bankat mund të mënjanojnë një ndërprerje të menjëhershme të marrëdhënieve të biznesit me personat juridikë nëse kanë marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të vazhdueshme për indentifikimin e pronarëve përfitues. Në këtë fazë, bankat kanë bërë kontrollet përkatëse në regjistrat zyrtarë dhe në burimet e hapura dhe kanë kërkuar nga klientët të sjellin vullnetarisht dokumentacionin e identifikimit të pronësisë përfituese.

Bankat, në pritje të dokumentacionit përkatës, duhet të përcaktojnë dhe pregatisin procedurat e menaxhimit të riskut, ku mund të përfshihen kufizimi i transaksioneve me natyrë debitore si për shembull transfertat në dalje (përveç rastit të pagesave të tatim taksave apo pagave të punonjësve),

¹ Objektivi ECSDA (European Central Securities Depositories Association) është për të ofruar zgjidhje dhe të japë këshilla në nivel ndërkombëtar për çështjet teknike, ekonomike, financiare ligjore dhe rregullatore për të zvogëluar rrezikun dhe të rritjen e efektshmërisë për letrat me vlerë dhe pagesat e lidhura me to në Evropë për të mirën e emetuesit, investitorët dhe pjesëmarrësve të tregut.

tërheqje të mëdha në para fizike, mos kreditim të klientit etj. Ky është një hap lehtësues për bankat por nuk e zgjidh problemin në periudha afatgjata.

Në vendin tonë një zhvillim shumë i rëndësishëm do të ishte krijimi i regjistrit kombëtar të llogarive të administruar nga BSH. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm pas krijimit të regjistrit të kredive të administruar po nga BSH. Krijimi i një regjistri kombëtar të llogarive do të aksesohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit, për të lehtësuar investigimet, me qëllim rritjen e kapaciteteve për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive që mund të jenë objekt konfiskimi ose të dyshuara për përfitim nga krimi. Procesi është shtyrë për një kohë të mëvonshme për shkak të domosdoshmërisë së përshtatjes së kërkesave/direktivave evropiane me kushtet tona konkrete. Kjo ka ardhur edhe si rezultat i reagimit të bankave të nivelit të dytë në vendin tonë, të cilat kanë shprehur rezervat të tyre në lidhje me këtë çështje pasi krijimi i një regjistri të aksesueshëm të llogarive të gjithë klientëve, jo vetëm që do të shkaktonte një reagim publik, por do të binte ndesh me parimet e konfidencialitetit dhe sekretit bankar, si dhe do të shkonte kundër të gjitha përpjekjeve të bëra nga sektorët publik dhe privat në Shqipëri për reduktimin e nivelit të cash-it në ekonomi. Implementimi i këtij projekti e bën të domosdoshme rishikimin e metodologjisë aktuale për raportimin drejt përshtatjes me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe kjo kërkon pak kohë. Krijimi i një regjistri kombëtar të llogarive të administruar nga BSH do të rriste edhe më shumë transparencën në lidhje me identifikimin e klientit dhe pronësisë përfituese të shoqërive.

Një tjetër aspekt i identifikimit të pronësisë përfituese është monitorimi i vazhdueshëm i të dhënave identifikuese të klienteve. Ligji organik Shqiptar i PPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sikundër kuadri ligjor ndërkombëtar, përfshijnë një skopë shumë të gjerë përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve me klientët. Ndryshimi i shpeshtë i të dhënave identifikuese të klienteve mund të ekspozojë subjektet ligjore përballë masave administrative të vendosura nga autoritetet përgjegjëse dhe mbikëqyerse. Vigjilenca e duhur, e cila përfshin identifikimin e klientëve, dokumentacionin e kërkuar për identifikimin e klientit, monitorimin e marrëdhënieve të biznesit me klientët është një proces dinamik dhe bankave në veçanti u del një punë shumë e madhe për një përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore. Të dhënat për identifikimin e klientit por edhe kërkesat rregullative ndryshojnë vazhdimisht. Për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit, subjektet duhet të regjistrojnë e të mbajnë disa të dhëna identifikuese të detyrueshme (tabela 9).

Tabela 9. Të dhënat për identifikimin dhe regjistrimin e klientit (neni 5, ligji 9917 mbi PPP/FT)

Lloji i klientit	Të dhënat për identifikimin e klientit
<i>Personat fizikë</i>	<i>emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, autoritetin që e ka lëshuar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar;</i>
<i>Personat fizikë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse</i>	<i>emrin, mbiemrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, NIPT-in, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar</i>
<i>Personat juridikë privatë që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:</i>	<i>emrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, NIPT-in, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së veprimit financiar;</i>
<i>Personat juridikë privatë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:</i>	<i>emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin dhe aktin e themelimit, numrin dhe datën e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selinë e përhershme dhe natyrën e veprimtarisë;</i>
<i>Përfaqësuesit ligjorë të klientit</i>	<i>emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm dhe të përhershëm, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, autoritetin që e ka lëshuar dhe kopjen e aktit të përfaqësimit.</i>

Të dhënat për identifikimin e klientit japin një panoramë të qartë të klientit në momentin e çeljes së llogarisë por këto të dhëna ndryshojnë vazhdimisht. Bankat bëjnë identifikimin e klienteve (të vazhdueshëm apo rastësor) dhe verifikimin e identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme

originale ose fotokopje të noterizuara (*udhëzim nr. 28 i Ministrisë së financave mbi PPP/FT*) si më poshtë:

a) *Për individët dhe përfaqësuesit ligjore:*

- *Letërnjoftim ID (Kartë Identiteti);*
- *Pasaporta brenda afatit të skadencës;*

b) *Për personat fizik dhe juridik që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:*

- *Statuti;*
- *akti i themelimit;*
- *Ekstrakte të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit;*
- *NIPT;*

Dokumente të tjera shtesë, të cilat janë përcaktuar në ligj mund të kërkohen nga subjektet, nëse shikohet e nevojshme. Nga ana tjetër subjektet duhet të jenë në mënyrë proaktive vigjilente në përditësimin e të dhënave pasi ligji kërkon nga subjektet ligjore që të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, përfshirë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t’u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij, profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve.

Kërkesat ligjore dhe rregullative përballin bankat me një punë kolosale dhe intensive. Në vitet e fundit kemi ndryshime rrënjësore në mjetet e identifikimit të klienteve si pasojë futjes së mjeteve identifikuese dixhitale. Para vitit 2009 ishte normale të hapje llogari pranë bankave vetëm me çertifikata të lëshuara nga Zyra të Gjendjes Civile. Me hyrjen në fuqi të kartave të identitetit dixhitale, siç shikohet edhe në nenin 3, të udhëzimit numër 28, të Ministrisë së Financave, çertifikatat nuk pranohen më si dokument parësor për identifikimin e klienteve, madje duhet të zëvendësohen. Ato mund të përdoren vetëm nëse shikohet e nevojshme si dokumenta shtesë. Me hyrjen në fuqi të pasaportave biometrike automatikisht duke filluar nga fillimi i vitit 2012 shfuqizohen pasaportat e mëparshme. Bankat duhet të shpenzojnë shumë “energji” për të përditësuar të gjitha mjetet e identifikimit pasi shumica e llogarive të vjetra janë hapur para lëshimit të mjeteve dixhitale të identifikimit.

Personat fizik dhe juridik që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse ose jo fitimprurëse ndryshojnë vazhdimisht të dhënat në QKR në varësi të kalimit të pronësisë. Është pothuajse e pamundur që këto ndryshime të pasqyrohen në kohe reale në databazën e subjekteve bankare. Situata do të përmirësohet vetëm nëse klientët ndëgjegjësohen dhe njoftojnë vetë mbi këto ndryshime. Në databazën e bankës numri i personave juridike është i konsiderueshëm dhe përditesimi i të dhënave në mënyrë periodike është i vështirë sidomos në rastet kur klienti mund të mos ketë kryer transaksione për një periudhe kohore të gjatë (gjendje “dormant”).

Opinionimi publik duhet të jetë i mirëinformuar nga institucionet kompetente të zbatimit të ligjit mbi ndryshimet e kërkesave ligjore në kohë reale pasi në rast të kundërt institucionet financiare do të përballen gjithmonë me konsekuencat ligjore. Publikimi në fletoren zyrtare të akteve normative shpeshherë nuk është i mjaftueshëm. Autoritetet përgjegjëse dhe mikqyerse duhet të ndërmarrin fushata sensibilizuese në mjetet e informimit publik për individët dhe kompanitë që posedojnë llogari bankare.

Duke analizuar bazën ligjore, në lidhje me pronarin përfitues, duket se nuk ka një harmonizim të qartë të ligjeve dhe rregulloreve të tjera me ligjin organik të PPP. Subjektet raportuese e kanë të pamundur të identifikojnë pronësinë përfituese nëpërmjet QKR-së apo QRA-së në rastin e një kompanie me shumë aksionerë të tërthortë. Si rezultat mbetet vetëm ti kërkohet klienteve vetëdeklarimi i dokumentacionit justifikues pasi në burimet e hapura si interneti, informacione kaq specifike janë mjaft të limituara ose pothuajse të pamundura të gjenden. Nëse zinxhiri i fundit i pronësisë përfituese nuk është identifikuar dhe përditësuar në regjistrat tregtare me siguri nuk mund të gjëndet në ndonjë dokument tjetër zyrtar shtetëror apo privat.

3.2 Pyetje kërkimore nr. 2.


Legjislacione të ndryshme kanë kërkesa rregullative të ndryshme nga kuadri rregullativ vendas. Bankat janë të ekspozuara nga rreziku i mosidentifikimit të klienteve në bazë të kërkesave ligjore vendase. Qendrat financiare “off-shore” përbëjnë një rrezik të lartë pasi ushtrojnë një sekret të lartë bankar dhe jo domosdoshmërisht e kanë të sanksionuar zbulimin e pronësisë përfituese të kompanive të regjistruara në juridiksione të tilla. Kompanitë me qendër “off-shore” mund të

krijojnë marrëdhënie biznesi me një bankë, e cila nuk ushtron standardet ndërkombëtare të identifikimit të pronarit përfundimtar përfitues që zotëron një kompani. Bazuar në argumentet e mësipërme është formuluar pyetja kërkimore si vijon:

A hasni vështirësi në identifikimin i klientit për degët apo filialet e një kompanie të huaj me rezidencë në vendet e tjera (sidomos në qendrat financiare “off-shore”) dhe a mendoni se kërkohen amendime në kuadrin rregullativ në fuqi dhe krijimi i regjistrave të aksesueshëm ndërkombëtar me të dhëna mbi pronësinë përfituese?

Rezultatet e kërimit janë të pasqyruara në grafikun nr. 2. Numri i të intervistuarve që mbështesin pyetjen e dytë kërkimore është 14 ndërsa numri të i të intervistuarve që kanë mbajtur një qëndrim negativ për të është 2. Të intervistuarit qoftë nga subjektet private raportuese apo nga institucionet shtetërore ishin pro ndryshimeve rregullative për përmirësimin e kuadrit rregullativ. Vetëm dy të intervistuar nga institucionet shtetërore ishin të mendimit që nuk janë të nevojshme ndryshimet rregullative dhe se subjektet private raportuese duhet të mos lejojnë kryerjen e marrëdhënieve me kompani “off-shore” nëse nuk arrijnë pas një periudhe kohore të identifikojnë klientët jorezidentë dhe strukturën e pronësisë përfituese.

Grafiku 2



Realizimi i identifikimi të klientit dhe pronësisë përfituese nga subjektet financiare dhe profesionet e lira jofinanciare bëhet më i vështirë për degët apo filialet e një kompanie të huaj me rezidencë në

vendet e tjera dhe sidomos në qendrat “off-shore”. Arsyeja kryesore është struktura e pronësisë shumë shtresore dhe mungesës së aksesit në regjistrat publikë ndërkombëtare. Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme disa të dhëna shtesë (tabela 10).

Tabela 10. Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja (neni 37 mbi QKR)

	<i>Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja</i>
1	<i>kapitalin e shoqërisë së huaj</i>
2	<i>emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;</i>
3	<i>kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar</i>
4	<i>fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;</i>
5	<i>selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit</i>
6	<i>të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;</i>
7	<i>specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.</i>

Të dhënat e mësipërme për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja përfshirë kapitalin e shoqërisë së huaj apo të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës, nuk përcaktojnë në mënyrë eksplicite identifikimin e pronësisë përfutuese të shtresës së fundit për kompanitë jorezidente me shumë nivele pronësie. Në faqen e internetit të QKR-së, në seksionin “Paketë informative për bizneset e huaja”, aplikimit për regjistrim fillestar që duhet të paraqitet në QKR për regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me ortak person juridik të huaj, duhet ti bashkëngjiten dokumenta të tjera shtesë të nevojshme (tabela 11).

Tabela 11. Dokumentacion shtesë për ortakun person juridik të huaj,

	<i>Dokumentacion shtesë për regjistrim fillestar në QKR</i>
1.	<i>akti i themelimit e statuti i shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;</i>
2.	<i>dokumentacioni, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj;</i>
3.	<i>dokumentacioni, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;</i>
4.	<i>vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri.</i>

Në paketën informative për bizneset e huaja nuk evidentohet kërkesa për identifikimin e pronësisë fundore. Në rastin e korporatave me seli në qendrat financiare “off-shore” dokumentacioni, që vërteton “regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj”, shpesh herë nuk edvidenton individët e fundit në shtresën e pronësisë. Vende të tilla si Ishujt e Virgjër Britanik, Kajman etj, janë shumë hermetik sa i përket ruajtjes së anonimatit dhe sekretit të pronësisë mbi korporatat me seli në këto vende. Kompanitë jorezidente të cilat kryejnë mardhënie biznesi me bankat tregtare lokale duhet të sigurojnë paraqitjen e dokumentacionit për identifikimin e pronarit përfitues dhe burimin e të ardhurave. Bankat e kanë të vështirë të sigurojnë për një kompani jo rezidente dhe sidomos për një kompani “off-shore” këto informacione themelore identifikuese. Në disa vende të Komitetit Evropian si Italia, kompanitë “off-shore” që nuk identifikohen deri në shtresën e fundit në bazë të legjislacionit në fuqi, nuk lejohen të regjistrohen pranë QKR-së Italiane.

Organizime të ndryshme ligjore dhe produkte financiare, të cilat përdoren për pastrim parash gjejnë hapsiara në juridiksionet “off-shore”. Shoqëritë tregtare dhe bankat guaskë “Shell” janë një problem i madh në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Një bankë guaskë është një term financiar që përshkruan një institucion financiar që nuk ka një prani fizike në vendin në të cilin ajo është e inkorporuar dhe liçensuar. “Bankë guaskë” është një bankë, e cila nuk ka prani fizike, përfshirë mungesën e administrimit e drejtimit, si dhe nuk është e përfshirë në një grup të

rregulluar financiar (ligj 9917 mbi PPP/FT). Aktit Patriot i SHBA që ka për qëllim parandalimin e pastrimit të parave, në mënyrë specifike ndalon transaksionet me institucione të tilla. Në juridiksionet “off-shore” është e lehtë për të krijuar dhe zhdukur banka guaskë si dhe kompani me struktura të komplikua shumë-juridiksionale. Në rastet kur bankat evidentojnë apo konstatojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë, ato duhet të ndërpresin menjëherë marrëdhënien e biznesit me to dhe t’i raportojnë autoritetit përgjegjës.

Trustet janë një marrëveshje mirëbesimi, ku pronësia mbahet nga i mirëbesuari për llogari të përfituesit dhe ashtu si kompanitë “guaskë” fshehin pronarin e vërtetë të parave. Trusted janë marrëdhëniet juridike të krijuara ku fondet janë vendosur nën kontrollin e një administruesi të besuar. Në varësi të juridiksionit, ato nuk e kanë të domosdoshme të zbulojnë pronarin e tyre të vërtetë përfitues. Trustet janë një fenomen që shfaqet kryesisht në vendet me traditë “Common Law”. Vendet “off-shore” bëjnë të mundur inkorporimin dhe operimin me trusted. Regjistrimi i trusteve pranë QKR-së bëhet pa patur nevojën e regjistrimit të pronësisë dhe kontrollit efektiv mbi to duke vështirësuar identifikimin e tyre nga bankat.

Klientët jorezidentë janë shqetësuar për bankat edhe për faktin se përdorin instrumenta lehtësisht të manipulueshëm për pastimin e parave të tilla si “Instrumente të negociueshme të mbajtësit”. Këto instrumente përfshijnë instrumentet monetare në formën e mbajtësit në pronësi të këtij të fundit, të tilla si çeqet e udhëtarit, instrumentet e negociueshme (ku përfshihen, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), që janë në formën e mbajtësit, të vlefshme, pa u kufizuar nga personi të cilit i paguhet, të paguara një personi fiktiv ose përndryshe në një formë që pronësia kalohet thjesht nëpërmjet dorëzimit nga një person të një tjetër; instrumentet jo të plota (përfshirë, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), të nënshkruara, por pa përfshirë emrin e personit të cilit i paguhet (*ligj 9917 mbi PPP/FT*).

Një aspekt i veçantë i manipulimit të pronësisë përfituese nga korporatat “off-shore” janë aksionet e mbajtësit “Bearer Shares”. Aksionet e mbajtësit i referohen instrumenteve të negociueshme që i japin pronësinë një personi juridik një personi i cili posedon çertifikatën e aksioneve të mbajtësit. Kushdo që fizikisht mban një çertifikatë “bearer shares” është supozuar të jetë pronari i saj. Këto çertifikata i japin kontrollin e një kompanie kujtdo që i ka në duar në një moment të caktuar. Pronësia është jashtëzakonisht e vështirë që të rikuperohet në rast të humbjes apo vjedhjes.

Aksionet e mbajtësit ndryshojnë nga instrumentet të regjistruar normalisht, në faktin se nuk mbahen të dhëna mbi personin i cili zotëron pronësinë themelore, apo të transaksioneve që përfshijnë transferimin e pronësisë. Investitorët të cilët dëshirojnë të ruajnë anonimitetin, përdorin gjerësisht aksionet e mbajtësit. Subjektet raportuese duhet të ushtojnë vigjilencë të zgjeruar për shoqëritë, pronarët e të cilëve posedojnë aksione të mbajtësit por shoqëri të tilla mund të regjistrohen lehtësisht në QKR pasi nuk kërkohet identifikimi i aksionerëve fundore. Mosfunksionimi i institucioneve të QKR-së dhe QRA-së bën shumë të vështirë identifikimin e pronarëve përfitues të cilat posedojnë këto lloj aksionesh. Mungesa e regjistrave ndërkombëtarë të regjistrimit të aksioneve e vështirëson së tepërmi identifikimin e kompanive me pronësi aksione të mbajtësit. Bankat në vendin tonë vendosen para një vështirësie serioze për të identifikuar pronarin përfitues të një kompani të huaj e cila ka në pronësi aksione të mbajtësit dhe kërkon të kryejë marrdhënie biznesi me të. Duhet një ndërhyrje rigoroze për të parandaluar regjistrimin e kompanive të huaja me pronësi aksionesh të mbajtësit në QKR apo QRA për të ndaluar regjistrimin e kompanive pa anonimata.

Në rastin kur bankat nuk mund të zbatojë detyrimin e vigjilencës së zgjeruar atherë: a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksionin; b) duhet të dërgojnë një raport të veprimtarisë së dyshimtë pranë DPPP-së. Mos identifikimi i saktë i klientit dhe pronarëve përfitues mund të rezultojë në kundërvajtje administrative dhe subjektet financiare bankë dhe me gjërë mund të penalizohen. Kjo përbën kosto financiare për bankën por edhe risk reputacional pasi emri i saj i mirë vihet në pikpyetje.

Bankat e nivelit të dyte në Shqipëri përballen me probleme të mëdha edhe në gjetjen e pronarëve përfitues të kompanive serioze të regjistruara në vende të Bashkimit Evropian. Në bazë të direktivës së tretë të BE në lidhje me PPP, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që zyrat e shkëmbimit të monedhës, trustet dhe kazinotë të jenë të licencuar në mënyrë që bizneset e tyre të operojnë ligjërisht. Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që personat të cilët në mënyrë efektive drejtojnë biznese të tilla si dhe pronarët e tyre përfitues nuk duhet të keqpërdorin këto subjekte për qëllime kriminale (*Directiva 2005/60/EC neni 36*). Por nuk është e lehtë të kontrollohen regjistrat tregtare të këtyre vendeve dhe ti shkohet deri në deri fund çështjes së pronarit të fundit përfitues.

Në disa raste shoqëritë me seli në vendet e Bashkimit Evropian të regjistruara në vendin tonë janë të organizura si shoqëri “koperative” me qindra aksionerë me përqindje të ulta zotërimi të paketës kontrolluese aksionere (shpesh herë më pak se 1% secili). Bankat përpiqen të posedojnë këtë dokument i cili bën të mundur identifikimin e klientit por me kostot përkatëse. Për shembull sipas përfaqësuesve të një bankë Italiane në vendin tonë, kërkimi i një dokumenti identifikues për një klient person juridik Italian në faqen “Cerved” (equivalenti i faqes zyrtare të QKR-së në vendin tonë) kushton 15 Euro. Në bankë ka një numër të relativisht të madh klientësh Italiane dhe kostoja për kontrollin e secilit prej tyre është e konsiderueshme. Gjithashtu të dhënat e klientëve përditësohen në mënyrë dinamike. Banka rezervon kërkimin vetëm për klientë të rëndësishëm ose për lloje transaksionesh të veçanta si në rastin e kreditimit të klientit. Kërkimi në “Cerved” është vetëm për klientët që janë persona juridike Italiane por nëse marrim në konsideratë që kompanitë “Mëma” janë me rezidencë nga vende të ndryshme të Evropës, shpenzimet rriten në mënyrë të konsiderueshme.

Subjektet financiare dhe në veçanti bankat janë të detyruara me ligj për t’ju kushtuar një vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë. Dokumentacioni për identifikimin e klienteve jorezidente përcaktohet në aktin nënligjor të Ministrisë së Financave nr 28 si më poshtë:

Dokumenta të vlefshme në origjinale ose fotokopje të noterizuara për individëd jorezidentë:

- Pasaportë, brenda afatit të skadencës;

- ID Kart Identiteti (vetëm për vendet e BE-së), brenda afatit të skadencës;

Për personat fizik dhe juridik që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse për shoqëri jo-rezidente:

- Dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin Rezidencës (Vendim i gjykatës ose ekstrakt nga regjistri tregtar);

- Statuti i shoqërisë;

- Dokumenti i identifikimit të personave të autorizuar.

Për jorezidentët kërkohet një monitorim i veçantë i marrëdhënieve të biznesit dhe i dokumentacionit të identifikimit të tyre edhe për faktin që legjislacione të ndryshme kanë kërkesa rregullative të ndryshme. Sipas përfaqësuesve të një kompanie austriake, dokumentacioni që kërkohet për të çelur një llogari bankare në një bankë austriake është vetëm një ekstrakt nga regjistri tregtar. Ky është

një dokumentacion i mjaftueshëm për të kryer marrëdhënie biznesi normalisht me bankat në Austri. Mjaft klientë të huaj shprehen se kërkesat rregullative lokale shtesë si statuti i shoqërisë, pengojnë përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Mungesa e një standartizimi ndërkombëtar të dokumentacionit për identifikimin e klienteve jorezidente i vendos bankat para vështirësive të shumta.

Bankat duhet të jenë shumë të kujdesshëm edhe nëse dokumentacioni i paraqitur nga klientet jorezidente është i plotë. Dokumentacioni i marrë nga klienti mund të jetë konform kërkesave ligjore por ekziston mundësia rrezikut të paraqitjes së dokumentacionit të fallsifikuar. Shumë banka të nivelit të dytë kërkojnë që dokumentacioni për identifikimin e klientëve jorezidente të jetë me vulë apostile që legalizon përdorimin e dokumentacionit. Rrjedhimisht rriten kostot e transaksionit për klientët e huaj.

Problemet shtohen kur subjektet finaciare dhe jofinaciare duhet të verifikojnë dhe t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë në vende problematike që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, për të parandaluar e luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, për një periudhë 5-vjeçare, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës dhe audituesve, nëse kërkohet. Institucionet finaciare për shkak së kryejnë marrëdhënie biznesi me kliente nga vende që paraqesin nivel rreziku të ndryshëm janë të përballur me rrezikun gjeografik. Në epokën e globalizimit, rreziku gjeografik bëhet edhe më i koklavitur për faktin se korporata komerciale multinacionale me origjinë nga vendet me rrezik më të ulët mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre në vende me rrezik relativisht më të lartë. Institucionet finaciare mund të gjykojnë se përbëjnë një rrezik më të lartë se normalisht kur klientet, burimi ose destinacioni i fondeve të tyre, janë të vendosura në një vend që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme të ndërmarra nga OKB.

Kohët e fundit bankat korrespondente kanë ndërprerë kryerjen e marrëdhënieve të biznesit me shumë banka Siriane për shkak të luftes civile në atë vend. Në disa raste klientët Shqiptarë janë detyruar të paguajnë edhe kostot e mos kryerjes së transaksionit, domethënë komisionet e bankës korrespondente. Në mesazhin e SWIFT-it evidentohet që vendi i klientit përfitues është shtuar në listën e vendeve me rrezik shumë të lartë dhe për këtë arsye nuk mund të kryhet transaksioni. Para

fillimit të luftës civile në këtë vend, transaksione të tilla kryheshin pa problem. Në një rast, transfertat në dalje me përfitues për një klient në Liban nuk u ekzekutuan nga banka korrespondente me arsyen se banka përfituese mund të ketë lidhje me bankat Siriane të cilat së fundmi janë nën regjimin e sanksioneve të OKB-së. Banka korrespondente kishte nevojë për verifikime të mëtejshme. Listat e bankave me qendër në vende të konsideruar problematike për OKB duhet të ishin më të sakta dhe të përditësuara në kohë reale.

Autoritetet përgjegjëse dhe institucionet financiare marrin informacione nga burime të besueshme të cilët sipas interpretimit të rekomandimeve të FATF-së i referohen informacionit që është nxjerrë nga organizma të njohura që në përgjithësi janë konsideruar me reputacion të lartë dhe që e bëjnë një informacion të tillë publik dhe gjerësisht në dispozicion të vendeve antare. Përveç FATF-së, burime të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, organet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Grupin Egmont i Njësive të Inteligjencës Financiare, si dhe organet përkatëse kombëtare qeveritare dhe organizatat jo-qeveritare. DPPPP dhe BSH ju vijjnë në ndihmë subjekteve raportuese me publikimet në kohë reale të listave të konsoliduara të Kombeve të Bashkura si dhe me deklaratat zyrtare të FATF-së mbi zhvillimet më të fundit dhe shqetësimet që vijnë nga vendet problematike. Vendeve të tilla ju mungojnë ligjet, rregulloret dhe masa të tjera përshtatshme në lidhje me PPP.

Subjektet bankare duhet të ndërtojnë marrëdhënie biznesi me banka të huaja korrespondente serioze dhe të mënjanojnë bankat korrespondente me adresa fiktive si dhe me mangësi në kuadrin rregullativ të PPP. Bankat për shërbimet bankare korrespondente ndërkufitare përpara se të vendosin një marrëdhënie biznesi, duhet: të grumbullojnë informacion të mjaftueshëm rreth institucionit pritës, për të kuptuar plotësisht natyrën e biznesit; të përcaktojnë, nëpërmjet informacionit publik, reputacionin e institucionit pritës, cilësinë e mbikëqyrjes së tij, përfshirë faktin nëse ka qenë subjekt hetimi apo masash administrative që lidhen me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit; të vlerësojnë se procedurat e kontrollit të brendshëm të institucionit pritës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë të mjaftueshme dhe efektive; të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimit dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjës të për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (*ligj 9917 mbi PPP/FT*).

Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare shkëmbejnë me bankat korresponde pytesorin e grupit Woslfberg, i cili përbëhet nga institucionet kryesore financiare ndërkombëtare si: Banco Santander, Banka e Tokio-Mitsubishi UFJ, Barclays, Citigroup, Credit Suisse, Deutsche Bank, Goldman Sachs, HSBC, JP Morgan Chase, Societe Generale dhe UBS. Këto banka synojnë të zhvillojnë standarde për industrinë e shërbimeve dhe produkteve financiare, të ngjashme me politikat “njihe klientin tënd” dhe të PPP. Pyetsori përditësohet njëherë në vit ose kur ka ndryshime dhe në shumicën e rasteve bankat e huaja dhe lokale i kanë të afishuara në faqet e tyre zyrtare elektronike. Me anë të pyetsorit Woslfberg, një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri është në gjendje të gjykojë mbi: politikat, praktikat dhe procedura të përgjithshme të PPP që ndiqen në këto banka; vlerësimin e riskut ndaj pastrimit të parave; monitorimin e marrëdhënies së biznesit me klientët; sinjalizimin për transaksione dhe parandalimin dhe zbulimin e transaksioneve me fonde të jashtëligjshme; trajnimet për PPP etj. Megjithatë nuk ka një listë ndërkombëtare bankash korresponde të cilat mund të konsiderohen problematike. Gjithçka mbetet në gjykimin e bankave për të përzgjedhur bankën korresponde.

Vendet në tranzicion, të vënë përballë presionit ndërkombëtarë për arritjen e standarteve të identifikimit të klientit, shpesh herë reagojnë në mënyrë të ekzagjerur në zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare të PPP. Institucionet mbikëqyërse por edhe institucionet financiare të vendeve të vogla që aspirojnë ti bashkohen Komunitetit Evropian në zbatim të kërkesave rregullative përkatëse të PPP, tentojnë të bëhen më “rigoroz” se homologët e tyre anetarë të Komunitetit Europian duke i parë më me imtësi kërkesat ligjore. Ligji për PPP, në lidhje me detyrimet për shërbimin e transferimit të parave ose të vlerave, kërkon nga subjektet financiare, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, vendbanimin e vendqëndrimin, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë nëse ka, të dërguesit, përfshirë emrin e institucionit financiar nga ku niset transferta. Informacioni duhet të përfshihet në formularin e mesazhit ose të pagesës që shoqëron transfertën.

Banka e cila merr transferta parash ose vlerash, përfshirë dhe ato të drejtpërdrejta elektronike, që nuk përmbajnë informacionin e plotë për urdhëruesin, duhet ta kërkojë informacionin që mungon nga institucioni dërgues ose nga përfituesi. Nëse nuk arrin të regjistrojë informacionin që mungon, ai duhet të refuzojë pranimin e transfertës dhe t’ia raportojë atë autoritetit përgjegjës. Adresa e saktë e klientit është një nga pikat kryesore të identifikimit të klientit. Një banke të nivelit të dytë

Shqiptare nuk ju ekzekutua transfertat në dalje nga banka korrespondente për shkak se banka pritëse homologe në Maqedoni pretendonte se adresa e klientit në Shqipëri nuk është sipas kërkesave të normave lokale dhe ndërkombëtare. Sistemi i adresave Shqiptare nuk përfshin “PO Box” ose shpesh herë emërtimin e saktë të rrugëve. Banka korrespondente njoftoi nëpërmjet mesazhit swift mbi pamundësinë e ekzekutimit të fondeve, arsyet perkatëse dhe penaltitetet për kthimin e fondeve. Bankës korrespondente ju komunikua mbi realitetin e adresave postale në vendin tonë. Pas evidentimit të problematikës, transfertat u krye duke përdorur të njëjtën adresë me disa kosto shtesë për bankën dhe klientin pa përfshirë këtu humbjen e kënaqësisë së klientit (vonesa në kryerjen e transaksionit). Klienti kishte kryer transfertat të tjera dalëse në drejtim të vendeve të tjera të Komunitetit Evropian duke përdorur të njëjtën adresë pa patur ndonjë problem.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve kompetente të zbatimit të ligjit duhet të rritet në këtë drejtim. Këto institucione duhet shpejt, në mënyrë konstruktive dhe efektive të sigurojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me informacionin bazë të pronarit përfitues. Lehtësimi i aksesit nga autoritetet kompetente dhe institucionet financiare në të dhënat themelore të regjistrave të kompanive të vendeve të tjera dhe shkëmbimi i informacionit mbi aksionarët është shumë i rëndësishëm. Subjektet raportuese duhet të sigurojnë të dhënat identifikuese të shoqërive të vendeve të tjera përfshirë informacionin e pronësisë përfituese dhe pronarëve përfitues që jetojnë jashtë vendit. Gjithashtu një komunikim i dyanshëm i autoritetit përgjegjës me institucionet raportuese financiare do të ishte i domosdoshëm. Kjo do ta lehtësonte “peshën” e identifikimit të pronësisë përfituese tek institucionet financiare.

Organizmat ndërkombëtarë që merren me parandalimin e pastrimit të parave po marrin masa të rëndësishme në rang ndërkombëtar për identifikimin e pronësisë përfituese dhe identifikimin e të dhënave të klientit në përgjithësi. Kjo vihet re në ndryshimet e fundit në rekomandimet e FATF-së të Shkurtit 2012.

Të gjitha kompanitë e krijuara në një vend duhet të regjistrohen në regjistrin e kompanive.

Informacioni minimal themelore për t'u marrë dhe regjistruar nga një kompani duhet të jetë:

(a) emri i kompanisë, akti i themelimit, forma juridike dhe statusi, adresa e regjistruar zyra, kompetencat themelore që e rregullojnë (p.sh. memorandum dhe artikuljt e asocimit), një listë të drejtorëve, dhe

(b) regjistrin e aksionerëve të saj apo anëtarëve, që përmban emrat e aksionerëve dhe anëtarëve dhe numrin e aksioneve të mbajtur nga çdo aksioner dhe kategori të aksioneve (duke përfshirë natyrën e të drejtes së votës)

"Regjistri i kompanisë" i referohet regjistërit të kompanive të inkuorporuara ose të liçencuara në vend dhe normalisht mirëmbahet nga një autoritet inkuorporues. Tashmë po kërkohet gjithnjë e më shumë të krijohet në nivel të Bashkimit Evropian një regjistër i pronarëve përfitues i përditësuar rregullisht. Informacioni i kësaj lloji duhet të shkëmbehen ose të kordinohen në të gjitha vendet pa ndonjë pengesë, në mënyrë të shmangen rastet e pastrimit të parave dhe keqpërdorimit fiskal. Mospërputhjet në legjislacionet kombëtare nuk duhet ti ofrojnë mundësinë shkelësve të ligjit të gjejnë hapsira në vakumin ligjor. Çdokush që regjistron një kompani me përgjegjësi të kufizuar duhet të deklarojë emrat e individëve të vërtetë që kanë kontrollin e fundit efektiv mbi të, kudo që janë, dhe të raportojnë çdo ndryshim në paketën kontrolluese aksionere. Drejtorët e kompanive duhet të mbahen përgjegjës në rast dështimit të ndërmarrjes së hapave të arsyeshme për të parandaluar pastrimin e parave dhe evazionin fiskal. Përveç kësaj, vetëm personat fizikë duhet të lejohen të veprojnë si drejtues të korporatave dhe personat juridikë nuk duhet të lejohen të përmbushin rolin e kontrollit të fundit efektiv mbi një korporatë.

Nga analiza e mësipërme del që problemi i identifikimit të klientit dhe veçanarisht i pronarit përfitues të klienteve persona juridike është sa kombëtar aq dhe ndërkombëtar dhe kalon gjithë kufijtë e mundshëm duke qenë pjesë përbërse e dukurive të globalizimit. Sado që të përpiqen ligjvënësist shqiptar për të ndihmuar dhe ruajtur sistemin e tyre kombëtar financiar dhe ekonominë e vendit nga fenomenet e pastrimit të parave është e pamundur pa një harmonizim ndërkombëtar të masave kundër pastrimit të parave. Institucionet financiare do të përballen me klientë që vijnë nga vende që nuk e respektojnë identifikimit të plotë të klientit. Situata e krijuar i vendos bankat dhe subjekte të tjera ligjore përballë një problemi të madh. Në njërin anë ato kanë objektiva komerciale për të përmbushur dhe në anën tjetër përballen me konsekuencat ligjore. QKR-ja në vendin tonë regjistron degët e kompanive me seli në juridiksionet "off-shore" pa plotësuar kushtin e identifikimit të pronarit përfitues. Mosfunksionimi i institucionit të QRA-së i cili regjistron të dhënat e plota mbi pronësinë aksionere të kompanive të huaja krijon mundësinë për operimin e kompanive me pronësi të dyshimtë.


3.3 Pyetja kërkimore nr.3

Personat e Ekspozuar Politik PEP përfshijnë anëtarët e familjes dhe personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale me to. PEP-at e korruptuar përbëjnë një rrezik serioz për pastrimin e parave. Përcaktimi i listave të sakta të familjareve dhe personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale mbetet në gjykimin e bankave. Mos pajisja e subjekteve ligjore me lista të sakta, rrit mundësinë e ekspozimit ndaj rrezikut të kryerjes së transaksioneve nga pushtetarë të korruptuar dhe si rrjedhje është formuluar pyetja kërkimore në vijim:

A hasni vështirësi në identifikimin e anëtarëve të familjes dhe personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale me PEP dhe a duhet autoritet ligjvënës të mundësojnë listat e plota të PEP-ve?

Rezultatet e kërimit janë të pasqyruara në grafikun 3. Numri i të intervistuarve që i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes së tretë kërkimore është 12 ndërsa numri të i të intervistuarve që kanë mbajtur një qëndrim negativ është 3. Të intervistuarit nga subjektet private raportuese ishin pro ndryshimeve rregullative për përmirësimin e kuadrit rregullativ. Të intervistuar nga institucionet shtetërore ishin të mendimit që këto të fundit nuk mund të sigurojnë lista më të plota të PEP-ve, kështu që subjektet private raportuese duhet të rrisin vigjilencën e zgjeruar për të mitiguar rrezikun e mosidentifikimit të PEP-ve në industrinë ku ato operojnë.

Grafiku 3



Korrupsioni në nivelet e larta shtetërore vazhdon të jetë i një niveli të lartë në rang global me gjithë përpjekjet e bëra nga ligjvënësit. Një sasi e konsiderueshme e parave të krijuara nga korrupsioni me siguri do të kenë destinacionin e pastrimit të produkteve të krimit. Në kontekstin e luftës kundër pastrimit të parave në nivelet e larta politike, lufta kundër korrupsionit mbetet një çështje shumë e rëndësishme. PEP të korrumpuar paraqesin një rrezikshmëri të lartë në fushën e pastrimit të parave dhe subjektet duhet të marrin masa të rëndësishme për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar (tabela 12).

Tabela 12. Masa për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj PEP-ve (ligji 9917 mbi PPP/FT)

	Masa e marra nga subjektet për PEP-at
1	<i>të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut për të përcaktuar nëse një klient ekzistues apo potencial ose pronari përfitues është një person i ekspozuar politikisht;</i>
2	<i>të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me personat e ekspozuar politikisht</i>
3	<i>të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet më pas person i ekspozuar politikisht</i>
4	<i>të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues, të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht</i>

PEP të korrumpuar mund të fshihen pas perdes së anonimitetit të korporatave “off-shore” ose mund të përdorin familjarë dhe persona me lidhje të ngushtë biznesi për ti përfaqësuar në strukturën e pronësisë përfituese të korporatave. Institucioneve financiare dhe jofinanciare ju kërkohet të marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse një klient apo pronar përfitues është një PEP i brendshëm apo një person i cili është ose i ka qenë besuar një funksion i rëndësishëm nga një vend i huaj ose organizatë ndërkombëtare. Ndryshimet e fundit ligjore kanë fuqizuar kontrollin ndaj PEP-ve por nga ana tjetër kanë vështirësuar zbatimin kuadrit ligjor në praktikë. Subjektet financiare dhe në veçanti bankat e kanë shumë të vështirë të identifikojnë dhe të ushtojnë një vigjilencë të zgjeruar për anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta

personale, pune apo biznesi me PEP. ILDKP-ja siguron listën emërore të PEP-ve vendas për autoritetin përgjegjës dhe ky i fundit jua dërgon subjekteve ligjore çdo gjashtë muajor. Kjo listë nuk përmban:

1. anëtarët e familjes;
2. personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të PEP-ve;

Bankat e nivelit të dytë kanë ngritur çështjen e listave të sakta pranë autoriteteve shtetërore dhe shqetësimet rreth identifikimit të saktë të PEP-ve. Problemi ngrihet pasi ligji organik shqiptar mbi PPP por edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk janë specifik në përcaktimin e antarëve të familjes. I njëjti problem vërehet edhe në rastin e përcaktimeve të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare në lidhje me PEP. Çështja që shtrohet për diskutim është së cilët duhet të konsideroheshin pjesëtarë të drejtpërdrejtë të familjes?

- Shtetasit që janë të regjistruar në çertifikatën familjare të gjendjes civile, apo;
- “Të afërm të ngushtë të një personi” të përcaktuar nga BSH për administratorët e bankave të cilët janë (Ligj nr. 9662, Për Bankat në Republikën e Shqipërisë):

a) fëmijët (ose të birësuarit);

b) fëmijët e fëmijëve;

c) bashkëshorti/ja;

ç) prindërit;

d) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre;

dh) personat në kujdestarinë e tij.

Përkufizimi i të “afërmve të ngushtë të një personi” të përcaktuar nga ligji për BSH i afrohet më shumë standartit ndërkombëtar për antarët e familjes së klienteve, por që nuk mund të konsiderohet i plotë. Legjislacioni parashikohet të identifikohet edhe “partnerët” e PEP-ve që është një term shumë i gjerë. Rrjedhimisht një përcaktim i qartë nevojitet në aktet rregulative nënligjore në këtë drejtim.

Situata paraqitet shumë më subjektive kur flitet për personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të PEP-ve. Personat përgjegjës në institucionet financiare dhe jofinanciare e kanë të vështirë të përcaktojnë këto kategori klientesh. Ato duhet të jenë në gjendje të monitorojnë të gjitha marrëdhëniet e biznesit që klientët PEP kryejnë me klientë të tjerë brenda

apo jashtë institucioneve të tyre. Institucionet financiare nuk duhet të bazohen thjesht në vetëdeklarim, por duhet të kryejnë hetime mbi lëvizjet bankare dhe përfituesit e transaksioneve të PEP-ve. Kur gjykohet që klienti PEP kryen marrëdhënie të shumta biznesi me një individ të caktuar, ky i fundit duhet automatikisht të përfshihet në listat PEP. Analizimi transaksioneve në këtë rast jo vetëm kërkon shumë “energj” nga subjektet raportuese por është shumë subjektiv. Vakumi ligjor krijon mundësinë për interpretime të ndryshme dhe për situata të caktuara, subjektet financiare dhe jo financiare mund edhe të penalizohen.

Një element tjetër i rëndësishëm në lidhje me problematikën e listave janë listat e PEP-ve të huaj për të cilët ekzistojnë dhe nevojitet të shfrytëzohen bazat specifike të të dhënave (Wordcheck, Factiva etj). Në mungesë të bazës apecifike, kërkimi bëhet në burimet e hapura të informacionit (psh Google) të cilat përmbajnë shumë informacione të panevojshme. Bazat specifike të të dhënave (Wordcheck, Factiva etj) janë një ndihmesë e madhe për bankat në veçanti. Megjithëse konsiderohen si shumë të besueshme, këto lista nuk janë plotësisht të sakta për shkak të dinamikës së ndryshimit të PEP-ve në mbarë botën. Një databazë me të dhëna të konsiderueshme nga të gjitha vendet e globit është e pamundur të përditësohet në kohë reale. Në këto lista ekzistojnë akoma figura politike që tashmë janë ndarë nga jeta si për shembull Mbreti Ahmet Zog, Ismail Qemali etj. Tjetër problem është se këto lista përfshijnë anëtarët e familjes por nuk përfshijnë plotësisht personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të PEP-ve të huaj. Sidoqoftë listat e Wordcheck, Factiva, Worldcompliance etj, mbeten nga më të saktat e mundshme për momentin. Një problemi i rëndësishëm është kostoja e tyre lartë për subjektet.

Institucioneve financiare bankare në veçanti dhe profesioneve të lira jofinanciare duhet t’ju sigurohet një listë e plotë e PEP-ve të brendshëm dhe të huaj, jo vetëm për të lehtësuar punën e tyre operacionale por edhe për të parandaluar abuzimin që mund të vijë shoqërisë nga PEP të korruptuar. Të intervistuarit nga institucionet shtetërore ishin të mendimit që këto të fundit nuk mund të sigurojnë lista më të plota të PEP-ve se ato aktuale. Madje edhe shtimi i familjarëve të PEP-ve nuk dukej punë e lehtë për shkak të burokracive të institucioneve të ndryshme shtetërore. Sipas tyre, subjektet private raportuese duhet të rrisin vigjilencën e zgjeruar për të zbutur rrezikun që vjen nga mos identifikimi në kohë reale i klientëve PEP dhe transaksioneve të kryer prej tyre në industrinë ku ato operojnë.


3.4 Pyetje kërkimore nr. 4

Eliminimi i rrezikut të pastrimit të parave kërkon një qasje maksimale të subjekteve raportuese ndaj sistemeve kompjuterike. Institucionet e financiare në veçanti nevojiten të kenë sisteme elektronike inteligjente për të identifikuar në kohë reale transaksionet e kryer nga klientët e tyre jashtë natyrës ekonomiko-ligjore. Investimi në sisteme efektive kompjuterike është relativisht i kushtueshem veçanarisht për bankat e vogla të sistemit bankar në Shqipëri. Nisur nga ky arsytim është formuluar pyetja kërkimore në vijim:

Çfarë peshe zënë investimet në teknologjinë e informacionit në lidhje me PPP në banka dhe a duhet të shikohet mundësia nga autoriteti përgjegjës apo mbikëqyrës për harmonizimin e proceseve për ndarjen e kostove ndërmjet subjekteve?

Rezultatet e kërkimit janë të pasqyruara në grafikun 4. Numri i të intervistuarve që mbështesin pyetjen e katërt kërkimore është 7 ndërsa numri i të intervistuarve që nuk e mbështesin këtë pyetje kërkimore është 6. Të intervistuarit ndaheshin në dy grupe në varësi të madhësisë së biznesit dhe të institucionit që përfaqësojnë. Bankat me peshë të vogël në sistemin bankar e ndiejnë më shumë peshën e investimeve në software aplikative në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe në disa raste si për shembull listat elektronike të PEP-ve, kërkojnë mundësinë e ndarjes së kostove midis bankave. Të intervistuarit e bankave të mëdha dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore nuk e konsiderojnë shqetësim të madh kostot e investimeve në këto aplikacione. Të intervistuarit e institucioneve shtetërore e konsiderojnë si një punë jashtë kompetencave të tyre ndërsa për bankat e mëdha sistemike, pavarësisht kostove përkatëse, investimet në këto aplikacione nuk rëndojnë në bilancet e tyre.

Grafiku 4



Investimet në sistemet elektronike inteligjente mbi parandalimin e pastrimit të parave të instaluar në bankat e nivelit të dytë, mundësojnë hedhjen dritë në kohë reale mbi natyrën dhe profilin e transaksioneve të klienteve dhe burimin e të ardhurave të tyre. Aplikimet software identifikojnë në kohë reale transaksionet e lidhura me njëri-tjetrin ose transaksionet komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk përputhen me qëllim e kryerjes së tyre.

“Internet banking”, për shembull, mund të përdoret për një transferim të vetëm të menjëhershëm të kapitalit në shuma të mëdha duke mënjanuar kërkesat e kuadrit rregullativ të PPP dhe të rregullores 70, “Për Veprimtarinë Valutore” të BSH. Subjektet financiare përdorin Internetin si një mjet për të lëvizur fondet nga llogaritë bankare universalisht dhe në një kohë të shpejtë. Transaksioni mund të kryhet në çdo kohë dhe nga çdo vendodhje. Ndër kategoritë e produkteve dhe transaksioneve të cilat paraqesin një nivel të lartë rreziku janë:

- e-banking në rastet e parashikuara nga subjekti në procedurat e tij;
- përdorimi i teknologjive moderne që ofrojnë anonimitet (për shembull ATM, internet banking, mobile banking, prepaid card) (rregullore 55 e Bankës së Shqipërisë mbi PPP/FT).

Ofruesi i shërbimit zakonisht nuk ka një marrëdhënie ballë-për-ballë me klientët e tij. Klientët problematikë mund të keqpërdorin duke mbivlerësuar apo nënvlerësuar vlerat në faturat *pro-forma*, kontratat ku përcaktohet forma e pagesës si dhe në dokumentacionin e zhdoganimit të

mallit. Në varësi të aksesueshmërinë së shërbimit të pagesës në Internet, këto aktivitete mund të përfshijnë pagesa ose transferime fondesh brenda vendit ose përtej kufijve kombëtarë.

Bankat e mëdha në vendin tonë të cilat kontrollohen nga shoqëritë “Mëmë” me rezidencë në vendet e BE kanë tashmë në dispozicionin e tyre aplikacione elektronike për PPP. Direktiva e Komitetit Evropian mbi PPP e konsideron të rëndësishme që institucionet financiare dhe të kreditit të jenë në gjendje për t’iu përgjigjur me shpejtësi kërkesave për informacion në lidhje me marrëdhëniet e biznesit me klientët e tyre. Për qëllim të identifikimit të marrëdhënieve të biznesit si dhe në mënyrë që të jenë në gjendje për të siguruar sa më shpejt informacionin, institucionet e kreditit dhe financiare duhet të kenë sisteme efektive të cilat janë në proporcionalitet me madhësinë dhe natyrën e biznesit të tyre. *Në mënyrë të veçantë do të jetë e përshtatshme për institucionet e kreditit dhe institucionet më të mëdha financiare që të kenë sistemeve elektronike në dispozicion të tyre* (neni 36, direktiva 2005/60 e Komitetit Evropian). Vendet antare duhet të sigurojnë që autoritetet kompetente gjatë kryejes së hetimit, të jenë në gjendje për të përdorur një gamë të gjerë të teknikave investigative të përshtatshme për hetimin e pastrimit të parave, veprave penale të lidhura me to dhe financimit të terrorizmit. Këto teknika hetimore përfshijnë: operacionet sekretë, interceptim të komunikimeve, qasjen ndaj sistemeve kompjuterike dhe të kontrollit të dërgesave. Përveç kësaj, vendet antare duhet të kenë mekanizma efektive në vend për të identifikuar në kohën e duhur, nëse personat fizikë ose juridikë mbajnë dhe kontrollojnë llogaritë e tyre (*rekomandimi nr. 31 i FATF-së*).

Institucionet financiare dhe profesionet e lira jo financiare duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj (*udhëzim 28 i Ministrisë së financave mbi PPP/FT*).

Rekomandimet e mësipërme e bëjnë të domosdoshme për institucionet e kreditit dhe institucionet më të mëdha financiare që të kenë sisteme elektronike inteligjente kundër pastrimit të parave në dispozicion të tyre. Institucionet financiare duhet të jenë në gjendje për t’iu përgjigjur me shpejtësi autoritetit përgjegjës mbi kërkesat për informacion për marrëdhëniet e biznesit me klientët e tyre. Institucioneve financiare ju kërkohet t’u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse dhe investimi në sisteme efektive kompjuterike që bëjnë të mundur parandalimin e transaksioneve me natyrë të dyshimtë në kohë reale shikohet si mëse i domosdoshëm.

Në këto sisteme duhet të përfshihen gjithashtu bazat specifike të të dhënave (Wordcheck, Factiva etj.) për trajtimin efikas të klientëve PEP. Këto databaza ju përmbahen rekomandimeve të FATF-së dhe lehtësojnë operacionalitetin e bankave pasi programe të tilla mund të inkorporohen në sistemet kompjuterike të bankave duke bërë të mundur një monitorim elektronik të të dhënave. Transaksionet e dyshimta do të pikaseshin dhe bllokoheshin menjëherë nga filtrat apo “rrjetat” elektronike përpara kryerjes së transaksionit. Subjektet raportuese, në rastin e PEP-ve, nuk kanë për të bërë hulumtime dhe analiza të shumta nëse një klient jo rezident i përket apo jo një kategorie të caktuar të PEP-ve. Sapo një PEP i huaj të hapë një mardhënie biznesi apo të kryejë një transaksion, për shëmbull një transfertë, sistemi elektronik aktivizon opsionin “alarm” në ekran dhe bllokon kryerjen e transaksionit. Personi përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në bankë kryen vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit dhe në varësi të rastit bën të mundur ç’bllokimin “release” e transaksionit apo raportimin pranë autoritetit përgjegjës.

Në mungesë të një sistemi kompjuterik, burimet e hapura mbeten e vetmja alternative. Në rastin e PEP-ve të huaj, bruime të tilla si “google search” përmbajnë shumë informacione të panevojshme. Analiza duhet të jetë shumë më e detajuar për të përcaktuar nëse klienti jorezident i përket kategorisë së përcaktuar nga kuadri ligjor për PEP-at e huaj. Kërkimi nga departamentet përkatëse të bankave mbetet në rrafshin manual dhe si rezultat burimet e hapura janë alternativa më e dobët krahasuar me bazat specifike të të dhënave. Një kërkim i tillë do të konsumonte shumë kohë dhe bankave ju nevojitet të kenë punonjës me eksperinca dhe të mirëtrajnuar në fushën e PPP. Stafit i bankës, në mënyrë që të mos abuzohet me transaksionet bankare të kryera nga klientët në kohë reale, duhet të jetë i trainuar në të tria nivelet: shërbimi i klientelës, departamenti përkatës i parandalimit të pastrimit të parave dhe kontrolli i brendshëm. Kuadri rregullativ i PPP ka lënë si opsion burimet e hapura të informacionit për personat e huaj të ekspozuar politikisht deri në paraqitjen e mundësisë financiare për investime të rëndësishme në softet kompjuterike në të ardhmen.

Kërkesat ligjore për aplikimin e sistemeve inteligjente kompjuterike mbi PPP të cilat përfshijnë bazat specifike të të dhënave Wordcheck, Factiva etj, kërkojnë investime në shuma të konsiderueshme për bankat e nivelit të dytë në vend. Këto kosto ndihen më shumë tek bankat me kapital të vogël ose që po përpiqen të arrijnë “Breakeven”. Investimi i bërë nga një bankë e madhe sistemike në Shqipëri në sistemin elektronik lidhur me PPP arrin shifrën 250,000.00 Euro dhe

mirëmbajtja e sistemit kushton të paktën 3,000.00 Euro në vit. Ky sistem ka të përfshirë module të rëndësishme për analizimin e të dhënave. Shërbimi për bazën e të dhënave “Wordchek” për identifikimin e PEP-ve të huaj kushton të paktën 20,000.00 Euro në vit. Përballë rreziqeve gjithnjë e në rritje të pastrimit të parave që vijnë nga zhvillimet e produkteve të reja teknologjike, bankat e mëdha kanë marrë masat nevojshme dhe kanë investur tashmë në sisteme inteligjente në lidhje me PPP. Investime të tilla janë të konsiderueshme për bankat e vogla dhe të mesme në vendin tonë. Kostot rëndojnë më shumë në buxhetet e bankave të vogla dhe të mesme në tregun Shqiptar. Ka patur tentative nga banka të vogla për të siguruar nga autoritetet përgjegjëse apo mbikëqyerse shërbimin e njëjës prej bazave specifike të të dhënave qoftë Wordcheck, Factiva, Worldcompliance etj, dhe duke patur opsionin “share” të jenë në gjendje të aksesojnë të dhënat duke ndarë edhe shpenzimet ndërmjet tyre. Deri më tani nuk ka patur përgjigje konkrete nga këto institucione. Të intervistuarit e institucioneve shtetërore e konsiderojnë si një punë jashtë kompetencave të tyre. Ndërmjetësimi në ndarjen e kostove nga autoritet shtetërore shikohet si një hap i rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet subjekteve raportuese dhe atyre shtetërore.

Metoda kriminale teknologjike mund të hedhin poshtë brenda një faksioni sekonde punën e ndërtuar me kujdes nga strukturat përkatëse të bankës. Megjithëse një institucioni financiar mund të ketë identifikuar qartë klientin apo pronarin përfitues, ndërhyrja në sistem dhe “vjedhja” e login-ve të llogarive bankare apo identitetit të klienteve mund të shkaktojë përdorimin e bankës për pastrim parash dhe rrjedhimisht një rrezik serioz financiar dhe reputacional për të. Njësitë shtetërore anti kriminale “high-tech” në këtë rast marrin një rol shumë të rëndësishëm. Ato kryejnë hetime të krimit në internet, mbledhin dhe analizojnë të dhëna, kërkjone në sistemet kompjuterike, asistojnë departamentet e tjera të policisë në hetimet e krimeve kibernetike, shkëmbejnë informacione më njësi të ngjashme të vendeve të tjera. Shpejtësia e komunikimit dhe bashkëpunimi në kohë reale i bankave me autoritetin përgjegjës lidhur me operacionet dyshimta sidomos në rastet e transfertave ndërkombëtare mund të lehtësojë ndjeshëm identifikimin e skemave të pastrimit të parave. Rritja e ndërsjelltë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe subjekteve raportuese do të lehtësonte punën operationale të këtyre të fundit në kuadër të luftës kundër krimeve teknologjike.


3.5 Pyetja kërkimore nr. 5.

Profesionet e lira janë të detyrur të raportojnë raporte të aktivitetit të dyshimtë RAD dhe raporte të transaksioneve të vlerave RTV në para fizike mbi limitin e përcaktuar pranë autoritetit përgjegjës, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj. Ekspertët kontabel, firmat audituese dhe kontabilistët e miratuar ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga institucionet financiare në aspektin e madhësisë. Në kontrast me institucionet financiare, një numër i madh i profesioneve të lira kanë vetëm një person i cili mund të jetë përgjegjës për kryerjen e shumë funksioneve dhe raportimi i transaksioneve të vlerave kufizon burimet burimet njerëzore dhe financiare që profesionet e lira mund të shfytëzojnë për transaksionet e dyshimta. Një çështje tjetër e rëndësishme që lidhet me raportimin e profesioneve të lira, është përfshirja e profesione të tjera të lira krahas avokatëve në sekretin profesional sa i përket detyrimeve të raportimit tek autoriteti përgjegjës. Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në situata të caktuara. Standardet ndërkombëtare parashohin që profesione të tjera të lira të jenë subjekt i të njëjtave detyrime të fshehtësisë apo privilegjit si avokatët. Duke marrë shkas nga ky arsyetim propozohet pyetja kërkimore në vijim:

A duhet të përjashtohen profesionet e lira nga detyrimi i raportimit të RTV-ve, dhe të fokusohen vetëm tek raportimi i RAD-ve?

Rezultatet e kërkimit janë të pasqyruara në grafikun 5. Numri i të intervistuarve që mbështesin pyetjen e pestë kërkimore janë 9 dhe asnjë nga të intervistuarit nuk u shpreh negativisht për këtë pyetje kërkimore. Përfaqësuesit e profesioneve të lira jofinanciare dhe të institucioneve shtetërore janë të mendimit se raportimi i profesioneve të lira duhet parë nga kënvështrimi i raportimit të aktivitetit të dyshimtë.

Grafiku 5



Profesionet e lira jo financiare përbëjnë një tematikë të rëndësishme në lëmin e parandalimit të pastrimit të parave. Ato njihen gjithashtu me termin ndërkombëtar DNFBP. Rreziku i lidhur me avokatët, noterët, kontabilistët, etj, qëndron në thelb në keqpërdorimin e mundshëm të këtyre profesioneve në fshehjen e identitetit të pronarëve përfitues apo transaksioneve të kryera nëpërmjet tyre. Profesionistët lirë të pavarur duhet të identifikojnë klientët dhe pronarët përfitues të shoqërive me të cilat kryejnë marrëdhënie biznesi.

Avokatët, noterët, profesionistët tjerë të pavarura ligjore dhe kontabilistët duhet të raportojnë transaksionet e dyshimta kur angazhohen në transaksione financiare me klientët e tyre. Subjektet që merren me shitje të metaleve të çmuara dhe tregtarët e guarve të çmuara duhet të raportojnë transaksione të dyshimta kur ata angazhohen kryesisht në transaksione në të holla me klientët në shumë të barabartë me ose mbi pragun e zbatueshëm të caktuar.

Profesionet e lira kanë të njëjtat detyrime për raportimin pranë autoritetit përgjegjës sikundër subjektet e tjera raportuese të ligjit përfshirë këtu edhe institucionet e mëdha financiare bankare. Ligji 9917 mbi PPP/FT, nuk bën dallim ndërmjet profesionet të lira jofinanciare dhe subjekteve financiare të industrisë bankare përsa i përket kërkesave raportuese (tabela 13).

Tabela 13. Detyrimet raportuese të subjekteve (ligji 9917 mbi PPP/FT)

	Detyrimet raportuese të subjekteve financiare dhe jofinanciare
1	<i>Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë. (RAD)</i>
2	<i>Kur subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijëni, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrat të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit. (RAD)</i>
3	<i>Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve. (RTV)</i>

Sipas dispozitave të mësipërme ligjore, profesionet e lira, janë të detyrur të raportojnë si RAD ashtu dhe raporte të transaksioneve të vlerave RTV në para fizike mbi limit pranë autoritetit përgjegjës, brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj. Në rast të kundërt shkeljet e kryera nga profesionet e lira jofinanciare mund të klasifikohen si kundërvajtje administrative për të cilat ndëshkohen me masa administrative.

Avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjorë, ekspertet kontabël, kontabilistë të miratuar etj., kur ofrojnë shërbimet për klientët e tyre, duhet të shqyrtojnë transaksionet e kryer nga klientët e tyre edhe nën dritën e tipologjive të pastrimit të parave. Kur vërejnë dyshime se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo

fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale, ato paraqesin një RAD tek autoriteti përgjegjës brenda afatit kohor të përcaktuar.

Ekspertet kontabel dhe shoqëritë audituese, ushtrojnë profesionin për auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, të shoqërive tregtare, ndërmarrjeve apo organizatave të tjera, kur auditimi detyrohet nga ligji ose kërkohet nga ortakët/aksionarët e tyre (*Ligj nr. 10 091 Për Auditimin Ligjor*). Eksperti kontabël apo shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, shqyrton informacionet dhe dokumentet bazuar në kërkesat ligjore të parandalimit të pastrimit të parave. Kur dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet transaksione të pastrimit të parave, njoftojnë menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë Autoritetin Përgjegjës.

Ekspertet kontabel, firmat audituese dhe kontabilistët e miratuar, noterët etj ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga institucionet financiare në aspektin e madhësisë. Njëlloj si institucionet financiare e tjera edhe profesionet e lira duhet të emërojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, tek të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe të përcaktojnë procedura të përshtatshme menaxhimi e përputhshmërie, brenda subjektit dhe degëve (*ligj 9917 mbi PPP/FT*). Në rast se numri i punonjësve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj është më pak se 3 persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit.

Ligji i organik i PPP, nr. 9917, përcakton që profesionet e lira janë të detyruar të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda ditës së nesërme, të gjitha transaksionet në para fizike RTV, kur përgatisin ose kryejnë transaksione për klientët e tyre për disa lloj veprimtarish si kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të aseteve të tjera; administrimin e llogarive bankare; administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare; krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore. Në kontrast me institucionet financiare, një numër i konsiderueshëm i profesioneve të lira kanë vetëm një punonjës. Kjo, kufizon burimet njerëzore dhe financiare që profesionet e lira mund të vënë për parandalimin e transaksioneve të dyshimta. Për një numër të madh ekspertësh kontabel, një person i vetëm mund të jetë përgjegjës për kryerjen e shumë funksioneve duke përfshirë nga gjërat më të thjeshta si

posta e deri tek menaxhimi i lartë dhe detyrimi për raportimin e RTV-ve pranë autoritetit përgjegjës është një ngarkesë e tepërt.

Kuadri nën-ligjor i PPP, gjithashtu, parashikon të njëjtat detyrime si për profesionet e lira ashtu dhe për subjektet raportuese financiare pa dallim. Kërkesat rregullative si më poshtë rrisin ndjeshëm barrën e kostove të tyre (*Udhëzim nr. 29, i Ministrisë së Financave mbi PPP/FT*):

- nëse një klient/pronar përfitues është person i ekspozuar politikisht profesionet e lira duhet: *të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj*
- Profesionet e lira duhet: *të krijojnë një sistem të centralizuar që të mundësojë regjistrimin, grumbullimin, analizimin dhe gjetjen e të dhënave. Ky sistem minimalisht duhet të përmbajë të dhënat sipas aneksit IV bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këto të dhëna duhet të jenë të mbështetura në dokumentacion justifikues dhe nëse kërkohet, të vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse/licencuese dhe audituesve. Krahas mbajtjes në format shkresor, këto të dhëna të mbahen edhe në format elektronik dhe të jenë të përpunueshme (p.sh. Excel, Access).*

Raportimi i transaksioneve të vlerave në para fizike mbi pragun e raportimit pranë autoritetit përgjegjës sa herë që konstatojnë një gjë të tillë konsiderohet i ekzagjeruar nga përfaqësuesit e profesioneve të lira. Për të përmbushur këtë detyrim, mund të neglizhohen RAD-të, të cilat kanë një rëndësi më të madhe në analizat e kryera nga autoriteti përgjegjës dhe autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit.

Rekomandimi 23 i FATF-së, pjesë ndryshimeve të fundit të Shkurtit 2012, vendos theksin në raportimin e RAD-ve dhe nuk përcakton raportimin e RTV-ve. Sipas këtij rekomandimi:

Kërkesat e përcaktuara në Rekomandimet 18 dhe 21 zbatohen për të gjitha bizneset dhe profesionet jo-financiare, subjekt i kualifikimeve të mëposhtme:

(a) avokatët, noterët, profesionistët e tjerë ligjorë të pavarur dhe kontabilistët duhet të kërkohet që të raportojnë transaksionet e dyshimta kur, në emër të ose për një klient, ata angazhohen në një transaksion financiar në lidhje me aktivitetet e përshkruara në paragrafin (d) të Rekomandimit 22.

Vendet janë të inkurajuara për të zgjeruar kërkesat e raportimit për pjesën tjetër të aktiviteteve profesionale të kontabilistëve, duke përfshirë auditimin.

*(b) bizneseve në metale të çmuara dhe tregtarëve në gurë të çmuar duhet t'u kërkohej që të raportojnë **transaksione të dyshimta** kur ata angazhohen në çdo transaksion në para fizike me një klient për një shumë të barabartë apo mbi pragun e zbatueshëm të caktuar.*

*(c) Trustet dhe ofruesit e shërbimit të kompanisë duhet të kërkohej që të raportojnë **transaksionet e dyshimta** për një klient, kur, në emër të ose për një klient, ata angazhohen në një transaksion në lidhje me aktivitetet e përmendura në paragrafin (d) të Rekomandimit 22.*

Rekomandimet ndërkombëtare kanë një qëndrim të qartë mbi çështjen e raportimit të transaksioneve të dyshimta nga profesionet e lira. Ligjvënësit tanë nuk duhet të ngarkojnë subjektet ligjore me kërkesa rregullative dhe ligjore që shkojnë përtej standardeve ndërkombëtare. Shoqëritë e mëdha të auditimit si KPMG, PWC, Deloitte etj, kanë një numër relativisht më të madh punonjësish krahasuar me ekspertët kontabël individual. Edhe në rastin e firmave të mëdha të auditimit “energji” e burimeve njerëzore duhej të fokusohesh në raportimin e RAD-ve. Këto firma, pamvarësisht madhësisë së tyre, do të rrisnin efikasitetin e luftës ndaj PPP nëse raportojnë pranë autoritetit përgjegjës një numër më të madh të RAD-ve sesa çdo RTV mbi pragun e raportimit.

Kontabilistët në praktikë ofrojnë një numër shumë të gjerë të shërbimeve pranë një game shumë të ndryshme të klientëve. Ekspertët kontabël, shoqëritë audituese dhe kontabilistët e miratuar mund të japin kontributin e tyre në dërgimin e RAD-ve gjatë kryerjes së shërbimeve të tilla, të cilat përfshijnë (por nuk kufizohen):

- Auditimin e shërbimeve për klientet e tyre;
- Rritjen e kapitalit të aksionereve të shoqërisë (nëpërmjet financimit ose në natyrë);
- Shpërndarjen e kapitalit;
- Riorganizimin juridik nëpërmjet bashkimit, ndarjes ose çdo forme tjetër të ngjashme të shoqërive;
- Transferimin e pronësisë së aksionereve etj.

IEKA si një organ profesional që rregullon industrinë e kontabilitetit në Shqipëri mund të japë një ndihmë specifike në përcaktimin e transaksioneve apo tipologjive të dyshimta që mund të

shërbejnë si udhërrëfyes për kontabilistët profesionistë. Këto tipologji duhet të paqyrohen në udhëzimin e Ministrisë së Financave për profesionet e lira. Kontabilistët e miratuar të pavarur ngrenë të njëjtat problematika si në rastin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pavarur. Shqetësimet e ngritura nga të intervistuarit janë të njëjta dhe fokusi tek raportimi i RAD-ve është mjaft domethënës për përmirësimin e punës në drejtim të parandalimit të abuzimit nga “pastruesit e parave” në këto subjekte.

Noterët kanë të njëjtën problematikë si kontabilistët sa i përket raportimit të vlerave RTV. Bazuar në opinionin e tyre, shqetësimet në lidhje me raportimin e transaksioneve të vlerave RTV konsistojnë si më poshtë:

- Ngarkesa është shumë e madhe. Pothuajse të gjitha transaksionet kalojnë shumën prej 1,000,000.00 lekësh të reja ose ekuivalenti në monedha të huaja dhe duhet të raportohen brenda 24 orëve të ardhshme;
- Raportimi i RTV-ve shpërqëndron vëmendjen e noterëve dhe humbet fokusi në raportimin e RAD-ve;
- Rriten kostot për noterët, pasi detyrohen të punësojnë persona shtesë për të përballuar ngarkesën;
- Rritet mundësia për nxjerrjen e informacionit nga zyrat noteriale pasi personat shtesë të punësuar kanë tashmë dijeni për raportimin.

Mënjanimi i raportimi voluminoz të transaksioneve të vlerave, shoqëruar edhe me rritjen e masave ndëshkuese nëse vihen re abuzime nga ana e noterëve, me siguri do të rriste numrin e raporteve të transaksioneve të dyshimta. Funksionimi i dhomës qëndore noteriale spanjolle ofron një praktikë të veçantë në raportimin e noterëve pranë autoritetit përgjegjës. Në këtë organizëm është e atashuar një njësi e veçantë e cila filtron të gjitha transaksionet e kryera nga noterët spanjollë dhe nëse konstatojnë dyshime, i raporton ato menjëherë pranë autoritetit përgjegjës. Autoriteti përgjegjës do të ishte më i interesuar të shmangej raportimi i transaksioneve të shumta të vlerave që e bën të vështirë menaxhimin e tyre dhe ul cilësinë e raportimeve.

Profesione të tjera të lira jo financiare si agentët e pasurive të patundshme apo vlerësues të pasurive të patundshme përballen me të njëjtat sfida sa i përket raportimit të transaksioneve të vlerave dhe të dyshimtave. Fokusi tek transaksionet e dyshimta do të përmirësonte ndjeshëm procesin e parandalimit të parave në këtë sektor. Një mënyrë tradicionale e pastrimit të parave konsiderohet transaksionet e pasurive të patundshme në sektorin e ndërtimit, sidomos kur janë të bazuara në “cash”. Vendi ynë është karakterizuar nga një “bum” ndërtimesh në dy dekadat e fundit. Raportimi i të gjitha transaksioneve të vlerave siç është parashikuar aktualisht në ligj thjesht rrit kostot, shmang fokusin e raportimit të RAD-ve. Shërbimet e ofruara nga agentët të pasurive të patundshme, të cilat mund të keqpërdorohen për pastrimit parash nga shkelesit të ligjit dhe që duhet të trajtohen nën dritën e dergimit të RAD-ve pranë autoritetit përgjegjës, përfshijnë ndër të tjera:

- Angazhimi në një sërë transaksionesh në pasuri të paluajtshme të dizenuar për të fshehur burimin e paligjshëm të fondeve, të cilat mund të klasifikohen në fazën e vendosjes;
- Investimi i parave në komplekset turistike në mënyrë që të fitojnë pamje legjitime, të cilat mund të klasifikohen në fazën e integritit;
- Blerja dhe shitja e pronave të patundshme me emra fiktive;
- Nënvlërësimi dhe mbivlerësimi i çmimeve të pronave të patundshme. Çmimi i deklaruar i blerjes është më pak se vlera reale pronës dhe më pas shitja bëhet me çmimin e vërtetë.

Një çështje tjetër e rëndësishme që lidhet me raportimin e profesioneve të lira, është përfshirja e profesione të tjera të lira krahas avokatëve në sekretin profesional sa i përket detyrimeve të raportimit pranë autoritetit përgjegjës. Profesione të lira jo financiare, ashtu si edhe subjektet e tjera të përcaktuara në ligjin Shqiptar mbi parandalimin e pastrimit të parave nuk lejohen të spekulojnë me sekretin profesional ose përfitimet që rrjedhin prej tij. Subjektet nuk duhet ta përdorin sekretin profesional ose përfitimet prej tij si arsye për mosrespektimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky ligj, kur kërkohet informacion ose kur, në përputhje me këtë ligj, urdhërohet nxjerrja e një dokumenti, që ka lidhje me informacionin. Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në situata të caktuara. *Avokatët dhe noterët janë të detyruar ta raportojnë informacionin për klientin tek autoriteti përgjegjës, në përputhje me këtë ligj. Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej*

tyre, në një proces gjyqësor, ose nga dokumentet, që ky i fundit ua ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar (neni 25, ligj 9917 mbi PPP/FT).

Avokatët për vetë natyrën e punës së tyre kanë shpehur rezervat e tyre në lidhje me raportimin e transaksioneve të dyshimta për klientet e tyre pranë autoritetit përgjegjës. Avokati, nga njëra anë duhet të mbrojë klientin e tij dhe nga ana tjetër mund të dergojë një RAD, i cili përmban elementë të dyshimtë për pastrimin e parave. Rekomandimet e FATF-së dhe legjislacioni Shqiptar kanë përcaktuar llojet e transaksioneve për të cilët avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim në ushtrim të kompetencave ligjore të parandalimit të pastrimit të parave. Avokatët nuk dërgojnë RAD tek autoriteti përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me privilegjin profesional ligjor apo me sekretin profesional ku përfshihen informacione në lidhje me kryerjen e detyrës gjatë mbrojtjes ose përfaqësimit të klientit të tyre, si dhe në lidhje me çështjet gjyqësore, administrative, të arbitrazhit dhe procedurave të ndërmjetësimit.

Profesione të tjera të lira mund të përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet klientëve ose përfaqësuesve të tyre, në situata të caktuara. Sipas rekomandimit 16 të FATF-së: *kur kontabilistët janë subjekt i detyrimeve të sekretit profesional ose privilegjit ligjor profesional (në natyrë të ngjashme me atë të profesionistëve ligjor), ata nuk janë të detyruar të raportojnë dyshimet e tyre, nëse informacioni përkatës është marrë në rrethana ku ata janë subjekt i sekretit profesional ose privilegjeve profesionale juridike sipas ligjeve të atij vendi. Sekretit profesional / privilegj ligjor profesional nuk janë të njëjta me konfidencialitetin e klientit. Në vazhdim po sipas këtij rekomandimi, secili vend duhet të përcaktojë çështjet që do të përfshihen në privilegjin ligjor profesional apo sekretin profesional të profesioneve të lira. Avokatët përfshihen në këtë privilegj në rastin e informacionit që marrin prej klientëve të tyre: (a) në rrjedhën e konstatimit të pozicionit ligjor të klientit tyre, ose (b) në kryerjen e detyrës së tyre në mbrojtjen ose përfaqësimin e klientit, ose në lidhje me çështjet gjyqësore, administrative, apo të procedurës së ndërmjetësimit. Kur kontabilistët janë subjekt i detyrimeve të njëjta të sekretit apo privilegjit profesional, për ato nuk duhet të jetë e nevojshme raportimi i transaksioneve të dyshimta (FATF Guidance For Accountants, 17.05.2008).*

Ndryshimet në rekomandimet e fundit të FATF-së të Shkurtit 2012 i mëshojnë faktit që edhe profesione të tjera jofinanciare, krahas avokatëve, mund të trajtohen nën dritën e privilegjit profesional ligjor. Është detyrë e secilit vend për të përcaktuar çështjet që do të përfshihen nën

privilegjin profesional ligjor ose fshehtësinë profesionale. Kjo normalisht do të mbulojë informacionin që avokatët, noterët apo profesionistë të tjerë ligjorë të pavarur, marrin nga klientët e tyre: (a) në rrjedhën e konstatimit të pozitës juridike të klientit të tyre, ose (b) në kryerjen e detyrave të tyre për të mbrojtur ose përfaqësuar klientin, ose në çështjet gjyqësore, administrative, arbitrazhit, apo procesit të ndërmjetësimit (Shënime interpretuese, Rekomandim 23 i FATF-së).

Direktiva 2005/60 e Komunitetit Evropian mbi PPP, e cila është në vijim të rekomandimeve të FATF-së, gjithashtu parashikon privilegjin profesional ligjor. Kur anëtarë të pavarur të profesioneve të lira ofrojnë këshilla ligjore të cilat janë të njohura ligjërisht dhe të kontrolluara, gjatë konstatimit të pozitës juridike të një klienti ose përfaqësimit të një klienti në procedura ligjore, kjo nuk do të jetë e përshtatshme sipas kësaj Direktive për të vënë profesionistët ligjore nën detyrimin për të raportuar dyshimet për pastrim parash ose financim të terrorizmit (Paragrafi 20 direktiva 2005/60). Përfundimi bëhet vetëm nëse klienti kërkon këshillim për pastrim parash. Shërbimet drejtpërsëdrejt të krahasueshme duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë kur parashikohet nga kjo Direktivë. Në mënyrë që të sigurojë respektimin e të drejtave të parashtruara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të Traktatit të Bashkimit Evropian, në rastin kur auditorët e jashtëm, kontabilistët dhe këshilltarët tatimorë mbrojnë ose përfaqësojnë një klient në kontekstin e procedimeve gjyqësore apo gjatë konstatimit të pozitës ligjore të klientit, informacioni që ata marrin në kryerjen e këtyre detyrave nuk duhet të jetë subjekt i detyrimeve të raportimit (Paragrafi 21 direktiva 2005/60).

Për sa kohë që standardet ndërkombëtare parashohin që kontabilistët të jenë subjekt i të njëjtave detyrime të fshehtësisë apo privilegjit si avokatët është e nevojshme të përcaktohen çështjet që do të përfshihen nën privilegjin profesional ligjor ose fshehtësinë e tyre profesionale dhe të paraqiten këto amendime tek ligjvënësit në mënyrë që të mos raportohen raste të tilla. Të gjitha këto masa do të ndihmojnë profesionet e lira në fokusimin tek transaksionet e dyshimta të klientëve të tyre, dhe do të rrisin efikasitetin në përpjekjet e subjekteve për të reduktuar rrezikun që vjen nga pastruesit e parave dhe shkelësit e tjerë të ligjit.

Noterët nuk mund të përfshihen në privilegjin e sekretit profesional pasi natyra e punës së tyre nuk konsiston në mbrojtjen ose përfaqësimin e klientit, ose në çështjet gjyqësore, administrative, arbitrazhit, apo procesit të ndërmjetësimit. Megjithatë ligji nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë” ka nevojë për përmirësim sa i përket nenit 23 për të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes

së veprimtarisë së tij dhe që përbëjnë sekret profesional. Sipas këtij neni: *Të dhëna për përmbajtjen e akteve noteriale të kryera mund t'u jepen vetëm personave, në emër të cilëve janë kryer këto veprime. Gjykata, prokuroria dhe hetuesia mund të njihen me të dhëna të kësaj natyre, kur kanë filluar ndjekjet penale kundër noterit lidhur me detyrën e tij, ose kundër shtetasit që është subjekt në veprime noteriale të kryera, por gjithnjë pa u dëmtuar interesat themelore të shtetit a shtetasve të veçantë.* Gjithashtu neni 51 i ligjit “Për Noterinë” citon: *Me kërkesën e palëve, akti noterial hartohet në shumë origjinale, prej të cilave, pasi mbahet në zyrën e noterisë, të tjerat u dorëzohen palëve. Origjinalet e akteve ruhen në arkivin e noterisë dhe nuk mund të tërhiqen prej tij, me përjashtim të rasteve kur këtë e kërkojnë gjykata a prokuroria. Në një rast të tillë vihet shënim në dosjen nga u tërhoq akti. Këto organe, pasi pasqyrojnë çka u duhet prej aktit në procesin hetimor ose gjyqësor, detyrohen t'ia kthejnë atë noterisë.* Këto nene nuk janë në harmoni me nenin 3, të ligjit 9917 mbi PPP/FT, i cili i pëcakton noterët si subjekte raportuese të ligjit. Rrjedhimisht duhet që në nenin e mësipërm të ligjit për noterinë, krahas gjykatës dhe prokurorisë, të përfshihet DPPPP-ja e cila, në bazë të kuadrit ligjor të PPP/FT, ka të drejtë të ketë akses në aktet origjinale që ruhen në arkivin e noterisë.

Përfundimisht profesionet e lira jofinanciare raportojnë transaksionet e vlerave dhe nuk japin kontributin e tyre të plotë në raportimet e transaksioneve të dyshimta të kryera nga klientet e tyre dhe amendamentet e nevojshme ligjorë duhet të adresohen në kuadrin tonë ligjor. Profesionet e lira, në rrjedhën e punës së tyre operationale, duhet të përqëndohen tek produktet, shërbimet dhe konsumatorët që janë më të prekshëm dhe ku mund të abuzohet lehtësisht nga pastruesit e parave. Këto subjekte duhet të fokusohen në identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të tij, në marrjen e masave të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues duke kuptuar më mirë strukturën e pronësisë dhe kontrollin mbi personat juridikë. Vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet mbledhjes së informacioneve mbi natyrën dhe qëllim e marrëdhënies së biznesit të klientëve të tyre. Ekspertët kontabël dhe shoqëritë audituese duhet të jenë pjesë e nenit 25, të ligjit 9917 mbi PPP/FT, “Moslejimi i spekulimit me sekretin profesional ose përfitimet prej tij”, krahas avokatëve. Në aktet nënligjore, duhet të përcaktohet qartë rastet kur profesionet e lira janë pjesë e sekretit profesional.


3.6 Pyetja kërkimore nr. 6

Institucionet raportuese financiare dhe jofinanciare, të gjendur para një vakumi rregullativ, përballen me dilemën nëse transaksionet me natyrë evazioni fiskal duhet të raportohen si aktivitet i dyshimtë. Raportimet e transaksioneve me natyrë evazioni fiskal mund të konsiderohen si të tepruara për mungesë elementësh të dyshimtë por nga ana tjetër, subjektet raportuese mund të penalizohen për mosraportim. Fluturimi i kapitalit jashtë vendit dhe përdorimi i llogarisë së administratorëve e mbështesin më tepër këtë argument. Bazuar në këtë arsyetim formulohet pyetja kërkimore në vijim:

A duhet të përfshihen transaksionet me natyrë evazioni fiskal në kërkesat rregullative të vigjilencës së zgjeruar të PPP dhe a duhet të raportohen ato si RAD?

Rezultatet e kërimit janë të pasqyruara në grafikun 6. Numri i të intervistuarve që mbështesin pyetjen kërkimore është 8 ndërsa numri i të intervistuarve që nuk e mbështesin është 5. Të intervistuarit, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të disa bankave, janë për përfshirjen e sa më shumë tipologjive apo treguesve të dyshimtë që përmbajnë elementë të evazionit fiskal në kuadrin rregullativ të pastrimit të parave. Përfaqësues të disa bankave të tjera e shikonin këtë hap si të parakohshëm dhe mund të sillte kosto për bankat për shkak të pakënaqësisë që mund të ngjallin masa të tilla në klientelën e bankës.

Grafiku 6




Evazoni fiskal dhe pastrimi i parave janë fenomene shumë të ngjashme. Një numër i konsiderueshem transaksionesh bien në kufirin e asaj që mund të quhet evazion fiskal apo pastrim parash. Legjislacioni në fuqi nuk është i qartë nëse transaksione të tilla duhet të raportohen apo jo. Mungesa e një kuadri ligjor dhe nën ligjor të qartë i vendos oficerët e përputhshmërisë në banka, të cilët merren me raportimet e transaksioneve të dyshimta, përballë vendimarrjeve të vështira dhe shumë komplekse që lënë vend për interpretime.

Përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 66/2012, datë 07.06.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për PPP/FT”, i ndryshuar, bankat duhet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një shumë të barabartë në vlerë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. Heqja e detyrimit për të gjitha transaksionet jo në para fizike, detyrimisht kërkon nga bankat që të rrisin numrin e raporteve të aktivitetit të dyshimtë. Institucionet financiare dhe profesionet e lira jofinanciare kanë detyrimin të raportojnë pranë DPPPP-së, të gjitha rastet e veprimtarisë së dyshimtë pavarësisht nga shumat e përfshira nëpërmjet RAD-ve. Bankat i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashirojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se periudha e përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të ligjit. Përveç sasisë së RAD-ve një rëndësi të veçantë ka edhe cilësia e tyre.

Gjatë vitit 2007 u raportuan shumë transaksione të dyshimta RAD pranë DPPPP-së me natyrë të evazionit fiskal. Vitet në vijim ky numër ra ndjeshëm pasi RAD të tilla nuk u konsideruan me vlerë të veçantë. Grafiku numër 7 tregon në mënyrë kronologjike fluksin e RAD-ve të raportuara gjatë viteve 2005 - 2009. Nga grafiku vihet re një rritje graduale e numrit të raportimeve të veprimtarisë së dyshimtë, me oshilacione të theksuara në vitet 2006 - 2007.

Grafiku 7. RAD të raportuara në DPPPP në vitin 2007

**Burimi DPPPP, raporti vjetor 2009**

Viti 2007 tragon për një rritje rekord prej 748 raportimesh të aktiviteteve të dyshimta nga bankat. Nga vlerësimet që iu janë bërë RAD-ve në raportet vjetore të viteve 2007 e 2008, rezulton se shumica e tyre kanë të bëjnë me kryerje shkëmbimesh valutore të palicënuara, transferta të shumëfishta në drejtim të një përfituesi dhe transaksione të tjera me natyrë tregtare. Fakti që në vitin 2007, vetëm 1% e totalit të raportimeve RAD-ve janë referuar në organet e zbatimit të ligjit, dëshmon se këto transaksione janë konsideruar me mungesë të elementëve të mjaftueshëm të dyshimit në lidhje me pastrimin e parave. Veprimet bankare të cilat përmbajnë elementë të evazionit fiskal nuk janë trajtuar si çështje që kanë lidhje direkte me pastrimin e parave.

Këtu përballemi me dy probleme të rëndësishme. Institucionet financiare duhet të kujdesen që krahas rritjes së numrit të RAD-ve, të rrisin edhe cilësinë e tyre. Nga njëra anë kemi rritje saiore të numrit të RAD-ve e cila është konsideruar e pavlerë. Nga ana tjetër, shumica e këtyre transaksioneve përmbajnë elementë të evazionit fiskal dhe shmangies tatimore dhe si të tilla mund të çojnë në evazion të pastër fiskal. Kjo situatë i bën personat përgjegjës të bankave të paqartë në lidhje me raportimin apo jo si të dyshimtë të transaksionit pranë autoritetit përgjegjës. Ligjvënësi nuk e ka të definuar qartë në kuadrin ligjor dhe rregullativ nëse transaksionet që përmbajnë elementë të evazionit fiskal duhet të konsiderohen të dyshimta.

Disa transaksione të cilat përmbajnë anomali të theksuara të evazionit fiskal duhet të adresohen. Paraqitja së dy bilanceve nga shoqëritë për marrjen e një kredie në bankë ka qenë një fenomen i theksuar vite më parë. Ky është një fenomen në rënie pasi dhe formalizimi i ekonomisë ka ardhur duke u konsoliduar por nuk është eliminuar plotësisht. Duke u konsideruar thjesht pjesë e evazionit fiskal këto raste mund të mos raportohen si RAD.

Një element tjetër i evazionit fiskal janë transaksionet me kambistë të palicensuar. Kambistë të palicensuar konsiderohen të gjithë ato shtetas që kryejnë veprimtarinë e këmbimit valutor pa u pajisur me lejet përkatëse të ushtrimit të këtij aktiviteti. Megjithatë është e drejtë e secilit klient që paratë e depozituara në bankë ti konvertojë sa herë shikon kurse të favorshme luhatëse të këmbimit valutor. Kjo sjellë njëfarë konfuziteti dhe nevojiten tipologji të qarta (për shembull një numër transaksionesh për një periudhë të caktuar) në kuadrin rregullativ për të qartësuar se kur një klient mund të klasifikohet si kambist i palicensuar dhe rrjedhimisht të raportohet si RAD.

Përdorimi i llogarisë së administratorit në favor të kompanisë është një problem shqetësues që ka të bëjë me evazionin fiskal. Institucionet bankare, në disa raste, përballen me kërkesën e klientit që llogaritë e administratorëve të përdoren për transaksione të tilla si shlyerje faturash dhe detyrimesh të tjera në favor të kompanisë. Këto pagesa duhet të ishin kryer në llogaritë e kompanisë dhe jo të administratorëve pasi organet tatimore kontrollojnë bilancet e personave juridike, pra të kompanive. Duke fshehur transaksionet e kompanisë tek llogaritë e administratorëve është me e vështirë për të bërë dallimin nëse detyrimet janë reale apo të përziera edhe me para të “pista”.

Administrata tatimore, vetë ose nëpërmjet organit të prokurorisë, ka të drejtë t'i kërkojë edhe bankave me seli në Republikën e Shqipërisë, të mos lejojnë tatimpaguesin të kërkojë transferimin e shumave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky ndalim transferimi nuk kërkohet vetëm për tatimpaguesin, por edhe për të gjithë pronarët dhe/ose administratorët e tij. Ky Urdhër Bllokimi i dërgohet bankave tek të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi, ose administratori apo pronarët e shoqërisë tregtare, kanë llogarite e tyre, si dhe të gjitha bankave të tjera me seli në Republikën e Shqipërisë (Udhëzimi Nr. 24 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”). Ky udhëzim ndalon transferimin e shumave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga administoret kur gjykohet e nevojshme nga Drejtoria e Tatimeve. Këto kërkesa nuk mund të konsiderohen të plota pasi vetëm DPPP-ja mund të marrë informacion mbi transaksionet bankare në kohë reale. Ligjvënësi, nuk ka formular tipologji të qarta mbi

levizjet bankare me natyrë shmangie tatimesh në llogarinë e administratorit të kompanisë. Përfshirja elementëve të dyshimtë të evazionit fiskal në kuadrin nën ligjor do të rriste edhe më shumë transparencën mbi llogaritë e personave juridike dhe do të lehtësonte punën e personave përgjegjës për raportimin e RAD-ve në banka.

Për sistemit bankar një shqetësim në rritje është transferimi i kapitalit. Një ndër treguesit të anomalisë së parandalimit të pastrimit të parave në lidhje me transaksionet me jashtë vendit, konsiderohen transfertat hyrse ose dalëse jashtë vendit, të cilat përfshijnë edhe transfertat elektronike të shumave të mëdha në vlerë ose me urdhërpagesë në “cash”, veçanërisht kur nuk kalojnë nëpërmjet një llogarie, ose kur operacionet, përfshirë këtu rastet kur vendi i huaj i origjinës ose i destinacionit të shumave është problematik dhe fondet nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik i zhvilluar nga klienti ose nga rrethana të tjera. BSH ka dekretuar masat përkatëse në këtë drejtim. Për të shmangur rrezikun e përdorimit të bankës për qëllime të pastrimit të parave dhe evazionit fiskal duhet të plotësohet rigorozisht, dokumentacioni për transferimin e kapitalit të rregullores së BSH nr. 70, “Për Veprimtarinë Valutore”. Institucionet financiare banka duhet të kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund të çmojnë të arsyeshëm :

a) për personat fizikë tregtarë dhe juridikë:

- i. deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit dhe i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,*
- ii. vendimi i organit vendimmarrës të klientit për kryerjen e transferimit të kapitalit,*
- iii. ekstrakti i regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit,*

b) për personat fizikë:

- i. deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit, deklarimi i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet.*

Legjislacioni i mësipërm është dekretuar pikërisht për të parandaluar rrjedhjen e kapitalit jashtë vendit tonë dhe sidomos për të neutralizuar dërgimin e asaj pjese të kapitalit që është fituar në mënyrë të paligjshme. Nevojitet që kërkesa të tilla të jenë pjese organike e legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave si dhe të rriten masat penalizuese ndaj abuzuesve të ligjit. Tipologjitë të cilat përmbajnë elementë të fluturimit të kapitalit nuk janë të formuluar qartë në aktet nënligjore të Ministrisë së Financave dhe të Bankës së Shqipërisë. Transaksionet me natyrë evazioni fiskal, korrupsioni dhe aktivitetet kriminale duhet të futen në të njëjtën “ombrellë” dhe të konsiderohen si indikatorë të rëndësishëm të pastrimit të parave. Tentativat për evazion fiskal duhet të konsiderohen si elementë të dyshimtë të pastrimit të parave dhe duhet të trajtohen me vigjilencë të zgjeruar. Dekretimi dhe zbatimi përpikmërisht i rekomandimeve të mësipërme nga institucionet finaciare bankare, shmang ndjeshëm mundësinë e kryerjes së transferimit të fondeve, të cilat mund të përmbajnë elementë të dyshimtë.

Ndryshimet në rekomandimet e FATF-së, të Shkurtit 2012, dhe direktiva e katërt e Bashkimit Evropian mbi parandalimin e të pastrimit të parave të cilët përfshijnë si krim themelor të pastrimit të parave kontrabandën (duke përfshirë shkeljet me detyrimet doganore, akcizat dhe taksat) dhe krimet tatimore (lidhur me tatimet direkte dhe taksat indirekte), do të prekin legjislacionin shqiptar në të ardhmen e afërt. Efektet e drejtpërdrejta të direktives së katërt të bashkimit evropian do të ndihen edhe në ligjin e pastrimit të parave dhe në atë tatimor për shkak të përafrimit të legjislacionit me vendet e Bashkimit Evropian por edhe në mënyrë të tërthortë pasi dekreti Amerikan i FACTA-s do të prekë pothuajse gjithë operativitetin e bankave të nivelit të dytë në vendin tonë. Momentalisht bankat po inkludojnë rekomandimet e FATCA-s, të cilat janë me natyrë evazioni fiskal, në kuadrin e tyre rregullativ “Njihe Klientin Tënd” e cila është pjesë e rregulloreve të brendëshme të parandalimit të pastrimit të parave.

Si përfundim, të gjitha transaksionet bankare të kryera nga klientet që përpiqen të shmangin pagimin e taksave duhet të vazhdojnë të raportohen pranë DPPPP-së. Ky i fundit bashkërendon punën me organet tatimore për të parandaluar fenomene të tilla. Kërkohej ndërhyrje në kuadrin ligjor dhe rregullativ për të vendosur transaksionet me natyrë evazioni fiskal në listën e transaksioneve që kërkojnë aplikimin e vigjilencës së zgjeruar. Transaksionet me natyrë të evazionit fiskal nuk janë të përfshira në nenin 9 “Kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, ndaj të cilave zbatohet vigjilenca e zgjeruar”, të ligjit organik nr. 9917 i PPP/FT dhe në

aktet nënligjore në zbatim të tij, qoftë ato të Ministrisë së Financave ashtu dhe në ato të BSH. Ligjvënësit shqiptare duhet të jenë të përgatitur për këto ndryshime të rëndësishme dhe të marrin masa për përgatitjen e tipologjive të transaksioneve me natyrë evazionit fiskal dhe përfshirjen e tyre në aktet nën ligjore të parandalimit të pastrimit të parave. Një numër më i vogël përfaqësuesish të bankave të tjera e shikonin këtë hap si të parakohshëm dhe mund të sillte kosto për industrinë bankare. Duhet të presim implementimin e rekomandimeve të fundit të FATF-së mbi evazionin fiskal dhe pastrimin e parave si dhe ndikimin që do të kenë në vendet e Bashkimit Evropian. Masa të tilla mund të ngjallin pakënaqësi në klientelën e bankës. Disa tjerë ndanin mendimin që numri i tipologjive të evazionit fiskal të ishte sa më i reduktuar.

4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

4.1 Konkluzionet

Pastrimi i parave konsiderohet si themra e akilit të sistemeve politiko-ekonomike demokratike pasi zgjeron ekonominë informale dhe minon kredibilitetin dhe transparencën e sistemit financiar. Fenomeni i Pastrimit të Parave është procesi i lëvizjes së fondeve të gjeneruara në mënyrë ilegale në një sërë transaksionesh për të krijuar një aparence legale të këtyre fondeve me qëllim përfundimtar fshehjen e origjinës së tyre ilegale. Pastrimi i parave ndodh jashtë rrezes së statistikave normale ekonomike të vendeve. Njihen tre faza të rëndësishme nëpërmejt të cilave kryhet procesi i plotë i pastrimit të parave të krijuara në mënyrë të “pistë”. Këto faza përfshijnë vendosjen e përfitimeve të paligjshme në sistemin financiar, shtresëzimin - shndërrimin e të ardhurave të jashtëligjshme në një formë tjetër për të fshehur gjurmët dhe integrimin - fondet rihyjnë në ekonominë legjitime. Shpesh herë këto faza mund të kapërcehen.

Në kohën e krizes globale dhe rajonale që po kalojmë, të ardhurat e gjeneruara nga burime jolegjitime sjellin likuiditet në ekonominë e vendit në një periudhë afatshkurtër por pasojat negative afatgjata që vijnë nga pastrimi i parave dhe evazioni fiskal janë të konsiderueshme në jetën ekonomike dhe sociale të një vendi dhe tejkalojnë ato pozitive afat shkurtër. Krimi i organizuar mund të infiltrojë në institucionet shtetërore, në subjektet financiare, të marrë kontrollin e sektorëve të mëdhenj të ekonomisë, të kapë mediat dhe të rrisë problemet sociale e shoqërore të një vendi. Ekzistojnë disa metoda të përdorura nga elemente kriminale për pastrimin e parave si strukturimi i transaksionve, manipulimi i faturave tregtare, manipulimi i çmimeve të pasurive të paluajtshme, përdorimi i korporatave “off-shore” me anonimitet të lartë etj.

Fenomeni i pastrimit të parave është kthyer në një temë shumë sensitive për autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit dhe subjektet ligjore raportuese. Çështja duhet të adresohet në mënyrë efektive dhe sistematike pavarësisht nga situata e përgjithshme ekonomike, financiare dhe fiskale e vendit. Parandalimi dhe zbutja e kërcënimit të fuqishëm e konstant që vjen nga aktivitetet kriminale merr rëndësi të veçantë. Në këtë kuadër, institucionet financiare dhe profesionet e lira jofinanciare janë të obliguara të zbatojnë kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi. Kuadri ligjor dhe rregullativ në

fuqi në lidhje me PPP paraqet disa probleme që duhet të adresohen sa më parë për të përmirësuar mjedisin ligjor në vend dhe që rrjedhimisht do të ishte një vlerë e shtuar e të bërit biznes në tregun Shqiptar. Një qasje më transparente dhe e qartë duhet të karakterizojë kërkesat ligjore dhe rregullative duke patur parasysh që subjektet ligjore gjenden mes dy “zjarresh”, në njërën anë ato kanë objektiva komerciale për të përmbushur the në anën tjetër përballen me konsekuencat ligjore për mos respektim të detyrimeve ligjore në lidhje me PPP.

Ligjvënësit kanë forcuar kërkesat ligjore dhe rregullative për parandalimin e këtij fenomeni por ekzistojne disa hendeqe ligjore të cilët pengojnë subjektet financiare dhe jo financiare në zbatimin e kërkesave ligjore dhe duhet të merren masa për amendimet përkatëse në kuadrin ligjor dhe rregullativ. Këto amendime do të bëjnë të mundur që institucionet financiare dhe subjektet e tjera raportuese të mos vihen përballë vërshtirësive ligjore dhe rregullative me pasojë ndëshkime administrative e penale. Ndryshimet në kuadrin ligjor do të krijojnë një qasje më efektive në luftën ndaj këtij fenomeni nga institucionet kompetente ligjvënëse.

Një nga konkluzionet kryesore të këtij studimi ka të bëjë me kërkesën ligjore për të kryer identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut të tij. Në këtë proces, institucionet financiare dhe jofinanciare përballen me një sërë vështirësish për shkak të ekzistencës së hendekut në legjislacionin shqiptar sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të pronarit përfitues fundor.

Pronari përfitues është personi fizik, që zotëron ose kontrollon i fundit një kompani me pronësi një shtresore apo shumë shtresore. Këtu përfshihen ata persona, të cilët kanë një paketë kontrolluese të paktën në nivelin 25% të aksioneve të një personi juridik. Në mungesë të identifikimit të plotë të pronarit përfitues nga institucionet shtetërore, “presioni” bie mbi subjektet financiare dhe jofinanciare të cilat rrezikojnë marrjen e masave administrative/penale nga organet kompetente përgjegjëse apo mbikëqyërse.

Shoqërive tregtare në bazë të ligjit për organizimin e QKR-së, nuk janë të detyruar mandatërisht të regjistrojnë personin fizik, i cili ushtron kontrollin e fundit efektiv të një shoqërie me pronësi

shumë shtresore. QKR-ja momentalisht mjaftohet me regjistrimin e shtresës së parë të aksionerëve të cilët mund të jenë kompani të tjera dhe nuk identifikohen individët e fundit në zinxhirin e pronësisë së kompanive. Ligji për Titujt”, përcakton se aksionet mund të regjistrohen në disa qendra të specializuara për mbajtjen e regjistrave të titujve dhe nuk parashikon një depozitar qëndror të regjistrimit të pronarëve përfitues të aksioneve të shoqërive anonime që në rastin e vendit tonë është Qendra e Regjistrimit të Aksioneve QRA. Ligji parashikon decentralizimin e regjistrimit të aksioneve në regjistrarë të ndryshëm duke nënvlerësuar ndjeshëm rolin e QRA-së. Duke mos patur një status të qartë, institucioni i QRA-së nuk kryen plotësisht një nga funksionet themelore të tij - identifikimin dhe regjistrimin e të dhënave të aksionerëve të shoqërive anonime në regjistrarin e këtij institucioni. Situata vështirësohet po të kemi parasysh mungesën e një tregu aksionesh “bursë” në rastin e shoqërive aksionere me ofertë publike.

Subjektet raportuese financiare dhe profesionet e lira jofinanciare duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet me klientët e tyre. Institucionet financiare hasin vështirësi në përditësim e të dhënave identifikuese të klientëve. Ndryshimi i shpeshtë i të dhënave të klienteve mund ti ekspozojë subjektet ligjore raportuese nga konsekuencat administrative. Opinioni publik duhet të jetë i mirëinformuar dhe në kohë reale mbi ndryshimet e kërkesave ligjore dhe rregullative nga institucionet kompetente të zbatimit të ligjit.

Identifikimi i klientit paraqitet i ndërlikuar për deget apo filialet e një kompanie të huaj me rezidence në vendet e tjera dhe sidomos në qendrat “off-shore”. Kjo për shkak të strukturës së pronësisë shumë shtresore dhe mungesës së aksesit në regjistrat publik ndërkombëtar. Qendrat financiare “off-shore” janë juridiksione që kanë një numër relativisht të madh të institucioneve financiare të angazhuara kryesisht në biznes me jorezidentët. Ato kanë ndërtuar sisteme financiare që kanë asete dhe detyrime të jashtme e jo në proporcionin me ato të brendëshme. Ligji për QKR-në nuk e përmend në mënyrë eksplicite identifikimin e pronësisë përfituese për kompanitë jorezidente shumë shtresore. Identifikimi i pronësisë së aksioneve të mbajtësit të cilët i japin pronësinë e një shoqërie, një personi i cili posedon certifikatën e aksioneve të mbajtësit mbetet një sfidë reale. Këto certifikata i japin kontrollin e një kompanie kujtdo që e ka në duar në një moment të veçantë pa patur nevojë të identifikohet. Juridiksionet “off-shore” ushtrojnë një sekret relativisht të lartë në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive të regjistruara në këto vende si dhe të llogarive bankare të tyre. Çdokush pavarësisht nga përkatësia e tij mund të regjistrojë një kompani

në një qendër “off-shore” dhe më pas të krijojë një marrëdhënie biznesi me një bankë, e cila nuk ushtron standardet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit dhe të financimit të terrorizmit, ndër të tjera fshehjen e pronarit përfundimtar përfitues.

Bankat “guackë”, të cilat janë institucione financiare që nuk kanë një prani fizike në një vend të caktuar si dhe trustet gjejnë hapsira të nevojshme në juridiksionet “off-shore”. Dëmi që i vjen ekonomise globale në përgjithësi nga ekzistenca e qendrave të tilla financiare është i konsiderueshem. Studimi i tyre bëhet akoma më i rëndësishëm përshkak se edhe në vendin tonë kanë filluar aktivitetin e tyre njëserë kompanish me qendër në parajsat fiskale. Niveli i rrezikut reputacional për subjektet ligjore bankare rritet ndjeshëm në rastet e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, të parandalimit dhe pastrimit të parave. Kohët e fundit opinioni publik mbarëbotëror po ndryshon duke anuar në anën e një transparence më të madhe në lidhje me çështjet sensitive që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe evazionin fiskal. Përpjekjet për të hequr “vellon” që mbulon financat globale janë sigurisht të vështira. Vendet perëndimore dhe më gjerë po përballen me thellimin problemeve fiskale dhe çështjet e drejtësisë ekonomike, të cilat po lëvizin agjendat politikëbërësve globalisht.

Identifikimi i plotë i PEP-ve dhe transaksioneve të kryera prej tyre mbetet një sfidë mjaft e rëndësishme në luftën kundër pastrimit të parave. Kjo vjen për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit që ndodh në nivele të larta të sistemit politik. Ekziston një problem i rëndësishëm me listat emërore të PEP-ve vendas dhe të huaj në lidhje me anëtarët e familjes, si dhe personat e lidhur me marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të PEP-ve. Persona me një lidhje të ngushtë me PEP të korrumpuar, duke mos figuruar në listat kombëtare dhe ndërkombëtare të PEP-ve, mund të jenë pronarë përfitues të fshehur të kompanive me pronësi shumë shtresore. Listat aktuale të vëna në dispozicion të subjekteve ligjore raportuese nga autoritet përgjegjëse dhe mbikëqyrëse nuk janë të plota. Kjo mangësi ndikon negativisht në përmirësimin e ushtrimit të vigjilencës së zgjeruar nga subjektet financiare dhe jo financiare ndaj personave të cilat mbajnë apo kanë mbajtur pozicione të rëndësishme shtetërore.

Zhvillimet e reja teknologjike në fushën e sistemit bankar dhe më gjerë, krahas përmirësimeve që sjellin në punën operacionale dhe lehtësimin e të bërit biznes, sjellin probleme të rëndësishme në fshehjen identitetit të klientit dhe të transaksioneve të dyshimta. Për një identifikim sa më të saktë

të klientit dhe transaksioneve të kryera prej tij, institucionet financiare duhet të investojnë në sisteme elektronike inteligjente. Ky investim i domosdoshëm bëhet i papërballueshëm nga bankat që zënë një përqindje të vogël në tregun bankar. Autoritetet përgjegjëse ose mbikëqyërse nuk mundësojnë, kordinimin e implementimit të disa aplikimeve software për bankat e vogla.

Profesionet e lira jo financiare janë një hallkë e rëndësishme në luftën kundër pastrimit të parave. Profesionet e lira janë të detyruara të raportojnë aktivitetet e dyshimta RAD tek autoriteti përgjegjës si dhe raportet e transaksioneve të vlerave RTV për veprimet mbi pragun e raportimit brënda harkut kohor të përcaktuar në ligj. Raportimi i transaksioneve të vlerave në para fizike mbi pragun e raportimit tek autoriteti përgjegjës është i ekzagjeruar. Për të përmbushur këtë detyrim, mund të lihet pas dore raportimi i transaksioneve të dyshimta RAD-ve, i cili në fakt është më i rëndësishëm dhe për të cilat autoriteti përgjegjës dhe autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit janë më të interesuara.

Marrëdhënia në mes të pastrimit të parave dhe evazionit tatimor është një temë shumë komplekse pasi këto fenomene janë mjaft të lidhura ndërmjet tyre. Aspekte të tilla si legalizimi i kapitalit apo përdorimi i llogarisë së administratorit në favor të kompanisë mbeshtesin lidhjen e ngushtë që ekziston midis këtyre fenomeneve. Transferimi i kapitalit nëpërmjet transfertat elektronike të shumave në vlerë të mëdha mund të përfshijnë fonde me burim të ardhurash si nga aktivitetet kriminale ashtu dhe nga evazioni fiskal. Kështu që kemi rrjedhje të kapitalit të fituar në mënyra të paligjshme jashtë vendit. Rrjedhimisht teknikat e përdorura në të dy fenomenet janë të njëjta. Personat përgjegjës në institucionet financiare dhe jofinanciare gjenden përballë vështirësive sa i përket vendosjes së një vijë ndarëse midis të dy fenomeneve. Nuk janë përcaktuar tipologji të sakta në kuadrin ligjor dhe rregullativ të PPP të cilat do të ndihmonin në rritjen e raportimit të transaksioneve të dyshimta RAD dhe zbutjen e rrezikut reputacional që mund të përballen subjektet raportuese.

4.2 Rekomandime

Në përfundim studimit janë përgatitur disa rekomandime për institucionet dhe studius në fushën e parandalimit të parave. Këto rekomandime do të sillnin një përmirësim të mjedisit politiko-ligjor aktual dhe përmirësim të klimës së biznesit në vend. Subjektet ligjore raportuese (institucionet financiare dhe jofinanciare) do të përballëshin me një rrezik reputacional më të moderuar për shkak se hapsira për penalizime nga autoritetet përgjegjëse dhe mbikëqyerse do të ishte më e ulët. Rrjedhimisht një mjedis më transparent ligjor rrit atraktivitetin e tregut shqiptar për investime të huaja direkte si dhe ato vendase.

Përmirësimi i funksionimit të QKR-së dhe QRA-së

Kuadri ligjor i cili rregullon institucionin e QKR-së duhet të përditësohet dhe përmirësohet sa i përket identifikimit fundor të pronësisë së personave juridikë. QKR-ja nuk duhet të regjistrojë asnjë subjekt juridik (shoqëri) pa identifikuar fillimisht pronësinë përfituese deri në hallkën e fundit të zinxhirit të strukturës së pronësisë përfituese. Çdokush që regjistron një kompani, pamvarësisht nga lloji i organizimit të saj, duhet të deklarojë emrat e individëve të vërtetë që kanë kontrollin e fundit efektiv, dhe të raportojnë çdo ndryshim në të dhënat identifikuese të pronarëve përfitues në kohë reale. Institucioni i QKR-së duhet të disponojë në mënyrë taksative regjistrin e posatshëm të shoqërive aksionere, i cili duhet të përmbajë në detaje informacionin mbi të gjitha shtresat e pronësisë përfituese të një shoqërie. Masat shtërnguese duhet të rriten për menaxherët dhe pronarët përfitues të kompanive që përpiqen të fshehin pronësinë përfituese. Të shikohet edhe mundësia që QKR-ja të privatizohet për ta bërë sa më eficiente regjistrimin dhe përditësimin e informacionit të shoqërive tregtare dhe funksionimin e këtij organizmi të rëndësishëm. Praktika Italiane e funksionimit të QKR-së “Cerved” mund të merret si model.

Sa i përket funksionimit të QRA-së, në ligjin për “Titujt” duhet të përcaktohet qartë që të ketë vetëm një qendër të specializuar për mbajtjen e regjistrave të shoqërive anonime në vendin tonë. Identifikimi i zotëruesve përfundimtar të aksioneve do të realizohet me efikasitet nëse ekziston vetëm një regjistrar i të dhënave. Kuadri rregullativ duhet të detyrojë shoqëritë anonime të huaja

ose vendase të regjistrohen pranë regjistrarit të vetëm QRA, shoqëruar me të dhënat identifikuese mbi pronarin e fundit përfitues që janë poseduesit e vërtetë të aksioneve. Regjistri elektronik i QRA-së duhet të tregojë me detaje të gjitha kalimet e pronësisë mbi aksionet në mënyrë kronologjike. Institucionet financiare bankë nëpërmjet aksesit online, si në rastin e QKR-së, të lidhen me databazin e QRA-së për të kryer identifikimin e pronarit përfitues në kohë reale. Në kuadrin ligjor të parandalimit të pastrimit të parave (*neni 5 i ligjit 9917 mbi PPP/FT*), në rastin e shoqërive anonime, të shtohet si klausole edhe ekstrakti i QRA-së. Të shikohet edhe mundësia e privatizimit të QRA-së duke parë praktikën më të mira ndërkombëtare. Funksionimi i bursës do të ishte një hap i rëndësishëm në identifikimin e pronësisë përfituese fundore të shoqërive anonime.

Institucionet e QKR-së dhe QRA-së duhet të ndalojnë në mënyrë taksative regjistrimin e degeve të kompanive me seli në juridiksionet “off-shore” nëse nuk bëhet identifikimi i plotë i strukturës së pronësisë përfituese deri në nivelin e kontrollit të fundit efektiv mbi kompanitë. Aksionerët që kanë interes kontrollues të tregojnë identitetin e tyre. QKR-ja dhe QRA-ja duhet të regjistrojnë të gjitha të dhënat mbi gjurmët e pronësisë reale përfituese të shoqërive aksionere jorezidente. Këto institucione duhet të marrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e aksioneve të mbajtësit, duke aplikuar mekanizma të tilla si ndalimi i tyre ose konvertimi i tyre në aksione nominale të regjistruara. Më shumë informacion mbi pronësinë e përfituese të kompanive dhe trusteve, mundëson subjektet ligjore, autoritetet tatimore dhe zbatuesit e ligjit, të gjejnë se kush në të vërtetë kontrollon një firmë. Ndryshimet e kërkuara duhet të sanksionohet në kuadrin ligjor të këtyre institucioneve për të mbyllur hendekun ligjor që ekziston me ligjin organik të parandalimit të pastrimit të parave si dhe do të lehtësonte peshën e identifikimit të klienteve “off-shore” e cila bie ekskluzivisht tek institucionet financiare dhe profesionet e lira jofinanciare.

Për sa më sipër, institucionet të cilat duhet të përfshihen në këtë projekt janë: QKR, AMF, Ministria e Financave, Bursa e Tiranës dhe DPPPP.

Domosdoshmëria e pajisjes së subjekteve financiare me listat e sakta të PEP-ve

Autoritetet ligjvënëse duhet të përpilojnë dhe t’ju sigurojnë subjekteve ligjore dhe institucioneve financiare në veçanti, një listë të plotë të PEP-ve të huaj edhe vendas për të lehtësuar punën e tyre operationale dhe për të parandaluar abuzimin që mund të vijë nga PEP të korruptuar. Në listë

duhet të përfshihen qoftë antaret e familjes së personave të klasifikuar PEP ashtu the personat që kanë një lidhje të ngushtë biznesi me PEP. ILDKP dhe DPPP duhet të përfshihen në këtë projekt.

Autoritetet shtetërore të ndermjetësojnë për aplikime software mbi PPP

Autoritetet përgjegjëse apo mbikëqyrese duhet të ndihmojnë bankat e vogla dhe me buxhet të ulët, në gjetjen e sistemeve software inteligjente në lidhje me PPP si dhe shërbimet e bazave specifike të të dhënave për identifikimin elektronik të PEP-ve. Bankat, duke patur opsionin “share”, duhet të jenë në gjendje të aksesojnë të dhënat nga këto software dhe të ndajnë kostot ndërmjet tyre. DPPP dhe BSH duhet të përfshihen në këtë projekt.

Profesionet e lira jofinanciare duhet të raportojnë vetëm RAD

Profesionet e lira jofinanciare duhet të përqëndrohen dhe të japin kontributin e tyre në raportimet e RAD-ve dhe amendamentet e nevojshme ligjorë duhet të adresohen në kuadrin tonë ligjor për të hequr detyrimin e raportimit të RTV-ve në “cash” për shumën 1,000,000.00 Lekë. Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në Udhëzim Nr. 29, datë 31.12.2012 “Për Mënyrat dhe Procedurat e Raportimit të Profesioneve të Lira Jofinanciare”, të Ministrisë së Financave. Në këtë projekt duhet të përfshihen ministritë përkatëse për mbikëqyerjen e profesioneve të tjera të lira në bashkëpunim me DPPP. Një ndihmë të veçantë duhet të jepë Dhoma Kombëtare e Avokatisë për avokatët si dhe IEKA për ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur.

Evazoni fiskal të trajtohet në kuadrin rregullativ të parandalimit të pastrimit të parave.

Nevojiten amendime përkatëse në kuadrin rregullativ për të përfshirë elementë të evazionit fiskal në kuadrin rregullativ të parandalimit të pastrimit të parave. Transaksionet me natyrë evazoni fiskal duhet të trajtohen me vigjilencë të zgjeruar nga subjektet raportuese dhe të përfshihen në nenin 9, të ligjit 9917, mbi PPP/FT “Kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, ndaj të cilave zbatohet vigjilenca e zgjeruar”. Në aktet nënligjore të Ministrisë së Financave (udhëzim 28 dhe 29 Për Mënyrat dhe Procedurat e Raportimit mbi PPP) dhe BSH (Udhëzim 55 mbi PPP në sistemin bankar) duhet të përcaktohen qartë tipologjitë e transaksioneve të evazionit fiskal ku duhet aplikuar vigjilenca e zgjeruar për të lehtësuar operativitetin e subjekteve ligjore

raportuese në drejtim të identifikimit të transaksioneve të tilla dhe zbutjen e rreziqeve që vijnë prej tyre. Këto kërkesa do të rrisin edhe me shumë transparencën mbi transaksionet në llogaritë e personave juridike. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, BSH dhe DPPPP duhet të përfshihen në këtë projekt.

Të krijohen regjistrat e kompanive dhe të aksesohen ndërkombëtarisht

Në rrafshin ndërkombëtar, identifikimi i pronarit përfitues duhet të bëhet për të gjithë personat që zotërojnë një përqindje të caktuar të kompanisë. Problemi i identifikimit të pronarit përfitues të klienteve persona juridike është një prej dukurive të globalizimit dhe shqetëson ligjvënësit në nivel ndërkombëtar. Duhet që të gjithë kompanitë e krijuara në një vend të regjistrohen në regjistrin e veçantë të kompanive bashkë me të dhënat përfundimtare të pronësisë përfituese dhe të aksesohen nga subjektet ligjore raportuese dhe institucionet ligjvënëse ndërkombëtarisht. Regjistrat e korporatave të çdo vendi, përfshirë dhe ato që janë me qendër në vendet “off-shore”, duhet të jenë të përditësuara me detajet e emrit, adresën, drejtorët dhe identitetin e plotë të pronarëve përfitues të të gjitha kompanive që regjistrohen në atë vend. Regjistrat duhet të përmbajnë të dhëna të sakta identifikuese. Aksesimi duhet të jetë direkt dhe në kohe reale dhe pa kosto për subjektet financiare dhe jofinanciare të vendeve të ndryshme. Rekomandimet e FATF-së duhet të jenë të detyrueshme për të gjitha institucionet shtetërore të regjistrimit të kompanive në mbarë globin. Institucionet ndërkombëtare si FATF, Moneyval, FMN, Banka Botërore etj., duhet të mëshojnë faktit që bashkëpunimi ndërkombëtar të rritet dhe të dhënat e regjistrave të korporatave të vendeve të ndryshme të aksesohen nga institucionet kompetente të zbatimit të ligjit dhe subjektet ligjore raportuese të vendeve të tjera. Ky do të ishte një hap konkret shumë domethënës në identifikimin e korporatave multinacionale dhe bashkëpunimi ndërkombëtar nuk do të mbetet në kuadrin e rekomandimeve. Në këtë drejtim kërkohet të bëhen disa përpjekje substanciale në rang global dhe reforma të rëndësishme institucionale duhet të ndërmerren. Organizmi i FATF-së dhe autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit në vende të zhvilluara duhet të luajnë një rol më aktiv në vlerësimin e vendeve ku konstatohen probleme me identifikimin e pronësisë përfituese dhe uljen e rrezikut që vjen prej tyre.

Studime të tjera në të ardhmen mund të mos kufizohen vetëm në identifikimin e problematikave që përballen subjektet ligjore raportuese, por mund të zgjerohen edhe në sfidat që përballen institucionet shtetërore në kuadër të zbatueshmërisë së ligjit. Shumë me interes është thellimi i

studimit rreth rrezikshmërisë që paraqet pastrimi i parave në përdorimin e produkteve specifike financiare si përsëmbull:

- factoring-u dhe financimi i transaksioneve tregtare;
- produktet derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options);
- instrumentet e këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje (swap) dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen, etj.

Ekspertë të subjekteve nga fusha të tjera mund të japin kontributin e tyre në thellimin e gjetjeve të këtij studimi. Këtu mund të përmendim shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre; lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, të çfarëdo forme; zyrat e këmbimeve valutore; biznesi i ndërtimeve; biznesi i metaleve dhe i gurëve të çmuar; veprimtaritë e speditonit dhe të transportit etj.

Studimi dhe parandalimi i fenomenit të pastrimit të parave do të jetë një sfidë e rëndësishme për ligjvënësit, bankierët, profesionistët e lirë dhe akademikët në të ardhmen.

Bibliografia

- 1 Aaker David, *Strategic Market Management*, 2008,
- 2 Ahmed Zoromé; *Concept of Off-shore Financial Centers: In Search of an Operational Definition*; IMF Working Paper 07/87; 1 Prill, 2007.
- 3 Banka e Shqipërisë
www.bankofalbania.org.
3. Brigitte Unger, Gregory Rawlings “*Competing for criminal money*”; 2008.
4. Brigitte Unger, *The Gravity Model for Measuring Money Laundering and Tax Evasion Paper prepared for the Workshop on Macroeconomic and Policy Implication of Underground Economy and Tax Evasion*, February 5-6, 2009.
5. B. Maurer, *Re-regulating off-shore finance*, 2009.
6. BBC, *Bitcoin's freedom promise*, 16 April, 2013.
7. BBC, *Does transparency kill 99% of despots?* Robert Peston, the BBC's business editor, 20 March 2011.
8. BBC, *Cybercriminals 'drained ATMs' in \$45m World Bank heist*, May 09, 2013.
9. Behind corporate veil, *Using corporate entities for illicit purposes*, OECD 2001.
10. Cayman Compass, “*10,000-plus funds registered in Cayman Islands*”, 29th July, 2008.
11. Criminal money flows on the Internet: *methods, trends and multi-stakeholder counteraction*, Adopted by MONEYVAL at its 38th Plenary meeting (5-9 March 2012).
www.coe.int/moneyval www.coe.int/cybercrime
12. CNBC, *More bitcoins, more problems: How hackers are targeting bitcoins*, 20 Nov 2013.
13. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
<http://www.fint.gov.al/>
14. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
http://www.tatime.gov.al/gdt/default.aspx?UR=http://intranet.bisbanca.int/?page_id=23

15. Ermelinda Meksi & Auron Pasha; *Kur Mbaron Tranzicioni? Teoria Kundrejt Realitetit në Shqipëri; Ekonomia shqiptare: arritje dhe sfida* - Konferenca IV e Bankës së Shqipërisë 20.04.2004.
16. Egmont Group of Financial Intelligence Units.
www.egmontgroup.org
17. *European Council*
<http://www.european-council.europa.eu/home-page/highlights/g8-summit-promoting-global-fairness-through-trade,-transparency-and-tax-compliance?>
18. Financial Action Task Force (FATF).
www.fatf-gafi.org/
- 19 FMN
<https://www.imf.org/external/np/mae/osshore/2000/eng/back.htm>.
19. Financial Action Task Force (FATF) *Guidance for Accountants*, 17 June 2008.
20. FATF Report, *On new payment methods*, October 13, 2006.
21. FATF Report, April 2011.
22. Global Financial Integrity GFI.
www.gfintegrity.org
23. Financial Secrecy Index
<http://www.financialsecrecyindex.com/introduction/fsi-2013-results>.
24. Indian Express-ICIJ probe: *Vijay Mallya, Ravikant Ruia in tax havens*, April 4, 2013.
25. IMF. 2005. Off-shore Financial Centers: *The Assessment Program—A Progress Report*. Washington DC.
26. James S. Henry; *The Price of Off-shore Revisited, New Estimates for Missing Global Private Wealth, Income, Inequality, and Lost Taxes*, July 2012.
27. Jane G. Gravelle, *Tax Havens: International Tax Avoidance and Evasion*, January 23, 2013.
28. Joint Release; National Credit Union, Administration Office of the Controller of the Currency, Financial Crimes Enforcement Network, Board of Governors of the Federal Reserve System, Federal Deposit Insurance Corporation, *Guidance on Obtaining and Retaining Beneficial Ownership Information*, March 5, 2010.

29. List of countries in the world sorted by their gross domestic product (GDP), *List by the United Nations*, (2011).
30. Komsioneri për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, <http://www.kmdp.al/index.php/sq/>
31. Methods and Stages in Money Laundering, Money loundering in EU, people.exeter.ac.uk/.../methods%20and%20stages.htm
32. Moran Harari, Markus Meinzer and Richard Murphy "*Financial Secrecy, Banks and the Big 4 Firms of Accountants*" Tax Justice Network, (October 2012).
33. OECD, Secretary-General Report to the G20 Finance Ministers, July13, 2013.
34. Off-shore Financial Centers: *A Report on the Assessment Program and Proposal for Integration with the Financial Sector Assessment Program*, 2008.
35. Peter Lilley, "Dirty dealing" *The untold truth about global money laundering, international crime and terrorism*; 2006.
36. Peter J. Quirk, *Money Laundering Muddying the Macroeconomy*, (1997).
37. Peter Reuter, Edwin M. Truman, *Chasing Dirty Money: The Fight Against Money Laundering*, 2004.
38. Phineas Baxandall, Abigail Caplovitz Field and Dan Smith, U.S. PIRG, "*Average Citizens and Small Businesses pay the Price for Off-shore Tax Havens*" April, 2012.
39. Raymond w. Baker "Capitalism's Achilles Heel" *Dirty Money and how to Renew the Free-Market System*; 2005.
40. Reuters, *Money laundering distorts Colombia's economic comeback*, by Helen Murphy and Nelson Bocanegra, 28.05. 2013.
41. Reuters, *Pakistan's booming market no black and white matter*, by Katharine Houreld 10.04. 2013.
42. Reuters, *Bitcoin exchanges offer anti- money-laundering aid*, by Brett Wolf, 15.06. 2011.
43. Reuters, *Oldest Swiss private bank is newest U.S. target*, By Martin de Sa'Pinto and Lynnley Browning, 16.02.2012.
44. Reuters, *Another Score for Bitcoin: You Can Now Use it to Pay for College*, 21.11. 2013.

45. Rui Tavares, Thematic Paper on Money Laundering *Relationship between Money Laundering, Tax Evasion and Tax Havens*. Author: (Greens/EFA) January 2013.
46. Spiegel online international – *Off-shore Leaks: Vast Web of Tax Evasion Exposed*, April 04, 2013.
47. Transparency international
www.transparency.org/cpi2012/in_detail
48. Tim Parks, *Medici Money: Banking, Metaphysics and Art in Fifteenth-Century Florence*, 2005.
49. Tax Justice Network
www.taxjustice.net
50. Tax Justice Network "*Financial Secrecy Index*" (2011).
51. The Economist, *From Bolshevism to backhanders*, 14.04.2011.
52. The Economist, *The benefits of early money-laundering*, Oct 21st 2011.
53. The Economist, *Just when you thought it was safe... Bailing out Cyprus was always going to be tricky. But it didn't have to be like this*, 27.03. 2013.
54. The Economist, *Swiss banking secrecy, Don't ask, won't tell*, 11.02. 2012
55. The Economist, *The shores of El Dorado*, 10.02. 2012.
56. The Economist, "*Banking for the bad guys*", 06.08. 2012.
57. The Economist, *Trouble Island*, 15.10.2011.
58. The Economist, *Corporate anonymity*, 21.01. 2012.
59. The Economist, *An index of financial secrecy, Lifting the veil*, 6.11. 2013.
60. The Guardian, *Why I am committed to global tax reform, The principles for governing tax have barely changed in 100 years. Now's the time* George Osborne, 16 .02. 2013.
61. The Regulatory News Update from DLA Paper, July 2011.
62. The Woslfberg Group
<http://www.wolfsberg-principles.com/faq-ownership.html#3b>
63. Theodore S. Greenberg, Larissa Gray, "Politically Exposed Persons", *Preventive Measures for the Banking Sector*, 11.05.2010.

64. John McDowell, and Gary Novis, Program Analyst, *The Consequences of Money Laundering and Financial Crime*, Electronic Journal of the U.S. Department of State Vol. 6, No. 2, May 2001.
65. United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC)
<http://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/introduction.html>
66. US Pirg, *First Step to Avoid the Fiscal Cliff: Close Off-shore Tax Loopholes*, 06 December 06, 2012.
67. US State Department Money Laundering Report – 2012.
www.state.gov › ... › Volume II: Money Laundering and Financial Crimes.
68. World Bank, *Money Laundering Impacts Development* - 30 Mars 2013
www1.worldbank.org/finance/.../02-chap02-f.qxd.pdf
69. World bank, Doing Business
<http://www.doingbusiness.org/rankings>
70. Wolfsberg Group, *AML Principles*
www.wolfsberg-principles.com

APENDIKS I

INTERVISTË E GJYSMË-STRUKTURUAR

I nderuar kontribues,

Në kuadër të pregtitjes së temës së doktoraturës, “Sfidat që hasin subjektet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe sygjerimet për daljen nga ngërci ekzistues”, është përgatitur ky sondazh, i cili mbledh përceptimet dhe qëndrimet rreth cënueshmërisë së sektorit tuaj nga pastrimi i parave (PP). Intervista e mëposhtme zhvillohet në kuadrin e punës sime kërkimore për mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave pranë Universitetit të Tiranës dhe do jetë pjesë e një serie më të gjerë kërkimesh në fushën e PP në Shqipëri.

Pyetjet e gjysmë-strukturuara u drejtohen kolegëve me një njohuri të mirë të sektorëve financiar dhe të biznesit në vend si për shembull, oficerë të përputhshmërisë, zyrtarë të zbatimit të ligjit dhe përfaqësues të profesioneve të lira.

Ky studim synon të evidentojë dobësitë dhe vështirësitë që hasin subjektet ligjore në zbatimin e ligjit të PPP. Ju kërkohet të përgjigjeni vetëm në masën që ju lejon natyra e biznesit që operoni.

Roland SUBASHI,

Informacione të përgjithshme

Për cilën agjenci, autoritet ose institucion punoni?

Cilës nga fushat e mëposhtme që lidhen me PPP i përket institucioni që ju punoni?

- *FIU__;*

- Banke ____;
- Zyre Noteriale ____;
- Eksperte kontabel ____;
- Zyre Avokatie ____;
- Zyrat e këmbimeve valutore ____;
- Agjentët e pasurive të paluajtshme ____;
- Të tjerë _____

Përafërsisht sa vite keni qenë i përfshirë në çështje të PPP?

- < 1 _____
- 1-3 _____
- 3-6 _____
- > 9 _____

Pyetjet kërkimore

1. *A verifikon subjekti juaj identitetin e klientit përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientët? A kryeni monitorim të vazhdueshëm të të dhënave të klientit si dhe veshtiresite që hasen në këtë drejtim? A verifikon subjekti juaj identitetin e klientit përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientë të rastësishëm (rastesor)” përfshirë derdhjet e të tretëve si dhe vështirësitë që hasen në këtë drejtim? A a kryen subjekti juaj identifikimin e pronarit përfitues (person fizik) të klienteve parsore dhe rastesore dhe verifikimin e këtij identifikimi duke ndërmarrë masa të arsyeshme në mënyrë që të krijohet bindja se kush është pronari përfitues përfundimtar. Në rastin e personave juridikë dhe organizimeve të tjera ligjore masat e marra përfshijnë të kuptuarit e pronësisë dhe strukturës së kontrollit të tyre; A keni arritur të identifikoni të gjithë pronaret përfitues të klienteve tuaj juridike sidomos ato*

jorezidente? Çfarë vështirësish keni hasur? A aplikon subjekti juaj masat e vigjilencës së duhur bazuar në nivelin e rrezikut. Krahas kategorive të përcaktuara në ligj, subjektet duhet të përcaktojnë kategori të tjera të klientëve dhe transaksioneve ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. A keni hartuar procedura dhe politika për të identifikuar shkallën e rrezikut sipas kategorive të klientëve apo marrëdhënieve të biznesit? A ka subjekti juaj të ngritur sisteme kontrolli dhe monitorimi në bazë të anomalive të evidentuara dhe të parapërcaktuara në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi (qofte manual apo elektronik)?

(Vetëm për të intervistuarit e institucioneve shtetërore) Çfarë mendoni mbi problemin e subjekteve private raportuese mbi identifikimin e pronarit përfitues i cili ushtron i fundit kontrollin mbi një shoqëri tregtare me strukturë pronësie shumë shtresore (fuksonimi i QKR)?

(Vetëm për të intervistuarit e QRA) A kryen institucioni juaj Identifikimin e Pronarit përfitues (person fizik) të kompanive aksionere. Çfarë problematike hasni në këtë drejtim?

(Për të gjithë subjektet) A mendoni se duhen ndryshime rregullative për përmirësimin e identifikimit të klientit dhe pronësisë përfituese?

2. *Si i identifikoni klientet “jo rezidentet”. A keni vështirësi në lidhje me identifikimin e tyre. A ka subjekti juaj kliente “Off-shore”? Nëse po, si procedohet në raste të tilla? A ka subjekti juaj kliente që i përkasin “Organizimeve ligjore” si trustet apo marrëveshjet e tjera të ngjashme? Nëse po, si procedohet në raste të tilla? A ushtroni vigjilencë të zgjeruar ndaj tyre? A keni kryeni veprime me vendet problematike? Si e vlerësoni nivelin e rrezikut në lidhje me transfertat me këto vende? Si veproni në përzgjedhjen e bankave korrespondente? A mbani llogarive transitore me banken korrespondente? Si veproni në raste të tilla? Si siguroheni që banka korrespondente nuk operon me bankat “guaske”? Si veproni në rastin e transfertave individuale me jashtë shtetit? A kërkon dokumentacion justifikues për çdo transferte individuale të kryer jashtë shtetit? A keni mundësi të aksesoni regjistrat publike të vendeve antare të BE. Nëse po, a keni hasur probleme me identifikimin e klientit? A ka shpenzime kërkimi?*

(Vetëm për të intervistuarit e institucioneve shtetërore) Identifikimi i klientit paraqitet më i komplikuar për degët apo filialet e një kompanie të huaj me rezidencë në vendet e tjera (jo-rezidente) dhe sidomos në qendrat financiare “off-shore”. Cili është opinionimi juaj?

(Për të gjithë subjektet) A mendoni se janë të nevojshme amendime ligjore në kuadrin rregullativ për identifikimin e jo-rezidentëve dhe krijimi i regjistrave të aksesueshem ndërkombëtare me të dhëna mbi pronësinë përfutuese.

3. Në lidhje me Personat e Ekspozuar Politikisht PEP vendas, A keni akses në regjistrat publike sa i përket identifikimit të PEP? Per PEP e huaj, a kërkon subjekti juaj informacione ne burimet e disponueshme të tilla si: lista e perditesuar e personave te ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike e te dhenave (Worldcheck, Factiva, etj) apo nga burimet e hapura të informacionit? A e konsideroni shpenzim të konsiderueshëm për institucionin tuaj një investim të tillë? A duhet të keni lista me të sakta nga institucionet shtetërore?

(Vetëm për të intervistuarit e institucioneve shtetërore) Identifikimi i anëtarëve të familjes të Personave të Ekspozuar Politikisht PEP dhe personave të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi me PEP mbetet një sfidë e rëndësishme e subjekteve ligjore dhe autoritet ligjvënës. Cili është opinionimi juaj?

A duhet autoritet ligjvënës të mundësojnë listat e plota të PEP-ve?

4. Çmendim keni mbi rolin që mund të kenë Zhvillimet teknologjike dhe palët e treta në subjektin tuaj në lidhje me PPP? Si ndikojnë produktet e reja elektronike në procesin e identifikimit të klientit? A e shikoni të domososhme për institucionin tuaj që të ketë sisteme elektronike inteligjente kundër pastrimit të parave?

(Vetëm për të intervistuarit e institucioneve shtetërore) Çmendim keni mbi rolin që mund të kenë Zhvillimet teknologjike dhe palët e treta në lidhje me PPP? Si ndikojnë produktet e reja elektronike në procesin e identifikimit të klientit? A e shikoni të domososhme për subjektet që të ketë sisteme elektronike inteligjente kundër pastrimit të parave? Si mund ti ndihmoni Bankat në ndarjen e kostove për disa aplikacione si Worldcheck Factiva etc?

5. *(Kryesisht per profesionet e lira) Cili është vlerësimi juaj mbi transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja? Avokatët janë të vetmit që përjashtohen nga detyrimi për raportim, në rastin kur të dhënat janë marrë nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në situata të caktuara. Çmendim keni mbi trajtimin e sekretit profesional ose përfitimet që rrjedhin prej tij në profesionin tuaj? (Vetëm për të intervistuarit e institucioneve shtetërore) A duhet profesionet e lira të përjashtohen nga detyrimi i raportimit të RTV-ve, dhe të fokusohen vetëm tek RAD-të? Cili është mendimi juaj?*
6. *A kryhen transaksione me natyrë tregtare (psh. Pagesa faturash që i përkasin kompanisë) në llogarinë e administratorit të kompanisë. A jeni në gjendje të përcaktoni nëse kembimet valutore futen në kategorinë e klienteve të paligjshëm. A keni përcaktuar një numër limit transaksionesh për të përcaktuar nëse një klient po abuzon me transaksionet e kembimeve valutore.*
- A duhet të përfshihen transaksionet me natyrë evazioni fiskal në kërkesat rregullative të vigjilencës së zgjeruar të PPP dhe a duhet të raportohen ato si RAD?*

FALEMINDERIT PER BASHKEPUNIMIN TUAJ!

APENDIKS II**Kuadri ligjor dhe rregullativ**

Ligj nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 03.03.2011 dhe me ligjin nr. 66/2012, datë 07.06.2012.

Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Udhëzim Nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Ligj nr. 10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”.

Ligj nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ligj Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Ligj nr.9879 datë 21.2.2008 “Për Titujt”.

Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Vendim Nr. 3, datë 20.11.2012, Për Përcaktimin e Shteteve, me Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Ligj nr. 10 091, datë 5.3.2009 Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar.

Ligji nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar.

Udhëzim i Ministrise së Financave nr. 28, datë 31.12.2012 Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

Udhëzim i Ministrise së Financave nr. 29, datë 31.12.2012 Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare.

Ligj nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Vendim nr. 03, Këshilli Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë datë 19.01. 2011 Për miratimin e rregullores “për administrimin e rrezikut operacional”.

Aneksi 1 Udhëzues për Matjen e Rrezikut nga Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit, Vendim nr. 55, datë 28.08.2013 Për disa Ndryshime në Rregulloren “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”.

Ligji nr. 04/L-178 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr 03/L-196 Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit në Republikën e Kosovës.

Tipologjitë e Pastrimit të Parave - Njësi e Inteligjencës Financiare NIF të Kosovës.

Law on money laundering prevention and other criminal proceeds and financing terrorism, Scopje, January 2008.

FATF Recommendations, as adopted in February 2012.

European Communities (EC) Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime) 1990.

Directive 2005/60/EC of The European Parliament and of The Council of 26 October 2005 on the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing.

FATCA - The American Foreign Account Tax Compliance Act - expands information reporting and withholding rules for non-U.S. financial institutions (“foreign financial institutions” or “FFIs”).